

Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike

Rruga 'A. Frashen', Pall 4, Hyrja 3, Ap 24, Kutia Postare 2934, Tirane, SHQIPERI. Tel/Faks. 042/25021, E-mail. ceralb@.adanet.com.al

POLITIKAT EKONOMIKE PER ZHVILLIMIN E RAJONIT TE TIRANES

TIRANE, DHJETOR 1999

QENDRA SHQIPTARE PER KERKIME EKONOMIKE
ADRESA:
Rr. "A. Frasheri", Pall. 4, Hyrja 3. Ap. 2,
Kutia Postare 2934, Tirane, ShQIPERI
Tel./Faks: (355 42) -25021/29069,
E-mail: ceralb@adanet.com.al,
WWW.ONLINE.BG/ACER

Grupi i punes:

AURON PASHA, Drejtor Kerkimesh, Drejtues projekti

Prof. Ass. Dr. QAMIL TALKA, Konsulent per Çeshtjet e Zhvillimit Ekonomik
Dr. FATMIR MEMA, Bashkepunetor i Jashtem i QShKE
IRMA TANKU, Koordinatore e Programeve te Qeverisjes Vendore
LEDIA MUÇO, Koordinatore e Programit te Reformes Institucionale
FJORALBA VESHO, Asistente

Ky punim eshte perpjekje e perbashket e grupit te punes se Qendres Shqiptare per Kerkime Ekonomike. Ai u pergatit bazuar ne nje njohje te gjere te ketij rajoni, ne pervojen e specialisteve te grupit te punes, si edhe ne mendimet dhe opinionet te shume prej specialisteve me te mire te rajonit te Tiranes. Studjuesit u bazuan ne shume materiale dhe publikime te nje numri institucionesh qendrore dhe lokale, si edhe ne literaturen dhe pervojen e huaj.

Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike vlereson dhe falenderon per ndihmen dhe sugjerimet e dhena specialistet e meposhtem:

1. Luan SHAHOLLARI, Deputet, Kuvendi i Shqiperise, Anetar i Keshillit Bashkiak, Tirane
2. Violeta BENDO, Keshilltare Ekonomike e Kryetarit te Bashkise Tirne
3. Syrja SUKJA, Drejtor, Departamenti i Politikave Ekonomike, Bashkia e Tiranes
4. Zef PREÇI, Minister, Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit
5. Ali DEDEJ, Keshilltar, Ministria e Transportit
6. Nexhmedin DUMANI, Drejtor, Inspektoriati i Punes, Miinistria e Punes dhe Çeshjeve Sociale
7. Rako ZGURI, Drejtor, Drejtoria e Tatim-Taksave, Tirane
8. Gjergj MANO, Drejtor, Departamenti i Prodhimit, INSTAT
9. Gjergj SIMAKU, Drejtor, Agjensia Kombetare e Energjise
10. Alfred PALOKA, Shef Departamenti, KESH
11. Gani DELIU, Shef, Sektori i Ambjentit, Komiteti Kombetar i Mjedisit
12. Eleni DUNI, Drejtore, Departamenti i Statistikes, Bashkia e Tiranes
13. Nuzet XHENETI, Shefe, Sektori i Statistikes, Ministria e Puneve Publike
14. Siri ALLUSHI, Drejtor, Drejtoria e Statistikes, Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit

HYRJE 3

I. VESHTRIM I PERGJITHSHEM 5

II. GJENDJA INFRASTRUKTURORE E RAJONIT TE TIRANES 9
II. 1 Infrastruktura teknike
II. 2 Infrastruktura Komunale
II. 3 Infrastruktura sociale
II. 4 Mjedisi Urban i Rajonit te Tiranes

III. POPULLSIA E TIRANES DHE LEVIZJA MIGRUESE

IV. PUNESIMI 29

V. ZHVILLIMI EKONOMIK 34
V.1 Prirjet e Zhvillimit te Biznesit ne Rajonin e Tiranes
V. 2 Bujqesia
V. 3 Industria
V. 4 Zhvillimi i Biznesit Privat

VI. MJEDISI I BIZNESIT (VROJTIMI I BIZNESEVE TE TIRANES) 52
VI.1 Metodologjia
VI.2 Analiza e Rezultateve

VII. PARKU INDUSTRIAL I TIRANES 61
VII. 1 Paraqitje e Pergjithshme
VII. 2 Statusi Juridik i Zones Industriale
VII. 3 Kerkesa nga Firmat Lokale dhe Investitoret e Huaj
VII.4 Planifikimi Operacional Urban dhe Kerkesat Teknike te Parkut Industrial
VII. 5 Kerkesat e Planifikimit
VII. 6 Rezultatet

VIII. MBIJETESA EKONOMIKE E PARKUT INDUSTRIAL 74
VIII. 1 Koncepti i Pergjithshem i Biznesit
VIII. 2 Analiza e Aftesise Mbijetuese: Komente Metodologjike

IX. INTEGRIMI I ZONAVE SATELITE PERRETH QYTETIT TE TIRANES 79
IX.1 Situata Aktuale
IX.2 Prirja e Parashikuar e Zhvillimit

X. VENDI DHE ROLI I QEVERISE VENDORE NE ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL 80
X. 1 Decentralizimi i Metejshem i Pushtetit Vendor dhe Riorganizimi i tij per Rajonin e Tiranes
X. 2 Zhvillimi Ekonomik ne Nivel Lokal
X. 3 Pavaresia Financiare e Pushtetit Vendor

XI. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME KRYESORE 89

HYRJE

Gjate periudhes 1990-1999, Rajoni i Tiranes ka pesuar ndryshime te medha, te cilat kane formuar edhe specifika te zhvillimit te ardhshem te ketij rajoni te rendesishem. Tirana eshte kryeqyteti i vendit, ku jane te perqendruara administrata qendrore e shtetit, institucionet arsimore, kulturore dhe shendetesore kryesore te vendit.

- ne Tirane banon rreth 20% e popullsise se vendit;
- Tirana siguron 50-55% te te ardhurave te buxhetit te shtetit;
- konsumohet rreth 40% te energjise elektrike te vendit;
- realizohen 40-50% e ndertimeve te reja ne rang vendi;
- eshte tregu me i madh i vendit;
- jane perqendruar institucionet financiare e bankare kryesore te vendit;
- eshte ne qender te vendit dhe nepermjet arterieve te komunikacionit lidhet me gjithe vendin.

Te gjitha keto dhe parametra te tjere e vendosin Tiranen ne fokusin qendror te zhvillimit ekonomik te vendit.

Eshte e qarte se, qe ky rajon te mund te ece paralelisht me ndryshimet e shpejta ne mjedisin e pergjithshem ekonomik, duhet qe te ekzistoje nje vizion dhe objektiva te qarta strategjike. Hartimi i politikave ekonomike per zhvillimin e rajonit te Tiranes eshte pjese e nje strategjie me te gjere zhvilluese, e cila duhet te kete si synim harmonizimin e te gjitha politikave per krijimin e nje mjedisi te qendrueshem te rritjes ekonomike.

Qellimet kyçe te politikave ekonomike per Zhvillimin e rajonit te Tiranes jane:

- **Forcimi i bazes ekonomike dhe krijimi i nje ekonomie lokale me te fuqishme, me te gjere dhe te qendrueshme, duke maksimizuar mundesite per punesim dhe duke krijuar ambient te pershtatshem per zhvillimin e bizneseve.** ***Ketij synimi i sherben edhe propozimi per krijimin e nje zone (parku) industrial ne rajonin e Tiranes.***

- **Zhvillimi i nje rajoni, i cili te mund te perballoje sfidat dhe mundesite qe ofrojne teknologjite e reja, te mund te bazohet ne asetet e veta natyrale dhe te krijoje nje ambjent konkurence te shendoshe.**

- **Perballimi i sfidave te zhvillimit (infrastruktures, modelit te perdorimit te tokes, etj.) ne terma afat-shkurter qe vijne nga shtimi i popullsise, si pasoje e migrimit te jashtezakonshem drejt Tiranes, si dhe pergatitja per te qene nje metropol me kapacitet te fuqishem ekonomik (Tirane-Durres).**

Aspektet e rendesishme te ketyre politikave ekonomike do te ishin:

CILESIA E JETES, e cila lidhet ne radhe te pare me ruajtjen e mjedisit te rajonit. Konsideratat dhe shqetesimet per mjedisin e rajonit te Tiranes kane filluar te marrin rendesi te veçante dhe do te rriten edhe me shume ne te ardhmen, duke ndikuar ne marrjen e vendimeve per vendet ku do te vendosen firmat e ndryshme prodhuese.

POZICIONI KONKURUES: Pozicioni i Tiranes, duke qene njekohesisht kryeqendra e vendit, eshte pozicion me rendesi strategjike dhe, politikat ekonomike duhet te reflektojne pikerisht kete fakt.

SEKTORI I SHERBIMEVE: Eshte shume e rendesishme qe Tirana te ruaje dhe konsolidoje kapacitetin e vet prodhues dhe ofrues sherbimesh. Ne te njejten kohe, kjo do te ndihmonte edhe

ne hapjen e vendeve te reja te punes, duke ulur keshtu numrin e te papuneve ne rajon. Prioritet per rajonin e Tiranes eshte krijimi i vendeve te punes te cilesise se larte, qe kerkojne punonjes te kualifikuar dhe pagese te mire. Per kete, eshte e nevojshme qe te promovohen sektore te veçante te sherbimeve dhe prodhimeve qe angazhojne fuqi punetore.

SHERBIMET E BIZNESIT: Burimi kryesor i kerkeses per sherbime te biznesit jane vete bizneset, d.m.th. bizneset qe ushqejne njera-tjetren. Prandaj, eshte e nevojshme qe te zhvillohen dhe te zgjerohen sherbimet e cilesise te larte per bizneset, gje qe do te sjelle me shume te ardhura per rajonin.

SHERBIMET FINANCIARE: Tirana eshte padyshim qendra me e madhe financiare ne Shqiperi. Ne te kane selite 14 bankat e nivelit te dyte qe operojne ne vend. Eshte krijuar dhe po vazhdon te forcohet nje infrastrukture bankare e perbere nga nje pjese e konsiderueshme kapitali te huaj bankar. Synimi eshte qe ky pozicion, si nje qender financiare, te zhvillohet me tej, duke qene se sherbimet financiare jane nje element shume rendesishem i zhvillimit ekonomik ne pergjithesi.

INDUSTRI E BAZUAR NE NJOHURI DHE TEKNOLOGJI: Tirana ka nje kapacitet te padiskutueshem arsimor dhe akademik, i cili eshte njekohesisht nje burim qe duhet inkurajuar me tej ne drejtim te zhvillimit te teknologjise dhe mbajtjes se saj ne nivelet te zhvillimit bashkekohor.

TRANSPORTI DHE INFRASTRUKTURA: Rritja e shpejte ne perdorimin e informacionit dhe teknologjise se komunikimit eshte nje çeshtje se ciles duhet t'i kushtohet rendesi e veçante. Transporti eshte gjithashtu nje element i rendesishem; Tirana eshte nyje e komunikimit per Shqiperine. Linjat e transportit duhen zhvilluar me tej, duke ruajtur pozicionin konkurues te Tiranes si dhe duhet te synojne permiresimin e cilesise se jetes se qytetareve te saj.

Studimi i paraqitur ne kete material, mbi politikat ekonomike te zhvillimit te rajonit te Tiranes, u krye bazuar ne nje njohje te gjere te ketij rajonit, njohje e cila mbeshtetet si ne pervojen e specialisteve te fushave te ndryshme qe punojne ne Qendren Shqiptare per Kerkime Ekonomike, ashtu edhe ne mendimet dhe opinionet, permes debateve dhe diskutimeve, te shume prej specialisteve me te mire te rajonit te Tiranes. Studjuesit u bazuan ne nje numer te madh materialesh te grumbulluara nga burime te ndryshme, ku si me kryesoret mund te permenden INSTAT, Bashkia e Tiranes, Ministria e Tregtise dhe e Bashkepunimit Ekonomik, Ministria e Transporteve, Ministria e Puneve Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit, KESH, Ministria e Ekonomise Publike dhe e Privatizimit, AKP, institucione te tjera qendrore dhe mjaft burime te tjera. Gjithashtu, nje baze e mire per kete studim ka qene pjesemarrja ne projekte te ngjashme kombetare dhe nderkombetare e disa prej studjuesve pjesemarres, si dhe literatura e gjere bashkekohore e grumbulluar prej tyre gjate pjesemarrjes ne keto projekte.

Baze per trajtimin e studimit ishte analiza e gjere e gjendjes aktuale te infrastruktures teknike dhe sociale te rajonit te Tiranes. Nje vemendje me e veçante iu kushtua analizes se zhvillimit te biznesit ne zona te ndryshme te rajonit, i ndare sipas degeve te aktivitetit, madhesise se bizneseve dhe pozicionit gjeografik te zones perkatese. Me tej, per nxjerrjen e perfundimeve u perdor metoda krahasuese statistikore e te dhenave, duke bere edhediferencimet perkatese.

Perfundimet dhe rekomandimet e dhena nga grupi i studimit jane diskutuar edhe me specialiste te niveleve te ndryshme, jo vetem per te pare mundesine e zbatimit te tyre ne praktike, por edhe per te terhequr mendimet dhe opinionet e nje baze me te gjere, praktikisht te atyre qe te ndeshen perdite me problemet ne fjale.

Ne keto kushte, gjykohet dhe besohet se perfundimet dhe rekomandimet e dhena jane te bazuara dhe te realizueshme ne praktike, pasi ato mbeshteten ne nje njohje te gjere te realitetit ekonomik te rajonit te Tiranes dhe ne shkembimin e frutshem te mendimeve mes specialisteve te ndryshem, eksperte te fushave perkatese'.

'SHENIM: Ky material perfaqeson nje pune qe duhet dhe do te vazhdoje ne te ardhmen. Autoret mirepresin çdo sugjerim koment apo rekomandim te specialisteve te ndryshem

I. VESHTRIM I PERGJITHSHEM

Per nga niveli i popullsise, Tirana eshte sot qyteti me i madh i Shqiperise dhe qendra me e madhe ekonomiko administrativo-shteterore, arsimore, kulturore, shkencore dhe shendetsore e vendit. Ajo eshte nje nyje lidhese midis rajoneve veriore, verilindore, jugore dhe juglindore te Shqiperise.

I.1 Pak histori

Ne krahasim me disa qytete te tjera te vendit, Tirana si qytet eshte relativisht nje qytet i ri. Si vit themelimi i qytetit merret viti 1614, vit kur nga Sulejman Pashe Bargjini u krijua berthama e pare e qytetit, si fillim nje xhami, nje banjo popullore dhe nje furre buke. Por, gjurmimet arkeologjike te zbuluara, siç eshte mozaiku i Kishes se Kroit te Shengjinit i shekullit te IV te eres sone, si dhe gjetje te tjera arkeologjike me te hereshme, tregojne se kemi te bejme me nje vendbanim te lashte, mbi te cilin eshte ndertuar ky qytet.

Ne fund te shekullit XVII Tirana numeronte 4 mije banore. Ne vitin 1920 Tirana shpallet kryeqytet i Shqiperise dhe ne ate kohe kishte nje populsi prej 17 mije banore. Pas ketij viti, Tirana shnderrohet ne qendren me te fuqishme politiko-administrative te vendit dhe, me kalimin e viteve, u be qyteti me i madh i Shqiperise duke arritur ne vitin 1990 nje populsi prej 250 mije banore. Si rezultat i ndryshimeve te medha qe kane ndodhur ne kete periudhe tranzicioni, aktualisht Tirana ka nje populsi prej 416.016 banore[1].

I.2 Pozicioni Gjeografik

Tirana shtrihet ne skajin juglindor te fushes me te njejtin emer, pothuajse ne qender te territorit te vendit me gjeresi gjeografike veriore 41° 19'31" dhe gjatesi gjeografike lindore 19° 48'45", lartesi mbi nivelin e detit 110m, e rrethuar nga kodra te ulta ne rreze te malit te Dajtit, maja me e larte e te cilit eshte 1612m. Lartesia e qendres se qytetit mbi nivelin e detit eshte 110 m.

Qyteti i Tiranes ben pjese ne rrethin me te njejtin emer, i cili perfshin edhe tre qytete te tjera: Vore, Kamez, Krrabe si dhe 18 komuna me 163 fshatra.

Siperfaqja e pergjithshme e rrethit eshte 1238 km^2, nga te cilat qyteti ze 31 km^2. Gjatesia e vijes se pergjithshme te kufirit eshte 259 km. Ajo kufizohet ne perendim me rrethin e Durresit (57 km), ne lindje me rrethin e Matit (76 km), ne veri me Krujen (63 km) dhe ne Jug me Elbasanin (63 km). Ne anen jugore te qytetit shtrihet Parku i Madh Kombetar me nje siperfaqe 55 ha, ne qender te te cilit ndodhet Liqeni Artificial.

Qyteti pershkohet nga lumi i "Lanes", qe kalon mespermes qytetit. Gjithashtu, ne rajonin e Tiranes ndodhen 3 lumenj te tjere, lumi i Erzenit (brenda rrethit te Tiranes ka 65 km), lumi i "Tiranes" (Reglates) (51 km) dhe lumi Terkuza (30 km). Liqenet kryesore jane Liqeni Artificial i Tiranes (0.4 km^2 dhe thellesi 12.5m) dhe ujembledhesi i Farkes (0.7 km dhe thellesi 27.1 m).

Korridori Tirane-Durres eshte nje zone me rendesi te madhe ekonomike. Kjo per arsye se zona eshte e lokalizuar ne qender, ka lehtesi lidhjeje me aeroportin nderkombetar te Rinasit (rreth 25 km) dhe me portin e Durresit (rreth 40 km).

Shpenzimet per permiresimin e infrastruktures ne korridorin Tirane-Durres kapin shumen prej 140 milione dollare ne vit, duke ofruar mundesi te medha per kontraktoret dhe furnizuesit. Permiresimi i rruges kryesore perfshin: lidhjen kryesore lindje-perendim nga Durresi ne Elbasan dhe Pogradec drejt kryqezimit kufitar me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe Greqine, rruga kryesore

veri-jug nga Shkodra ne Durres dhe Fier, drejt kufirit me Greqine; dhe nje rruge dyfishe qe lidh Tiranen me Durresin. Suksesi i kesaj zone per terheqjen e investimeve do te varet shume nga politikat dhe masat e marra nga Bashkite e qyteteve te Tiranes dhe te Durresit, lidhur me planifikimin dhe zhvillimin e qyteteve, modelin e perdorimit te tokes dhe promovimin.

Klima eshte mesdhetare, me dimer te bute dhe vere te thate. Temperatura mesatare vjetore eshte 15.3°C. Muaji me i nxehte i vitit eshte korriku me nje temperature mesatare 23.5°C dhe nje maksimum te arritur me 41.3°C. Muaji me i ftohte eshte janari me temperature mesatare te regjistruar prej 6.8°C dhe nje minimum prej -9.9°C.

Rreshjet e shirave kane nje shperndarje jo te rregullt gjate gjithe vitit me intensitet me te larte ne muajt tetor-nentor. Sasia mesatare vjetore e rreshjeve eshte 1247 mm. Ererat mbizoteruese jane ato me drejtim juglindor dhe veriperendimor.

Ne pergjithesi, rajoni i Tiranes karakterizohet nga dukurite atmosferike te meposhtme:

Shpejtesia mesatare disavjeçare e regjimit te ererave jepet ne vlerat e meposhtme: pranvere -1.8 m/sek., vere -1.7 m/sek., vjeshte -1.5 m/sek., dimer -1.7 m/sek.

Pasqyra 1. Te dhena per Tiranen

Presioni atmosferik	1015 milibar
Lageshtia relative	72%
Dite te kthjellta	153
Dite pjeserisht te vraneta	150
Dite te vraneta	62
Dite me shi	101
Dite me shi-bresher	11
Dite me mjegull	10

Relievi i rajonit te Tiranes pergjithesisht eshte kodrinor malor. Ai ngrihet drejt lindjes dhe ulet ne drejtimet e tjera. Pjesa e rrafshte e territorit perben 37% te siperfaqes gjithsej, me nje pjerresi qe arrin ne 5%. Siperfaqja e rrethit prej 123.849 ha ka kete strukture: toke bujqesore 31.445 ha, livadhe e kullota 7628 ha, pyje 49221 ha dhe toka jobujqesore (troje) 35.555 ha.

Ne saje te gershetimit te klimes mesdhetare dhe asaj kontinentale nga njera ane, dhe orografise mjaft te ndryshueshme nga ana tjeter si dhe shkembit amnor here gelqeror, serpentin apo flysh, ne rajonin e Tiranes rritet nje bimesi mjaft e pasur me lloje te shumta, me rreth 16 mije specie, shifer kjo mjaft e larte ne krahasim me siperfaqen tokesore te kesaj treve. E gjithe kjo pasuri floristike, qe perben gjysmen e llojeve te flores sone, e karakterizuar nga dendesia, forma, ngjyra, lloje te ndryshme etj., ndikon shume si ne aspektin e zhvillimit ekonomik ne pergjithesi, ashtu edhe ne ate shendetesor dhe zbukurues, duke e bere qytetin e Tiranes te cilesohet per gjelberimin e tij tradicional.

Duke marre per baze shumellojshmerine e flores se Tiranes si dhe perdorimin e saj mjaft te gjere ne ekonomi, dallojme kete ndarje bimesie sipas vlerave te saj te dobishme ekonomike: bime ushqimore (115 lloje), bime vitaminoze (146 lloje), bime foragjere (45 lloje), bime mjekesore (78 lloje), bime mjaltore (72 lloje), bime ngjyruese (53 lloje), bime tekstile (36 lloje), bime taninoze (28 lloje), bime vajrash etenike (21 lloje), bime vajore (17 lloje), bime celuloze per leter (17 lloje). Duke marre per baze shperndarjen vertikale te bimesise, rrethi i Tiranes perfshihet ne 4 zona bimesie, duke filluar nga formacioni i makja shibljakut e deri tek kullotat alpine, duke bere qe variacioni i bimesise te jete mjaft i theksuar.

Pasqyra 2. Struktura . siperfaqes se tokes ne rrethin e Tiranes (ne ha)

Emertimi	1994	1995	1996	1997	1998
Siperfaqja	123.849	123.849	123.849	123.849	123.849
Siperfaqja bujqesore	33103	29845	29845	31445	31445
Toke are	23314	22328	22328	22728	22728
Pemishte	3173	1275	1275	2475	2297
Ullishte	4458	4417	4417	4417	3817
Vreshta	2158	1825	1825	1825	1695
Livadhe e kullota	7618	7618	7628	7628	7628
Pyje	49120	49120	49221	49221	49221
Toka jo bujqesore (troje)	34008	37266	37155	35555	35555

I. 3 Toka

Rajoni i Tiranes renditet ne 8 rrethet kryesore te Shqiperise per nga toka e kultivuar, duke patur rreth 5% te tokes bujqesore ne rang vendi. Ne rajonin e Tiranes gjenden pothuajse 60% e tipeve tokesore te identifikuara dhe te klasifikuar ne shkalle vendi. (Shih tabelën e mësipërme)

Persa i perket struktures se fondit te tokes bujqesore te studjuar (rreth 97% e siperfaqes se tokes bujqesore), ajo perbehet ne 91% nga toka zonale dhe vetem 9% nga toka azonale. Ne baze te nomenklatures ekzistuese te sistemit kombetar te klasifikimit, i cili ne thelb eshte gjenetiko gjeografik, dhe te skemes se perafrimit me sistemin e tokave te FAO – UNESCO, ne rrethin e Tiranes gjenden keto tipe tokash:

A. Toka zonale

Te murme pyjore (Cambisols +Leptosols +Nitosols)[2]

Te kafejta (Cambisols +Luvisols +Nitosols +Phaeozoms)

Te hinjta kafe (Cambisols +Luvisols +Nitosols + Phaeozoms)

B. Toka azonale

Aluviale (Fluvisols +Arenosols +Regosols)

Tokat e hinjta kafe zene gati te gjithe siperfaqen e kodrave dhe nje pjese te zones fushore. Ato shtrihen deri ne afersi te shpateve te uleta malore te periferise se rajonit dhe perbejne rreth 4/5 e siperfaqes se tokes bujqesore. Tokat e kafejta zene pjesen me te larte te kodrave dhe shtrihen deri ne lartesite 900 – 1.000 m mbi nivelin e detit. Keto toka shpesh ndodhen ne kushtet e nje relievi shume heterogjen, me shpate te pjerreta. Tokat e murrme takohen ne forme brezi tokesor mbi tokat e kafejta deri ne lartesite 1.600 – 1.700 m mbi nivelin e detit. Jane toka ne nje faze tranzitore zhvillimi. Mjedisi natyror ku zhvillohen keto toka eshte relievi kryesisht malor, klima mesdhetare paramalore me lageshti dhe vegjetacion pyjor. Ne pergjithesi, keto toka perdoren per pyje. Ne kete brez tokesor gjendet parku kombetar i Dajtit, i cili eshte vleresuar si nje nga parqet kryesore te Shqiperise. Tokat aluvionale gjenden ne zonat qe i nenshtrohen permbytjeve te shpeshta nga ujrat e lumenjve te rrjetit hidrografik te Tiranes. Karakteristika kryesore dalluese e tyre eshte ndryshimi i tekstures (rendesimi i saj) sipas mases se kalimit nga rrjedha e siperme ne ate te poshtme dhe nga shtrati i lumit ne brendesi te zones se hidro-akumulimit te aluvioneve. Gjithashtu, ato dallohen nga profili humusor jo i rregullt.

Nga nje vleresim pergjithesues i te dhenave studimore agropedologjike rezulton se, fondi i tokes bujqesore te rajonit te Tiranes perbehet nga rreth 40% toka me permbajtje mesatare dhe te larte te humusit, rreth 50% toka me perberje mekanike subargjilore te mesme (lymore, ranore, argjilo-lymore), ku tokat argjilore zene rreth 27%. Tokat zallishtore dhe gushtore zene rreth 2%; ato subranore dhe ranore rreth 1% dhe tokat acide rreth 9% te siperfaqes se pergjithshme. Ne shumicen e tyre ato kane status te mire te pjellorise.

I. 4 Pasurite Minerare

Ndertimi gjeologjik i rrethit te Tiranes ofron disa lloj mineralesh, te cilat shpesh kane rendesi praktike. Nder mineralet kryesore permenden: qymyret, boksidet, qymyret uranmbajtese dhe galiummbajtese, tufet, guret per veshje.

Pasqyra 3. Rezervat e Pellgut te Tiranes

Vendburimi	Fuqi Kalorifike	Rezervat (000 ton)		
		Te projektuara	Pa projekt	Gjithsej
Krraba	4200	3192	500	3692
Mushqeta	3000	6692	300	6992
Priske	3960	4421	2750	6971
Mezez	3500	12542	-	12542
Dom Berxull	2500	-	21200	21200
Valias	2800 3900	76365	-	76365
Nikel	2300 3900	58874	-	58874
Larushk	2300 3900	-	41300	41300
Rinas	2000	-	243050	243050
Kamez-Babrru Aramenas	2300 3900	-	36000	36000
Tirana		161886	345100	506986

[2] *Ne kllapa jane shenuar tokat sipas nomenklatures se FAO - UNESCO*

gelqeroret, argjilat, rerat kuarcore, materialet inerte, gips, etj. Pellgu i Tiranes eshte konsideruar zona qymyr-mbajtese me e madhe e vendit.

I.4.1 Kushtet Tekniko - Minerare te Pellgut

- Tavani dhe dyshemeja e shtresave te qymyrgurit ndertohen nga argjila dhe argjila devraltike, qe karakterizohen nga tregues te ulet te vetive fiziko-mekanike;
- Shtresat e qymyrit kane fortesi me te madhe se ato te shkembinjve rrethues dhe ndryshon nga 1 deri ne 1.8;
- Tektonika e madhe eshte pak e zhvilluar, kurse mikroteknika (e pas mineralizimit) eshte e zhvilluar;
- Ka kushte te ndryshme hidrogjeologjike per shfrytezim. Krahet kane kushte disi te mira, kurse qendra ka kushte shume te veshtira.

Nga minierat e qymyrit jane mbyllur ajo e Valiasit dhe e Mezezit dhe vazhdojne prodhimin me kapacitet te reduktuar minierat e Mushqetase dhe e Pellumbasit (Priska e Madhe). Qymyret uranmbajtese dhe galiummbajtese ndodhen ne Fushen e Dajtit, por nuk jane shfrytezuar si per shkak te mungeses se teknologjise, ashtu edhe per arsye te mundesise se ndotjes ne parkun e madh natyror te Dajtit.

Rezerva boksidesh, kryesisht hekurore, jane zbuluar dhe shfrytezuar pjeserisht ne fushen e Dajtit dhe pergjate rruges nga Fusha e Dajtit ne Priske. Minierat kane qene ne shfrytezim vetem per eksport ne tregun e jashtem, sepse ne vend nuk ka teknologji per perpunimin e boksideve. Tufet jane shtresa qe permbajn kalium. Ne zonen e Vrapit jane zbuluar rezerva qe mund te perdoren ne fabrikat e çimentos, por qe deri tani nuk ka ndonje vleresim ekonomik per t'i vene ne shfrytezim.

Guret gelqeror kane perhapje mjafte te gjere ne Malin e Dajtit si dhe ne gelqeroret e rrezuar te Priskes. Ne qafen e Priskes, gelqeroret jane pak te mermerizuara dhe mund te perdoren per pllaka veshje. Gelqerore te tjere mund te perdoren ne ndertim dhe per prodhimin e gelqeres, si dhe si lende e pare per prodhimin e çimentos. Argjilat jane mjaft te perhapura ne zonen e Zallherrit dhe te Ura e Farkes. Por, argjilat me te mira per prodhimin e tullave jane ato te tokave te Fushe Tiranes, ku jane ndertuar edhe fabrikat perkatese.

Rerat kuarcore jane te perhapura ne kodrat lindore te qytetit te Tiranes. Deri tani jane te studjuara rerat e Shkozes dhe ato ne afersi te Priskes, te cilat pas nje pasurimi te thjeshte jane perdorur dhe mund te perdoren ne fonderi. Rrerat e tjera, kryesisht ato me ngjyre bezhe, mund te perdoren shume mire ne ndertim. Materialet inerte (rera, zhuret, zhavoret) jane te perhapura ne luginen e lumit te Erzenit dhe te Tiranes, ku edhe jane ngritur impjante per shfrytezimin e tyre.

II. GJENDJA INFRASTRUKTURORE E RAJONIT TE TIRANES

II. 1 Infrastruktura teknike

II.1.1. Rrjeti elektrik dhe telefonik

Sistemi elektroenergjetik shqiptar vitet e fundit po ndeshet dhe perballon me veshtiresi nje sere problemesh qe vijne sidomos nga ndryshimet ne zhvillimin social-ekonomik te vendit dhe nga zhvendosja masive e popullsise drejt qyteteve kryesore, e sidomos drejt Tiranes. Ne keto vitet e fundit konsumi i energjise elektrike eshte rritur mbi dy here dhe ritmet e rritjes jane mjaft te larta. Psh., ne qytetin e Tiranes rritja e konsumit te energjise elektrike nga nje vit ne tjetrin eshte rreth 20%. Nga perllogaritjet e bera me rezerve, pas 10 vjetesh konsumi i energjise elektrike do te jete sa dyfishi i sotem, gje qe eshte krejtesisht e paperballueshme.

Rajoni i Tiranes eshte konsumatori me i madh i energjise elektrike ne vend. Ne dy vitet e fundit 1998, 1999 Tirana ka perdorur respektivisht 14,4% dhe 19,8% te energjise elektrike te konsumuar ne vend. *Te dhena te metejshme jepen ne pasqyren 1 tek Aneksi.*

Pasqyra 4. Prodhimi i energjise elektrike

Vitet	Prodhimi i energjise elektrike *(milione Kwh)*
1950	21
1960	194
1970	952
1980	3717
1985	3147
1990	3198
1998	5793
1999	5400

Pasqyra 5. Struktura e konsumit te energjise elektrike ne rang vendi (KWh)

Emertimi	1985		1990		1995		1996	
	Sasi	%	Sasi	%	Sasi	%	Sasi	%
Industri	1357,7	62,0	1463	53	503,5	25	548.8	24
Bujqesi	208,9	9,5	333,8	12	39,1	1.9	46.2	2
Tregti dhe Trafik	55,3	2,5	82,6	2,9	30,3	1.5	67.9	3
Popullsia	193,1	8,8	292,0	10,5	882,5	43	1093.4	47
Tjere perdorues	364,9	16,7	593,3	21	567,3	28	551.8	24
Gjithsej	2179,8	100	2764,8	100	2024.7	100	2308.1	100

Burimi: KESH

Nga studimi i te dhenave te pasqyres se mesiperme arrihet ne disa perfundime:

- Konsumi i energjise elektrike qe perdoret per veprimtari prodhuese ka tendence ne ulje, jo vetem ne krahasim me 1985, kur ekonomia funksionone te themi "normalisht", por edhe gjate viteve te tranzicionit. Nje dukuri e tille shpjegohet me lidhjen e drejperdrejte te ecurise se ekonomise dhe te reformave te tranzicionit.
- Rritja e konsumit te energjise elektrike ne sasi dhe ne perqindje per nevoja te popullsise shpjegohet me faktoret e meposhtem:

a. pajisjen me ritme te shpejta te popullsise me pajisje elektro-shtepiake (soba per gatim, lavatriçe, boliere, kondicionere, etj., qe perdorin energji elektrike.

b. Ndryshimi i struktures se ngrohjes se banesave duke zevendesuar sobat me dru zjarri e qymyrguri me soba e ngrohesa qe perdorin energji elektrike.

Aktualisht, eshte veshtire te thuhet se sa energji elektrike shkon per ngrohje: megjithate nepermjet llogaritjeve te terthorta mund te arrihet ne shifra te peraferta. Per te krijuar nje ide se ç'pjese e energjise elektrike perdoret per ngrohje, eshte bere krahasimi i konsumit te energjise elektrike gjate muajve me te ftohet me muajt me te ngrohte te vitit. Ne shkalle vendi per vitin 1996, jane keto te dhena per konsumin e pergjithshem te energjise elektrike:

Konsumi i energjise elektrike per muajt janar, shkurt, dhjetor 1.743.556kwh

Konsumi i energjise elektrike per muajt qershor, korrik, gusht	1,107.707 kwh
Diferenca ne shifer absolute	635.849 kwh
Diferenca ne perqindje	36.5%

Te dhenat per vitet 1998-1999 per rajonin e Tiranes paraqiten ne pasqyren 2 tek Aneksi.
Analiza e te dhenave jep mundesi te nxirren perfundimet e meposhtme:

- Populisia e rajonit te Tiranes ne dy vitet e fundit 1998-1999 (sipas Zyres se gjendjes civile) u rrit 6.3%, ndersa konsumi i pergjithshem i energjise elektrike u rrit 22.1 %. Nga ana tjeter, energjia elektrike qe konsumon populisia eshte rritur 29.7%, pra me nje ritem me te larte;
- Raporti i konsumit te energjise elektrike qytet-fshat per te dy vitet eshte 78-49% me 22-21%, respektivisht midis qytetit dhe fshatit;
- Duke bere diferencat e konsumit te energjise elektrike te tre muajve te dimrit me ato te veres rezultojne keto raporte:

	1998	1999
1. Konsumi me teper i E.E ne teresi ne %	55	40
a. qytet	46.6	44.4
b. fshat	17	21
2. Konsumi me teper i E.E. i popullates		
a. qytet	17	17.9
b. fshat	20	21.5

Siç shihet nga te dhenat, sasia e energjise elektrike qe perdorin bizneset, administrata e institucionet shteterore, sherbimet publike gjate dimrit shume me e larte sesa sasia qe konsumon populisia. Qe ketej rrjedh se, aktivizimi i ngrohjes qendrore me kaldaja i institucioneve te ndryshme do te ndikonte ne lehtesimin e ngarkeses se rrjetit elektrik ne periudhen e pikut. Nderkohe, nuk duhet nenvleftesuar edhe ngrohja qendrore per blloqet e reja te banesave qe do te ndertohen ne te ardhmen.

Ne kushtet e reja, rrjetet e transmetimit dhe te shperndarjes, jo vetem qe nuk arrijne te sigurojne nevojat ne rritje te populisise dhe te bizneseve, por gjithnje e me teper po behen pengese per realizimin e investimeve qe kerkojne energji elektrike, gje qe eshte me pasoja te renda per zhvillimin social-ekonomik.

Sipas studimeve te kryera nga KESH-i gjendja dhe shqetesimet e rrjetit shperndares te rajonit te Tiranes paraqitet si me poshte:

- Zhvillimi i rrjetit elektrik te rrethit te Tiranes eshte bere duke u mbeshtetur me studimet e kryera per kete qellim. Ne perputhje me zhvillimet reale te ngarkesave elektrike jane bere dhe korrigjimet perkatese.

Burimi kryesor i furnizimit me energji elektrike i qytetit dhe rrethit te Tiranes jane nenstacioni 220/110/35 Kw dhe 220/20 Kw. te cilet e marrin energjine nga rrjeti 220 Kw. Nga zbarat 110 kv te nenstacionit 220/110 kw dalin dy linja 110 kw, qe e qarkojne qytetin dhe furnizojne dy nenstacionet 110 kv Selite dhe Traktora. Nje linje radiale furnizon nenstacionin 110/20 kw Qender.

Ne kushtet normale te punes. transformatoret 220/110/35 kwne oret e pikut te ketij dimri kane rezultuar te ngarkuar mbi ngarkesen nominale. ndonese ka vetem nje vit qe eshte vene ne pune nenstacioni 220/110 kw i Sharres. qe furnizon rrethin e Durresit. Per kete. eshte ndryshuar skema duke futur gjenerimin e HEC Shkopet vetem per furnizimin e Tiranes. Dalja jashte pune e njerit prej autove do te shkaktonte probleme mjaft serioze per furnizimin e rajonit. pasi do te ishin te detyruara vendosja e kufizimeve te thella. Rrjeti elektrik 110 kw eshte ne kushte normale pune. por rezervimi i nenstacioneve nuk mund te behet.

Persa i perket rrjetit 35 kw. ai eshte i ngurtesuar dhe nuk mund te behet asnje rezervim nga unazat. Problematik eshte rrjeti 35 kv ne drejtimin Tirane. Mezez. Valias e Vore. ku behen kufizime te thella per shkak te kapacitetit kufizues te traktit te pare te linjes 35 Kw. Nenstacionet burim te TM 6 dhe 10 kw jane pothuaj te gjithe te mbingarkuar. Gjate diteve te dimrit behen

kufizime pothuaj ne çdo nenstacion. Kufizimi i pergjithshem eshte rreth 30 MVA.

Duke patur parasysh edhe defektet e shumta ne rrjetin e amortizuar 6-10 kv kushtet e furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve qe furnizohen nga ky rrjet jane mjaft te keqia, ndersa nenstacionet burim i tensionit 20 kw jane ne kushte te mira pune. Futja e nenstacionit 110/20 kw Qender ka bere te mundur pergjysmimin e disa fiderave 20 kw te ngarkuar ne kufijte nominale dhe shtimin e kabinave te reja 20 kw. Nga rrjeti 20 kv furnizohet rreth 1/3 e konsumatoreve te rrethit te Tiranes.

Duke u nisur nga sa trajtuam me siper nderhyrjet emergjente duhen te realizohen kryesisht per te eleminuar kufizimet e medha. Per kete, duhet avancuar kalimi gradual i ngarkeses nga rrjeti 6-10 kw ne rrjetin 20 kw.

- Eshte percaktuar fuqizimi i nenstacionit 110/20 kw U. Traktori, duke instaluar nje transformator me fuqi 40 MVA ne vend te transformatorit ekzistues me fuqi 16 MVA, si dhe faza e pare e ndertimit te nenstacionit 110/20 KW Kashar. Instalimi i Transformatorit me fuqi 40 MVA ne U. Traktori do te shoqerohet me shtrirjen e nje rrjeti kabllor rreth 20 km dhe 87 kabina 20/0.4 kw, nga te cilat 44 te reja. Investimet e pergjithshme per kete pakete arrijen 519 milione leke. Me keto ndryshime behet e mundur ulja e kufizimeve ne nenstacione dhe krijimi i nje skeme me elastike dhe me e sigurte per konsumatoret qe ushqehen nga rrjeti 20 kw. Gjithashtu, do te shtohen 3 fidera nga nenstacioni U. Traktori dhe 2 fidera nga nenstacioni Selite. Trasete e shtrirjes se ketyre fiderave jane arsyetuar ne logjiken per t'u futur ne zonat ne forme ishulli te rrjetit 6-10 kw brenda zonave te rrjetit 20kw. Ne zhvillimin e rrjetit 20 kw mbahen parasysh qe:

- te harmonizohet zhvillimi i rrjeteve shperndarese me aftesine transformuese te nenstacioneve;
- te shkeputen nga rrjeti 6-10 kv disa nga zonat me te renduara si "A. Demi", "M. Grameno", "Tirana e Re", "Laprake", duke bere te mundur eliminimin dhe shkarkimin e disa fiderave si 99,91 ne Traktora, etj.;
- te mbahet nje rezerve deri ne ngarkimin e plote te secilit fider, rreth 25% e aftesise transmetuese (dhe ngarkesave te lejuara), per te mundesuar lidhjen e kabinave te reja qe do te kerkohen. Per kete u caktua si kufi numri i kabinave ne nje linje (rreth 25). Megjithate, duhet permendur se ne kete faze nuk ezaurohen dot tere problemet, ne disa zona. Ky boshllek kerkon qe ne nje te ardhme te behen korrigjimet perkatese, nepermjet daljeve (fiderave te reja nga te 4 nenstacionet). Keshtu, mbeten te lidhura me tension 6-10 kw mjaft kabina te aferta me rrjetin 20 kw ne zonat "V. Shanto", ne qender (afer Bulevardit D. Kombit), ne Rr. "Hoxha Tahsim", Rr. "Kavajes" etj.

Nenstacioni i ri 110/20 kw Kashar do te sherbeje per te furnizuar me energji elektrike zonen me problematike te rrethit te Tiranes, siç eshte zona industriale me zhvillim intensiv ne anen perendimore te qytetit (ne te dy krahet e autostrades), zona e re urbane pergjate rrugeve te Durresit e te Kavajes, zona suburbane e Koder-Kamzes dhe Bathores, si dhe qyteti i Vores. Gjithashtu, ky nenstacion parashikohet te furnizoje zonat e dendura rurale qe aktualisht furnizohen nga nenstacionet problematike te Mezezit, Valisit dhe Vores. Aeroportin e Rinasit, etj., me nje investim te pergjithshem prej 957 milione leke.

Vendi i ndertimit te tij eshte percaktuar prane fshatit Yrshek, ne nje pozicion mjaft te favorshem si per mbulimin e ngarkesave te zones ashtu dhe per lidhjen ne rrjetin 110 kv.

- Per rrjetin 20 KW eshte menduar te dalin 7 fidera qe do te furnizojne zonat e siperpermendura.

Fideri Nr. 1 eshte teresisht kabllor si magjistral. Ai do te shtrihet paralel me autostraden, ne anen veriore te rruges. Ky rrjet do te furnizoje te gjithe perdoruesit ekzistues e te rinj, duke filluar nga nenstacioni, deri ne hyrje te Laprakes, afer kompleksit te banimit te "Karevan". Ne zhvillimet e ardhshme, ky fider mund te mbyllet ne unaze me nenstacionin 220/20 kw Tirane, nepermjet Laprakes.

Fideri Nr. 2 eshte pjeserisht kabllor, ne drejtim te zones se "Breg Lumit", deri ne afersi te nenstacionit 35/6 kw te U. Dinamo. Ne pjesen e pare, deri afer ktheses se Kamzes, linja do te jete kabllore. Me tej, ne anen veriore te hekurudhes ne kete fider do te lidhen nje varg kabinash

qe furnizojne zonen e Bregut te Lumit, perbri linjes hekurudhore deri ne nenstacionin 220/20kw Tirane, duke mbyllur furnizimin e dyanshem. Ne kete fider mund te perfshihen edhe nje sere kabinash ne afersi te Spitalit Ushtarak dhe U. Dinamo. Ky fider do te bashkohet me linjen e ndertuar pjeserisht kabllore, me dalje nga nenstacioni Tirana.

Fideri Nr. 3 do te zhvillohet ne drejtimin verior, duke perfshire perdoruesit e zones se Laprakes; Koder-Kamzes (perfshi U. Bujqesor) qytezen e Kamzes, deri ne zonen e bathores. Aktualisht, kabinat qe do te perfshihen ne kete fider furnizohen pjeserisht nga nenstacioni i Mezezit (fideri 104-109) dhe pjeserisht nga nenstacioni Valias. Ky fider mbyllet ne Koder-Kamez me linjen 20 Kw qe eshte ndertuar si magjistral, me dalje nga nenstacioni 220 kw Tirana.

Fideri Nr. 4 parashikohet te zhvillohet paralel me autostraden ne anen jugore te rruges, duke ndjekur trasene dhe perdoruesit qe jane furnizuar nga nenstacioni i Mezezit (fideri 108-110), deri ne afersi te Kombinatit Ushqimor e Frigoriferit. Ne kete fider do te lidhen kabinat e banesave te reja dhe objekteve social-ekonomike, qe jane ndertuar ne zonen perendimore te qytetit te Tiranes, deri ne afersi te qytezes se Kombinatit Tekstilit. Ne fazen fillestare eshte menduar qe rreth 50% e trasese te jete kabllore.

Fideri Nr. 5 eshte parashikuar te jete nje magjistral i fuqishem me seksion 150 mm2-AC, duke pershkruar hapesiren nga nenstacioni i ri (Kashar-Yrshek) deri ne Vore. Ky fier gjate trasese do te furnizoje kabina te vecanta, perbri autostrades ndonese ne fund do te konceptohet si nje qender shperndarese per Voren.

Fideri Nr.6 do te zhvillohet ne zonen rurale, ne anen veri-perendimore te autostrades.

Aktualisht, kabinat e kesaj zone furnizohen pjeserisht nga nenstacioni i Valiasit dhe pjeserisht nga nenstacioni i Vores. Ketu perfshihet pjesa fushore e zones se Berxulles. Radio Stacionit, F. Kasharit - Rinasi e deri ne fund te fshatrave te zones se Prezes.

Fideri Nr. 7 do te zhvillohet ne drejtimin jug-perendimor, ne zonen e Kodrave te Kasharit, deri ne Gjokaj afer Vores. Ky fider do te perfshije kabinat qe aktualisht furnizohen nga nenstacioni i Mezezit (fideri 101-107), si dhe perdorues te rinj qe po shfaqen ne zone.

Zhvillimi i rrjetit 20 kw te nenstacionit te Kasharit duhet te konsiderohet paraprak. Ai do te rivleresohet me tej gjate thellimit te studimit dhe do te konkretizohet me kryerjen e projekt-zbatimit dhe preventivave perkatese.

Realizimet e mesiperme mendohet te sjellin nje permiresim te dukshem te kushteve te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve te qytetit dhe rrethit te Tiranes. Duke i gjykuar keto te perfunduara, detyrimisht do te kete nje rritje te ngarkeses dhe problemet serioze do te shfaqen ne mbingarkimin e AT 220/110/35Kw. Sipas studimit te rajonit Tirane-Durres, ky problem zgjidhet me ndertimin e nenstacionit 220 Kw Durres dhe perdorimin e nenstacionit Sharre per Tiranen. Ne te kundert. duhet parashikuar fuqizimi i transformimit 220/20 Kw brenda rajonit te Tiranes sipas studimit perkates.

Se fundi. duhet theksuar se kerkesa per energji elektrike (energjia qe del nga zbarat e TM) per rajonin e Tiranes eshte rritur me rreth 42%. gjate periudhes dy vjeçare 1997-1999. Ajo ka qene 686 milione KWH ne vitin 1997 dhe 1.069 miliarde KWH per vitin 1999. Investimet qe duhet te kryhen per te perballuar keto ritme kaq te larta te rritjes se kerkeses per energji elektrike jane shume te medha. Mendohet se. veç investimeve ne kalimin e rrjetit nga 6-10 kw ne 20 kw. ne qytetin e Tiranes duhet te realizohen investime te rendesishme edhe ne drejtim te disiplinimit te perdorimit te energjise elektrike. Kjo do te kishte efekt si ne drejtim te rritjes se te ardhurave te KESH-it. ashtu dhe ne drejtim te kufizimit te ritmeve te rritjes se kerkeses per energji elektrike.

Mendohet se zgjidhje do te jete perfundimi i projektit te kalimit te Tiranes me rrjetin 20 kw. ndertimi i nje nenstacioni te ri 110/20 kw ne Kashar per te perballuar ngarkesat me 20 kV dhe te zonave ekonomike ne pjesen perendimore te Tiranes. si dhe disa zona te jera sidomos zona e bathores dhe e Vores. Kjo kerkon nje vellim pune mjaft te madh. Keshtu. vetem ne qytetin e Tiranes do te duhet te shtohen 35 km linja 29kw dhe 60 km linja 0.4 kw dhe 150 kabina transformimi 20/04 kw te reja dhe rikonstruksioni i mbi 200 kabinave ekzistuese per t'i kther nga 6 ne 20 kw. Ndersa. per zonat suburbane e rurale duhen 500 km linja ajrore 20 kw

dhe 3.000 km linja te TU me 250 kabina. Mendohet se kosto totale e ketij investimi mund te shkoje ne 25 milione dollare. Ne kushtet aktuale, zgjidhja me racionale do te ishte qe te punohej sa me pare ne disa drejtime si:

- **Zvogelimi i humbjeve te energjise elektrike te çdo natyre qofshin, duke arritur sa me pare ne nivelin e humbjeve teknike.**
- **Ndertimi i burimeve gjeneruese te linjave te nevojshme te transmetimit. Per kete, jo vetem qe duhet te kishte filluar dhe tani te ishte ne perfundim hidrocentrali i Bushatit, por duhet patjeter te fillohet ndertimi i hidrocentraleve ne lumin e Vjoses.**
- **Krahas hidrocentraleve, duhet qe ne nje kohe sa me te shkurter te ndertohet edhe nje TEC i fuqishem per rajonit e Tiranes, mundesisht qe te sherbeje jo vetem per prodhimin e energjise elektrike, por edhe per ngrohjen e popullsise. Ndertimi i TEC kushtezohet edhe nga lloji i lendes djegese qe do te perdore.**
- **Perdorimi i burimeve te tjera alternative per gatim dhe ngrohje si dhe rritja e efektivitetit te perdorimit te energjise elektrike ne familje, duke perdorur pajisje me rendiment te larte; ndertimi i apartamenteve te reja me kerkesa te larta termoizoluese; ndertimi i sistemit te ngrohjeve qendrore ne blloqet e reja qe do te ndertohen, etj.**

II. 1.2 Sistemi telefonik

Nga sistemi i meparshem Tirana trashegoi sistemin telefonik me te mire te vendit, por gjithsesi nje sistem krejtesisht te dobet dhe qe nuk plotesonte as minimumin e nevojave te qytetareve. Se bashku me kete sistem, Tirana trashegoi edhe premtimet e gjata per nje sistem te ri dhe per nje godine te re me pajisje moderne per telekomunikacion, godine qe edhe sot mjaft qytetare tiranas e dine se duhet te ishte, por qe nuk eshte ndertuar ende. Zhvillimi i vrullshem i qytetit, emigracioni i gjere, zhvillimi i bizneseve private dhe instalimi ne Tirane i shume misioneve nderkombetare bene qe sistemi i vjeter te mos perballonte asgje nga nevojat e qytetit. Ne keto kushte, eshte investuar ne zgjerimin dhe modernizimin e sistemit te nderlidhjes telefonike, duke e rritur gradualisht kapacitetin deri ne 60 mije numra telefonik, nga te cilet jane ne perdorim aktualisht mbi 50 mije.

Por, ne kushtet e rritjes se kerkesave konkrete per linja telefonike vihet re se mjaft nga kerkesat jane te paplotesuara, madje numri i sakte i tyre madje nuk mund te llogaritet, pasi biznesmene dhe sidomos qytetare te ndryshem i perserisin disa here kerkesat, duke menduar se ato kane humbur ne burokracine shteterore dhe me shprese se mund te plotesohen nje dite. Ne keto kushte, nga punonjesit e Telekomit te Tiranes vleresohet se numri i kerkesave aktualisht eshte rreth 150 mije, me prirje drejt rritjes. Eshte e kuptueshme qe abonentet familjare zakonisht kane nevoje per nje linje telefonike, ndersa nje numer i madh biznesesh kane nevoje per me teper se nje linje. Ne keto kushte, gjykohet se kerkesat per linja telefonike jane me te medha se sa vleresimi modest i administrates se Telekomit Tirane, duke arritur sipas vleresimit tone ne rreth 250 mije numra. Pra, eshte aktual kalimi i sistemit te telefonise se Tiranes nga sistemi peseshifror ne sistemin gjashteshifror, per te perballuar plotesimin e kerkesave qe siç e theksuam i kapercejne madhesine peseshifrore.

Prej disa vitesh, Shqiperia ka sistemin e saj te telefonave celular. AMC, i cili ne disa raste ka arritur te mbushe kerkesat e parealizuara te biznesmeneve per telefona stabel, dhe ne shume raste sherben per ngritjen e cilesise se nderlidhjes. Me gjithe çmimet e larta te zbatuara ne kushtet e mungeses se konkurences, çmime qe shpesh i bejne te huajt te qeshin, perseri numri i abonenteve vazhdon te rritet, duke tentuar te arrijne 17 mije abonent, nga te cilet pjesa me e madhe jane ne Tirane.

II. 1.3 Rrjeti i furnizimit me uje

Duke ju referuar modulit mesatar shumevjeçar te rrjedhjes ujore siperfaqsore per Tiranen (25 l/Km^2 si dhe vleres mesatare te rreshjeve per rajonin e Tiranes (1.600 mm ne vit, 40% e te cilave bien ne periudhen e dimrit), bejne qe burimet e ujrave nentoksore te karakterizohen

nga lekundje te medha te debitit. Keshtu, debiti maksimal eshte ne periudhen Tetor - Shkurt dhe debiti minimal ne periudhen Mars - Shtator. Ujesjellesi i Tiranes, i ndertuar ne vitin 1941, me nje prurje 40 l/sek qe merrej nga Lumi i Tiranes (ne vendin e quajtur Brar) nepermjet nje impianti pastrimi, furnizonte me uje qytetin e Tiranes me rreth 20 mije banore (aktualisht, ky stacion ka dale jashte perdorimit).

Perveç kesaj, ka patur dhe shume puse familjare. Ne vitin 1951 u perurua ujesjellesi i Selites, ne vitin 1964 ujesjellesi i Shen-Merise, ne vitin 1973 ujesjellesi i zones industriale, ne vitin 1974 ujesjellesi nga burimet e Bovilles, ne 1976 ujesjellesi i Lakrorit e Berxullit, etj. Burimet qe ushqejne ujesjellesin e Tiranes jane kryesisht natyrale dhe perbehen nga 3 burime kuritike (burimi i Selites, Shenmerise dhe Bovilles), te cilet sigurojne rreth 70% te sasise se ujit ne periudhen me shume uje dhe rreth 55% te kesaj sasie ne periudhen me pak uje, si dhe 7 stacione pompimi qe shfrytezojne 20 pus-çpime ne zonen fushore ne perendim te qytetit dhe sigurojne 30% te sasise se ujit ne periudhen me shume uje dhe 45% te kesaj sasie ne periudhen me pak uje. E gjithe sasia e ujit qe prodhohet nga vend-burimet perpunohet ne depot e ujit, qe kane nje volum prej 32 mije m3 uje.

Mesatarisht ne vit, te gjitha burimet e ujit japin rreth 55 milione m3 uje; duke shtuar edhe prurjen nga Bovilla (56 milione m3) llogariten gjithsej rreth 110 milione m3 uje. Vetite fizike-kimike te ujit, veçanerisht te burimeve te Selites e Shenmerise jane shume te mira.

Pasqyra 6. Prurjet e burimeve te furnizimit me uje (L/sek)

Nr.	Burimet	Prurja maksim.	Prurja min.
1.	Selita	700	250
2.	Shen-Merija	600	360
3.	Burilla	1800	1800
4.	Stacioni Berxull	240	240
5.	Stacioni Laknas	160	110
6.	Stacioni i Pishinave	140	140
7.	Stacioni Industrial	70	70
8.	Stacioni Çokollata	60	60
9.	Pusi Kombinat	25	25

Pasqyra 7. Vetite fiziko-kimike te gjithe burimeve te furnizimit me uje te pijshem

Sasia per çdo burim uji			Njesia	Elementet
Stacionet e pompave	Bovilla	Selita e Shenmeri		
92,0	42,32	10,35	Mg/l	Natrium+Kalium (Na+K)
102,8	73,2	40,04	«	Kalçium Ca
17,2	18,7	2,92	«	Manganez Mg
-	-	-	«	Amoniak Nh4
0,1	0,1	-	«	Hekur Fe
488	212,2	128,10	«	Hco3
-	6,0	6,0	«	Karbonate
26,6	7,1	7,1	«	Klorur
83,1	150,6	9,5	«	Sulfate
-	-	-	«	Nitrate
4,0	Gjurme	Gjurme	«	Nitrate
813,8	511,12	203,560	«	Mineralizim i Pergjithshem
554	0,343	0,144	Gr/l	Mbetja e Thate
5	Gjurme	-	Mg/l	Silice
15,3	14,5	6,24	shkalle gjermane	Fortesia
	1,2	1,28	Mg/l	Lenda Organike
	14,0	8,4		PH
16	8,2	7-8	0C	Temperatura

Sistemi i furnizimit me uje te Qytetit te Tiranes ka kete rrjet tubacioni:

1. Tubacione te xinguara	ml. 410.000	Ton 1200 - 25 vjet afat amortizim
2. Tubacione gize	ml. 238.000	Ton 13.600 - Per jete. pa amortizim
3. Tubacione Çeliku	ml. 260.000	Ton 25.000 - 25 vjet afat amortizim
		908.0 39.800

Parashikimi per furnizimin me uje ne perspektive te popullsise se Tiranes bazohet ne keta faktore:

- Rezervat ujore te burimeve te lartpermendura (3.500 -5.300 l/sek);
- Norma ditore e konsumit personal (norma shteterore eshte 150 l/p/d);
- Normat e konsumit personal per vendet mesdhetare dhe te Europes jane respektivisht 250 - 300 l/p/d dhe 450 - 550 l/p/d.

Ne baze te llogaritjeve te bera nga treguesit e mesiperm duhet te theksohet se, ne baze te normave tona, kapaciteti i furnizimit me uje ne rajonin e Tiranes eshte per nje populisi prej 1.4 milione banore sipas normave mesdhetare, ndersa sipas normave europiane 650 - 790 mije banore. Nga sa me siper, duke qene realist per te ardhmen dhe duke u bazuar ne normat mesdhetare te konsumit te ujit per person ne dite, kapaciteti mbajtes i rajonit te Tiranes eshte per nje populisi prej rreth 1.4 milione banoresh, gje qe nuk shkakton probleme nga pikpamja e burimeve.

Aktualisht gjendja e furnizimit me uje paraqet veshtiresite e meposhtme:

- Rritja e shpejte e qytetit, qe po perballon nje bum urban;
- Nderhyrjet pa leje dhe jashte kushteve teknike ne rrjetin e shperndarjes se ujit te pijshem;
- Shperdorimi i ujit, duke u perdorur per ndertim, ujitje tokash bujqesore, lavazhe automjetesh, dhe shperdorimet nga banoret e ndertesave njekateshe;
- Rrjeti teper i amortizuar; humbjet ne rrjet dhe shperdorimet arrijne deri ne 60%;
- Mungesa e aparateve matese te konsumit te ujit, sidomos ne vendet ku ai shperdorohet me teper.

Aktualisht, presioni i matur ne manometrin kryesor eshte 0.9 -1 atmosfere nga 3 atmosfere qe duhet te ishte ne kushte normale.

Ne kushtet e rrjetit te ujesjellsit te amortizuar, te rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza te amortizuar te ndertimeve te dendura mbi keto rrjete, te nderhyrjeve te shpeshta pa leje dhe te pakualifikuara, te mbetjes per nje kohe te gjate te tubacioneve pa uje nga nderprerjet e furnizimit, te perdorimit masiv te pompave te ujit, ekziston rreziku i ndotjeve masive, ndonese deri tani ka patur here pas here vetem ndotje ne segmente te veçanta te rrjetit te shperndarjes.

II. 2. Infrastruktura Komunale

II.2.1 Kanalizimet e ujrave te zeza

Rrjeti i kanalizimeve ne qytetin e Tiranes eshte rreth 520 km dhe ne sistem te perbashket te ujrave te zeza dhe te bardha. Ky rrjet punon me veterrjedhje deri ne pikat fundore te shkarkimit. Per qytetin e Tiranes jane dy pika perfundimtare shkarkimi: Perroi i Lanes dhe Lumi i Tiranes. Shkarkimi i ujrave te zeza, te bardha dhe teknologjike ne keto dy pika perfundimtare shkarkimi, ne pjese te ndryshme gjate gjithe gjatesise se tyre behet nepermjet kolektoreve prites te qytetit dhe nepermjet perrenjeve qe kalojne ne zonat e banuara te qytetit. Ne keto zona perrenjte jane te mbyllur ne tubacione betoni 2xΦ2000mm ose 2xΦ1500mm. Deri me sot shkarkimi i ujrave te ndotura behet drejtperdrejte ne perrua pa bere me pare trajtimin e tyre.

Tubacionet e rrjetit jane prej betoni me diametra te ndryshme:

Φ 400 mm – 1500 mm – Kolektore kryesore - rreth 200.072 ml

Φ 300 mm – 1500 mm – Kolektore sekondar – rreth 315.747 ml

Φ 200 mm – 1500 mm – Kolektore terciar

Φ 150 mm – 1500 mm – Kolektore sekondar

Nje pjese e mire e kolektoreve kryesor te qytetit jane ndertuar sipas studimit dhe projekt zbatimit te hartuar ne vitin 1962, per nje periudhe 20 vjeçare, e cila tashme gati po e kapercen dyfishin (nga 20 vjet ne 38 vjet).

Ne kete kuader gjendja e rrjetit ekzistues te kanalizimeve eshte jo e mire sepse:

- Siç u permend me lart, eshte kapercyer periudha 20 vjeçare qe prej ndertimit te tyre;

- Ritmi i larte i ndertimit te blloqeve te reja te banimit (rritja e dendesise se popullsise per Tiranen) dhe e zonave industriale kane rritur shkallen e veshtiresise se funksionimit te kolektoreve, te cilet ne raste rreshjesh sado te vogla, punojne jashte kapacitetit te tyre, duke shkaktuar permbytjen e rrugeve dhe te mjaft godinave te ndertuara ne kuota te uleta;
- Nderhyrjet e paligjshme dhe demtimet e rrjetit gjate ndertimeve te veprave me karakter te ndryshem;
- Mungesa e mjeteve te pastrimit te rrjetit, gje qe gradualisht do te çoje ne mbushjen maksimale te tubave me mbeturina te trasha dhe ne amortizimin e plote te rrjetit. Pastrimi i rrjetit behet vetem per pusetat e kontrollit per tubat me Φ deri ne 400 mm, duke perdorur vetem tel qe manovrohet me krah, nje metode teper e vjeteruar dhe aspak e pershtatshme dhe higjenike per kohen e sotme.

Ne keto kushte eshte e domosdoshme:

- **Zbatimi i nje programi emergjence per ndalimin e degradimit te metejshem te rrjetit te kanalizimeve;**
- **Realizimi i nje studimi afatgjate per rikonstruksionin e plote te rrjetit te qytetit dhe pastrimi i ujrave te zeza ne piken fundore te qytetit;**
- **Trajtimi i Lanes si kolektori kryesor i ujrave te zeza per qytetin e Tiranes.**

II. 2.2 Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor i qytetit te Tiranes ka nje gjatesi te tille, qe duke patur parasysh gjeresine e rrugeve ze nje siperfaqe prej 1.5 milione m^2, ndersa trotuaret jane 500 mije m^2.

Gjendja e rrugeve eshte mjaft e renduar per shkak te:

- Trafikut te madh te automjeteve me tonazh te ndryshem;
- Shtimit te shpejte te ritmeve te ndertimeve, qe domosdoshmerisht kerkojne çarjen e rrugeve per te realizuar lidhjet e nevojshme me rrjetin ekzistues inxhinjerik;
- Rikonstruksionet e shumta te ujesjellsit, elektrikut, telefonise, etj.;
- Riparimeve te difekteve te ndryshme te rrjetit inxhinjerik nentokesor;
- Nivelit te ulet te punimeve te mirembajtjes se vete rrugeve (pastrim te kanaleve anesore, pastrim te pusetave, mbushje gropave, etj.);
- Voneses se ndertimit te unazes kryesore te qytetit;
- Voneses se ndertimit te rruges se lidhjes direkte te Tiranes me aeroportin e Rinasit.

Te gjitha keto veshtiresojne funksionimin normal te rrjetit rrugor te qytetit. Keto veshtiresi shtohen edhe me teper po te kihet parasysh se ndermarrja e riparimit te rrugeve disponon mjete krejtesisht te amortizuara dhe fondet operative per riparim te rrugeve jane te pamjaftueshme, sidomos ne kohen kur veshtiresite dhe problemet shtohen.

Pasqyra 8. Treguesit kryesor te gjelberimit per qytetin e Tiranes

Nr	Emertimi	Njesia	1990	1998
1	Siperfaqe fidanishte	m^2	210000	120400
2	Siperfaqe sere me xham	m^2	14000	6270
3	Siperfaqe e shtreteve te nxehte	m^2	120	120
4	Siperfaqe me lule ne qytet	m^2	26400	13000
5	Siperfaqe rruge e sheshe ne lulishte	m^2	143720	129120
6	Bare i kultivuar	m^2	791900	521900
7	Park + pyll parku	m^2	2250000	1661000
8	Liqen artificial	Ha	45	45
9	Drure dekorativ	Cope	4022	3819
10	Fidanishte e luleve	m^2	15000	15000
11	Kopshti zoologjik	m^2	82000	82000
12	Parku i Dajtit	ha	4800	4800
13	Gjelberim ne institucione shkolla, etj.	m^2	200000	120000

Burimi: Bashkia e Tiranes

II.2.3 Gjelberimi

Nga pasqyra e mesiperme rezulton se fondi i gjelberuar i Tiranes ne vitin 1990 ishte 3.5 milione m^2 ose 17 m^2 per banore, duke u radhitur nder qytetet e gjelberuara mire te vendit. Sipas llogaritjeve dhe vrojtimeve te kryera, demtimet me te medha te mjediseve te gjelberuar rezultuan ne vitet 1992 - 1996, me ndertimin mbi siperfaqen e gjelberuar te mbi 1300 kioskave, duke e nxjerre jashte funksionit biologjik 35-40% te parqeve dhe te lulishteve, duke zhdukur mijera peme dekorative, duke betonuar dhjetramije m^2 siperfaqe.

Ne kete kontekst mund te permenden parqe e lulishte qe nuk ekzistojne me si parku Rinia, Vellezerit Frasheri, Namazgjaja, Drini, Banka, Muzeu Historik, Piramida, Zona e Lanes, etj. Ne uljen e siperfaqes se gjelberuar ka ndikuar vendosja e kioskave ne parqe e lulishte dhe kthimi i pronave publike ish-pronareve. Eshte e kuptueshme qe aksioni per prishjen e ndertimeve pa leje dhe e mbeturinave te tyre do te ndikoje ne rritjen dhe permiresimin deri diku te gjelberimit, por veshtire qe per nje periudhe afat-shkurter te arrihen treguesit e vitit 1990.

Per te arritur parametrat e kerkuar te gjelberimit rekomandohet:

- **Siperfaqet e gjelberuara duhet te ndertohen prane zonave te banimit. Per te realizuar, kete krahas investimeve shteterore, ne lejet e ndertimeve qe u jepen firmave private duhet tu percaktohen detyrimisht edhe detyra gjelberimi, si mbjellje lulesh, pemesh dhe krijim mikrolulishtesh brenda bllokut te ndertimit. Kete detyre organet perkatese te bashkise duhet ta marrin ne dorezim se bashku me objektin e perfunduar.**
- **Ne planin rregullues te qytetit te Tiranes, te caktohen zonat e lira per gjelberim dhe te hartohet nje grafik i plotesimit te skemes perkatese.**
- **Te planifikohet pyllezime rreth Tiranes, duke shfrytezuar hapesirat e lumenjve, te kodrave perreth dhe hapsira te tjera te lira.**
- **Te perfshihet mali i Dajtit ne studimet e perspektives, duke hartuar projekte pyllezimi, per te bere lidhjen e tij me qytetin e Tiranes**
- **Te planifikohet pyllezime rreth Tiranes, duke shfrytezuar hapesirat e lumenjve, te kodrave perreth dhe hapesira te tjera te lira.**
- **Te perfshihet mali i Dajtit ne studimet e perspektives, duke hartuar projekte pyllezimi, per te bere lidhjen e tij me qytetin e Tiranes**

II. 2.4 Perdorimi i tokes per ndertime

Levizja e lire e popullsise nga qytete te tjera dhe zonat rurale me pak te zhvilluara drejt rajonit te Tiranes, favorizoi zhvillimin e inisiatives se ndertimeve te paligjshme. dukuri qe do çoje ne urbanizimin e shpejte te tokave bujqesore ne periferi te qytetit. duke krijuar vendbanime te reja te paligjshme. Perdorimi i tokes po ndryshon me shpejtesi ne zonen urbane te Tiranes. Edhe ne ditet e sotme, ndertimet e reja te paligjshme vazhdojne te zhvillohen ne menyre kaotike nga inisiativa private.

Nga pikpamja urbanistike. qyteti i Tiranes eshte organizuar me nje unaze klasike dhe qender me rruge radiale dhe blloqe me shtepi te ngjeshura. Zona metropolitane me ndertime ze nje siperfaqe prej 15km^2 Rritja dhe peri apja e qytetit ne zonat rrethuese kalon dyfishin e hapsires brenda vijes se verdhe. ose 4 here zonen qendrore te ndertuar me intensitet te madh. Zona periurbane ne tranzicion aktiv ze afersisht 100 km^2. Densiteti i popullsise ne kete zone eshte i ulet. pasi nje pjese e tokes eshte e paperdorur ose e braktisur. Llogaritet qe rreth 70% e popullsise banuese aktuale ndodhet brenda zones tradicionale urbane dhe diferenca prej 30% jashte saj. por qe ze nje siperfaqe 3-4 here me te madhe sesa zona e ndertuar.

Zona suburbane e Tiranes eshte e vendosur ne nje konfiguracion kryesisht kodrinor malor ne gjithe gjeresine lindore. e cila kalon drejt perendimit me pjerresi me te bute.

Zmadhimi i Tiranes ka nevoje per kufije te rinj kadastral dhe administrativ. ku te perfshihet edhe zona suburbane. te domosdoshem per te planifikuar perdorimin e tokes Aktualisht. ka tre qendra te medha te rritjes suburbane prane qytetit. te cilat quhen zonat

satelite te Tiranes (Kamza, Paskuqani, Sauku). Bashkia e Kamzes ka 4 qendra kryesore te banuara.

Si pasoje e levizjes se lire te njerezve, zona suburbane e Tiranes ka ndryshuar ne menyre dramatike duke filluar nga viti 1991 e ne vazhdim. Nje pjese e mire e tokave bujqesore jane zene teresisht, si toka prane Kombinatit Ushqimor, Yzberisht, Kamez, Paskuqan, etj. Ndertesa dhe tokat e braktisuara kane vendosje qindrahektareshe ne vendet qe me pare ishin vreshta, pemishte, sera. Urbanizimi i shpejte dhe pa kriter i tokes bujqesore eshte kryer ne mungese te plote te infrastruktures se nevojshme ne keto zona si: hapje rrugesh, shtrirje linjash elektrike, ujesjellsa, kanalizime te ujrave te zeza dhe te bardha, infrastrukture tregtare, shkollore, sanitare, etj. Ndertesat jane te shperndara ne menyre krejt te rastesishme, pa asnje orjentim, gje qe do te rrise shume koston e infrastruktures ne te ardhmen. Rritja demografike do te vazhdoje edhe ne te ardhmen, gje qe do te shtoje kerkesat per ndertime te reja, te te gjitha llojeve, dhe rrjedhimisht do te beje presion per zenie te tokes bujqesore perreth qytetit. Per te mbrojtur token, veçanerisht ate bujqesore me kapacitet te larte prodhues, eshte i domosdoshem drejtimi i ketij proçesi nga pushteti qendror dhe ai vendor.

Periudha e tranzicionit eshte karakterizuar nga ndryshime te shpejta brenda dhe perreth Tiranes. Ketu permblidhen shtrirja urbane, krijimi i vendbanimeve te reja periferike, rritja e dendesise urbane te qytetit, rivleresimi i tokes, shnderrimi i stokut te banesave ne perdorim per qellime tregtare, trafiku i ngjeshur dhe zenia me ndertime e zonave publike. Keto dhe te tjera arsye bejne te domosdoshme rishikimin e masterplanitt te qytetit dhe te rajonit te Tiranes.

II. 2.5 Ngrohja e Qytetit

Per qellim llogaritje te kerkeses teorike per energji, Tirana eshte klasifikuar ne zonen e II-te me nje numer mesatar grad-ditesh te grades 12-18. Sipas te dhenave te vitit 1995, ne Tirane numeroheshin 64.159 banesa ne zonen urbane dhe rreth 24.110 ne zonen rurale dhe qe i korespondon nje popullsie prezente respektivisht: 328.400 banore dhe 142.208 banore ne fshat. Duke pranuar kete numer mesatar banoresh ne qytet dhe ne fshat, referuar popullsise urbane dhe rurale te vitit 1989 do te kishim: ne qytet 87.450 banesa dhe ne fshat 31.593 banesa. Ne fakt, te dhenat e gjendjes civile te fund vitit 1998 japin 139.562 familje ne qytet (Tirane 134.673 familje), dhe respektivisht: Vore 1065; Krrabe 581, Kamez 3233 dhe 39.206 ne fshat. Meqenese numri mesatar i banoreve per banese per vitin 1995 korespondon me numrin e perafert te banoreve per familje, atehere le te pranojme qe numri i ndertesave eshte i barabarte me ate te familjeve.

Sipas strategjise kombetare te energjise, ne llogaritjen e kerkeses per energji te perdorur per ngrohjen e banesave jane marre parasysh ndryshimet qe vijojne: vendodhja e baneses, mosha, tipi, konstruksion i baneses, etj. Gjithashtu, levizja e popullsise nga nje zone ne tjetren eshte konsideruar si faktor qe çon ne nje shperndarje te re te kerkeses per ngrohje. Si sherbim te domosdoshem ne familje jane marre ne konsiderate: ndriçimi, gatimi, ngrohja e baneses, ngrohja e ujit dhe perdorimi i pajisjeve te tjera elktro-shtepiake Per plotesimin e secilit prej tyre, llogaritja e kerkeses eshte mbeshtetur ne kontributin e

Pasqyra 9. Nevojat per energji te qytetit te Tiranes

Nr	Llojet e energjive	Nr i familjeve	Normativa KWH/familje	Nevoja (mije kwh)	P. Specifike (ne %)
1	E. Elek. per ndriçim	134700	344	46337	7.5
2	E.E. per gatim	134700	1384	186425	30.4
3	E.E. per ngrohje	134700	1229	165546	27.0
4	E.E. per uje te ngrohte	134700	960	129312	21.1
5	E.E. per pajisje elektro-shtepiake	134700	624	84053	13.7
	Gjithsej			611673	100

nje liste burimesh energjetike. Referuar numrit te familjeve te vitit 1998 dhe normativave te studimit te vitit 1995 te Agjensise Kombetare te Energjise, nevojat per energji te qytetit te Tiranes jepen ne pasqyren 9.

Sikurse shihet nga kjo pasqyre, rreth 30% e energjise elektrike perdoret per ngrohje, shifer kjo teper e larte. N.q.s. shtohet edhe mbi 30% tjeter qe perdoret per gatim, atehere shqetesimi behet edhe me evident dhe kjo kryesisht per arsye te: defiçitit shume te madh ne prodhimin e energjise elektrike: kostos se larte te prodhimit dhe te perdorimit te saj; problemeve te rrjetit te shperndarjes se energjise, etj.

Ndryshimi i struktures se perdorimit te energjise, ne krahasim me te kaluaren, ka nxjerre edhe disa probleme qe kerkojne edhe zgjidhjen perkatese, por, edhe te kohes.

- Neqoftese ne fillim te viteve 90, qyteti i Tiranes ngrohej kryesisht me dru zjarri dhe pjeserisht me vajguri (per ngrohje Tirana konsumonte 300-320 mije m3), sot konsumi i druve te zjarrit dhe vajgurit per ngrohje eshte i paperfillshem, duke u zevendesuar kryesisht me enrgji elektrike dhe gaz te lengshem. Eshte e kuptueshme qe zgjidhja e problemit te ngrohjes se qytetit te Tiranes eshte teper komplekse dhe shume e veshtire. Pa pretenduar per zgjidhje teresore te problemit te ngrohjes te qytetit te Tiranes, gjykohet se detyrimisht duhet filluar me zgjidhje pjesore.
- Ne disa qendra komunitare si qendrat spitalore, studentore duhen studiuar e realizuar ngrohje te perqendruara.
- Blloqet e reja te banimit detyrimisht te projektohen dhe ndertohen me ngrohje qendrore.
- Te studiohen mundesi te tjera ngrohje (diellore, etj.).
- Te ndertohet nje TEC - i madh, apo disa te vegjel me destinacion kryesor prodhimi i avullit per ngrohje.

Ne fillimet e viteve '90, tregu i energjise nxorri "jashte loje" si lende djegese drute e zjarrit. sepse ne ekonomine e tregut filloi te kushtonte shfrytezimi i tyre per shkak te kostos. Kjo situate solli edhe nje dukuri qe me vone do te perseritej edhe me lende djegese te tjera. Shumica e familjeve si ne te gjithe vendin, edhe ne rajonin e Tiranes, hoqen sobat me dru zjarri dhe e zevendesuan me radiatoret elektrike ose me vajgurin. Por, edhe vajguri filloi te mungoje ne treg duke perseritur te njejten dukuri si me drute e zjarrit, rrjedhimisht u hoqen nga perdorimi sobat dhe furnelat me vajguri.

Ne vitet '93-94 pati perpjekje per te stimuluar ngrohjen dhe gatimin me gazin e lenget. duke futur ne tregun e pajisjeve shtepiake sobat per ngrohje dhe gatim, ç'ka vazhdon te mbizoteroje ne treg si alternative ndaj energjise elektrike. Gazi i lengshem (GNL) megjithe perpjekjet edhe te organeve shteterore nuk po gjen perdorim ne mase, pasi konkurohet bindshem nga energjia elektrike. Jo vetem ne qytet, por edhe nje pjese te mire te fshatit. dominojne pajisjet elektroshtepiake sepse energjia elektrike eshte akoma me e lira ne tregun e energjise. Ne rang vendi, qe nga vitit 1992[1] furnizimi me burime primare energjetike ka mbetur relativisht konstant rreth 1,6-1,7 milione ton nafte ekuivalente (MTOE) ne krahasim me 3.3 MTOE me 1989 dhe 1,5 MTOE ne vitn 1992. Me te dukshme jane ndryshimet strukturore qe kane ndodhur lidhur me kontributet e burimeve te energjise dhe te konsumit final te saj. Duke u fokusuar ne ndryshimet e struktures se perdorimit te energjise ne banesa rezultatet tregojne se struktura e kerkeses ka ndryshuar s. lomos ne zonat urbane. ku energjia elektrike llogaritet per 60% te kerkese gjithsej ose 2 here me shume se drute e zjarrit.

Ne zonat rurale pozita e druve te zjarrit mbizoteron akoma: pothuajse 60% e kerkeses mbulohet nga drute e zjarrit dhe vetem 25% nga energjia elektrike. Per shkak te renies se kerkeses se industrise per energji elektrike, sektori i banesave ze tani nje perqindje ne rritje te konsumit te pergjithshem te energjise elektrike qe llogaritet me shume se 1/3 e kerkeses gjithsej per te gjitha burimet energjetike dhe 40% te kerkeses per energji elektrike. Perqindja ne rritje e konsumit te energjise per çdo banese individuale kryesohet nga ngrohja (ne kufijte 30-40%). Studimet per Strategjine Kombetare te Energjise tregojne se energjia elektrike do te vazhdoje te kontriboje me 40% te totalit te burimeve energjetike. Llogaritjet shpjegojne se ne vitin 2002 nevojat per energji elektrike per popullsine do te jene 5000 KWh. kur prodhimi i

[1] Gazeta *"Ekonomia"*. 29.2.2000

sotem mesatar i sistemit elektro-energjetik eshte 4800 KWh. Nese nuk merren masa rigoroze per kursimin e energjise dhe nese nuk zevendesohet energjia elektrike me ndonje burim tjeter te leverdisshem, sistemi elektrik do te shkoje ne kolaps. Sipas specialisteve, rritja e madhe e konsumit te energjise elektrike shpjegohet me çmimin e ulet dhe mospagimin e saj ne raport me burimet e tjera alternative.

Problemi shtrohet çfare duhet te behet qe te lehtesohet perdorimi i energjise elektrike me perdorues te tjere alternative. Brenda kuadrit te konsumit te burimeve energjetike ne familje, duhet bere me shume per perdorimin e burimeve te tjera energjetike si drute e zjarrit, vajgurit, panelet diellore, etj., me synim zvogelimin e konsumit te energjise elektrike.

II. 3 Infrastruktura sociale

II. 3.1 Arsimi

Niveli dhe roli i arsimit konsiderohen me te drejte si nje nder treguesit kryesore te demokratizimit dhe te ndertimit te shoqerise civile. Por, duhet te pranojme se ai si gjithe segmentet e shoqerise shqiptare ballafaqohet me pasojat e tranzicionit qe kalon i tere vendi.

Ndryshimi i sistemit ekonomik-shoqeror beri te domosdoshem ndryshimin e konceptimit te permbajtjes se shkolles, menyres se realizimit te ketij konceptimi, futjes se teknologjive te reja ne shkolle, permiresimit te infrastruktures qe t'i pergjigjet kerkesave te reja te kohes, per ta futur ate ne rrjedhen dhe integrimin ne modelin e shkolles perendimore.

Per sistemin e arsimit, Fondacioni SOROS ka hartuar projektin "Programi Tirana 2000", i cili paraqet nje pamje te pergjithshme te sistemit te arsimit te rajonit te Tiranes, duke vene theksin veçanerisht ne infrastrukturen e tij.

Te dhenat mbi rrjetin arsimor dhe numrin e nxenesve ne rajonin e Tiranes jepen ne pasqyren 3 tek Aneksi. Nga ato rezulton qe numri i nxenesve ne shkollat 8 vjeçare ne teresi per rajonin te rritet 5.7% , nga e cila qyteti 2.4 % dhe fshati 11,5%. Te dhenat per arsimin 8 vjeçar paraqesin kete tabllo: numri i nxenesve te rajonit rritet 5,8%, ne qytet 5,2% dhe ne fshat 10%.

Pasqyra 10. Personelit pedagogjik sipas niveleve dhe ngarkesa perkatese

Institucioni	Nr. i nxenesve	Nr. nxenes/ mesues
Kopshte	269	
Shkolla 8-vjeçare	1870	40
Shkolla te mesme	870	19,6

Shqetesim teper i madh, i cili kerkon nje studim teresor mbetet infrastruktura arsimore jo vetem ne fshat, por edhe ne kryeqytet. Megjithe ndërhyrjet shteterore apo donacionet e bera nga fondacione dhe shoqata bamiresie, gjendja fizike ne shumicen e shkollave, kopshteve dhe sidomos konvikteve ne teresi eshte larg kerkesave minimale. Problem tjeter mbetet ai i kapacitetit te shkollave, i cili nuk i pergjigjet numrit te madh te nxenesve per klase.

II. 3.2 Shendetesia

Veprimtaria sasiore e fushes se shendetesise jepet ne pasqyren 4 tek Aneksi.

Sikurse rezulton nga pasqyra e mepcshtme Nr. 11. ne fshat nuk funksionon asnje çerdhe nga 110 qe funksiononin ne vitin 1990. Edhe ne qytet numri i tyre eshte reduktuar ne 33 nga 77 qe ishin ne 1990. Nga 6185 vende ne çerdhe gjithsejt dhe 4898 ne qytet, numri i tyre eshte reduktuar ne 1505 vetem ne qytet dhe me nje frekuentim teper te ulet prej 980 femije. Nderkohe, duhet theksuar se ne qytet jane çelur edhe disa kopshte private, numri i te cileve sot per sot eshte i kufizuar.

Infrastruktura fizike e shendetesise, pa folur per nivelin e sherbimit ne spitale dhe ne ate ambulator, ka po ato shqetesime si dhe sektori i arsimit, per te mos thene me keq.

II. 4 Mjedisi Urban i Rajonit te Tiranes

II. 4.1 Mbeturinat e ngurta urbane dhe industriale

Popullsia aktuale e qytetit te Tiranes, sipas te dhenave te zyres se Gjendjes Civile prane

Pasqyra 11. Aktiviteti i Çerdheve te Femijeve

Nr.	Emertimi	Numri i çerdheve	Nr. i vendeve ne çerdhe	Femije te regjistruar	Frekuentuar
Viti 1993					
	Gjithsej	33	1929	1658	1346
1	Qyteti	33	1929	1658	1346
2	Fshati				
Viti 1994					
	Gjithsej	33	1440	1428	1059
1	Qyteti	33	1440	1428	1059
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1995					
	Gjithsej	30	795	1457	1024
1	Qyteti	30	795	1457	1024
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1996					
	Gjithsej	30	1315	1460	1016
1	Qyteti	30	1315	1460	1016
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1997					
	Gjithsej	29	1441	1400	884
1	Qyteti	29	1441	1400	884
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1998					
	Gjithsej	29	1505	1452	981
1	Qyteti	29	1505	1452	981
2	Fshati	0	0	0	0

Pasqyra 12. Te dhena mbi perberesit dhe sasine e mbeturinave

Nr	Materialet	Permbajtja (ne %)	Sasia vjetore e materialit (ton)
1	Plastike	15.4	20.000
2	Leter celuloze	12.3	16.000
3	Xham	4.8	6000
4	Tekstile	4.9	6500
5	Substanca organike	53.1	68000
6	Materiale inerte	5.3	7000
7	Metale	4.2	4500
	Gjithsej	100.0	128000

Bashkise, eshte 436.016 mije banore. Referuar normatives se pranuar nga Komiteti i Mbrojtjes se Mjedisit ne vitin 1996, 8kg/dite per persona, rezulton qe prodhimi ditor i plehrave te jete rreth 350 ton dhe ne vit 128 mije ton. Nga vrojtimet dhe analizat e kryera nga Komiteti, perberja mesatare, e per rrjedhim perberesit vjetor ne ton, per qytetin e Tiranes jepen ne pasqyren 12.

Nga analiza e perberesve te mbeturinave te Tiranes dhe disa qytete kryesore te vendit rezulton se ato ngjajne me shume me ato te vendeve te Lindjes se Mesme se sa me ato te vendeve te Europes Perendimore. Ky perfundim eshte arritur nga permbajtja e substancave organike, qe eshte shume me e larte se mesatarja europiane dhe ne linje me karakteristikat e vendeve ne zhvillim. Mbi te gjitha, te dhenat konfirmojne periudhen e tranzicionit ne te cilen ndodhet Shqiperia: ne fakt, te dhenat qe kane te bejne me permbajtjen e plastikave jane shume me te larta dhe ne linje me te dhenat qe jane tipike per

Pasqyra 13. Te dhena krahasuese

Nr.	Materialet	Permbajtja ne Perqindje	
		Stamboll (Turqi)	Qytete europiane me 300 mije banore
1	Celuloze	10.1	33.6
2	Plastike	3.1	16.6
3	Metale	1.5	5.3
4	Materiale inerte	15.3	8.2
5	Tekstile	3.1	3.6
6	Substanca Organike	60.8	26.8

shoqerite e konsumit.

Si perfundim, keto te dhena mbi strukturen e mbetjeve te qytetit te Tiranes konfirmojne se, persa i perket perdorimit te mirave qe ofron tregu, ruhen ende disa zakone te vjetra. Eshte e lehte te parashikohet qe zhvillimi i ketyre te dhenave ne te ardhmen do te jete drejt pozicioneve qe jane tipike per vendet e zhvilluara.

Prania e nje perqindje te larte te mbetjeve inerte eshte per shkak te aktiviteteve intensive ndertuese, aktivitete te kryera ne shumicen e rasteve me inisiative te individeve, te cilat shoqerohen me prodhimin e sasive jo te vogla te dherave te cilat hidhen ne kazanet e plehrave, per mungese edhe te kontrollit nga organet shteterore. Kjo lloj mbeturine per qytetin e Tiranes eshte bere shqetesuese, veçanerisht tani ne periudhen e prishjes se ndertimeve te paligjshme.

Prania me e larte e materialeve inerte ne plehrat e ngurta urbane krahasuar me situaten ne vendet perendimore, i detyrohet kryesisht materialeve qe derivojne nga fazat e ndryshme te aktivitetit te ndertimit; ne fakt ne vendet perendimore prodhimi mesatar i ketyre lloj mbeturinave te ngurta eshte 2-3% te peshes, ndersa ne Shqiperi eshte 6.9%. Keto te dhena perkojne plotesisht me karakteristikat e mbeturinave te vendeve ne zhvillim, ku nuk ka nje sherbim rigoroz te heqjes se tyre dhe mentaliteti i popullsise lidhur me asgjesimin korrekt te mbeturinave nuk eshte ne nivelin e duhur.

Ne perfundim, mund te thuhet se keto te dhena mbi karakteristikat e mallrave te tregtueshme na lejojne te besojme se, Tirana me shpejtesi po permireson zakonet e saj lidhur me perdorimin e mallrave te pranishme ne treg, ne shumicen e tyre te perendimit, por ende ruan disa karakteristika te vjetra.

Sipas llogaritjeve te institucioneve te specializuara, Tirana prodhon 22-25% te mbeturinave urbane te vendit. Vleresohet se ritmi i rritjes se prodhimit te mbeturinave eshte 8-10%, prandaj eshte e kuptueshme qe per administrimin e drejte te tyre kerkohet nje planifikim strategjik me i mire nga ana e institucioneve perkatese si dhe me shume investime.

Problemet aktuale qe duhen perballuar ne fushen e administrimit te mbeturinave te ngurta urbane mund te renditen:

- Administrimi i mbeturinave urbane ende nuk konsiderohet si problem paresor;
- Menyra aktuale e administrimit te tyre eshte eshte me pasoja te rendesishme higjenike dhe shendetesore;
- Teknologjia e trajtimit eshte primitive (thjeshte hedhja e tyre ne terren, teresisht te papershtatshme nga pikpamja e mbrojtjes te ujrave nentokesore);
- Financimet ne kete fushe jane te pakta;
- Ndergjegjesimi i ulet mjedisor (institucional dhe i publikut) eshte problemi kryesor i administrimit te mbeturinave urbane ne vend.

II. 4.2. Prirjet ne prodhimin e mbeturinave te qytetit

Sipas vezhgimeve dhe statistikave, prodhimi i mbeturinave ne qytetin e Tiranes vleresohet ne 0.8 kg/fryme/dite ose 292 kg/vit nga 0.7 kg/dite/fryme ne vitin 1996. Ndonese prodhimi i tyre eshte rritur ne krahasim me disa vite me perpara, ai eshte ende i ulet ne krahasim me vendet e Europes (380-420 kg/vit)

Pasqyra 14. Prodhimi vjetor i prodhimit te plehrave

Vitet	Nr. i popullise (mije/banore)	Prodh i plehrave per fryme (kg)	Prodh vjetor i plehrave (000 ton)
1998	500	256	128
2000	600	280	150
2005	700	320	224
2100	900	400	360

Ne ritmin e rritjes se prodhimit te mbeturinave te ngurta jane mbajtur parasysh dy faktore:

- Rritja vjetore e prodhimit e pranuar per 2 vjetet e fundit (1998-1999) dhe e pranuar per vitin 2000 prej 8 per qind;
- Ndryshimi dhe sjellja e qytetareve ne menyren e jeteses dhe te konsumit.

Edhe gjate viteve te fundit 1998-1999, administrimi i mbeturinave te ngurta urbane vazhdon te behet vetem sipas nje metode: shkarkimi ne terrene toke, zakonisht ne periferi te qytetit.

ne shumicen e rasteve pa ju nenshtruar ndonje perpunimi paraprak apo te metejshem. Vendet e depozitimit perfundimtar per mbeturinat e ngurta urbane pergjithesisht jane te vendosura prane vijave te ujit. Ato nuk kane sistem organizimi per efektin e kullimit dhe as sistem efikas te ngjeshjes se mbeturinave urbane.

Tirana, ashtu si dhe qytet e tjera te Shqiperise, ballafaqohet me nje administrim jo korrekt te mbeturinave urbane. Administrimi i plehrave nuk behet me metoda te sigurta, ç'ka ka shkaktuar shqetesime serioze per rrezikun potencial mjedisor. Shqetesimet kane te bejne me keto çeshtje kryesore:

- Ndotja e tokes dhe e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore me ndikime te mundshme ne cilesine e ujit te pijshem;
- Ndikim negativ estetik ne peisazhin natyror;
- Rreziqe nga rreshqitja e vetvetishme e mases se mbeturinave te depozituara me kohe;
- Ekzistenca e zonave te kontaminuara nga trajtimi ose depozitimi prej vitesh i mbeturinave, ç'ka rrit koston e zhvillimit urban, por edhe paraqet rreziqe serioze shendetesore dhe mjediseve.

Struktura organizative per heqjen, transportin dhe depozitimin e mbeturinave urbane synon t'i pergjigjet rritjes se mbeturinave, por nuk ka arritur te administroje rritjen e theksuar te tyre. Si pasoje, kudo neper rruge dhe ne hapesira te tjera shfaqen grumbuj plehrash e mbeturinash te gjithanshme. Duhet pranuar se ne tere qytetin e Tiranes jane vendosur kontiniere metalik apo plastike, por ata jane te pamjaftueshem dhe, per kete arsye dhe te tjera qe lidhen me edukaten qytetare, shume banore i hedhin plehrat vend e pavend, dhe ne mjaft raste, per force zakoni, ne vende ku i kane hedhur me pare, duke krijuar mjedise shume te ndotura.

Shqetesim mbetet mosterheqja e tyre, e cila si rregull duhet te realizohet çdo dite, gje qe eshte perjashtim. Terheqja e tyre nje here ne disa dite, sidomos ne periudhen e veres, shoqerohet me dekompozim dhe grumbullim mizash, minjsh, qensh, etj. Ndertimi i blloqeve te reja te banimit, zhvendosja e tregjeve te lira, demtimi i kontiniereve, levizjet e popullsise brenda qytetit bejne te domosdoshem nje rishperndarje te vendosjes se kontiniereve dhe pikave te grumbullimit te plehrave. Administrimi i plehrave paresore kerkon veprimet e meposhtme, te cilat gjykohen te domosdoshme per autoritetet lokale:

- Forcimi i autoriteteve vendore, sidomos ne monitorimin dhe kontrollin e veprimtarive ne kete fushe;
- Forcimi i administrimit te pergjithshem mjedisor te rajonit;
- Permiresimi i bashkepunimit midis Bashkise e Tiranes dhe institucioneve qe perfshihen ne administrimin e mbeturinave (Min. e Puneve Publike, Min. e Bujqesise dhe Ushqimit, Agjensia Kombetare e Mjedisit, Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit);
- Krijimi i Kadastres per administrimin e mbeturinave industriale, tregtare, bujqesore.

II. 4.3 Asgjesimi perfundimtar i plehrave

Deri me sot, kriteret per mbrojtjen e mjedisit nuk jane marre ne konsiderate ne lokalizimin e vendeve te hedhjes se mbeturinave te ngurta urban. Zakonisht mbeturinat vazhdojne te hidhen detyrimisht ne toke, pa realizuar ndonje sistem mbrojtje mjedisore. Sipas praktikes ne fuqi, impiantet, sheshet e asgjesimit te mbeturinave jane vendosur prane burimeve ujore. Keto impiante nuk kane sistem drenazhimi per efekt kullues dhe as sisteme efikase ngarkim-shkarkimi. Thjesht, mbeturinat shkarkohen dhe ndonjehere u hidhet pluhur gelqere per te kufizuar efektet mikro-biologjike. Ne shume raste ato hidhen ne shtratin e lumenjve, gje qe krijon probleme sidomos ne periudhe shirash.

Ne strategjine kombetare te administrimit te mbeturinave per Shqiperine eshte percaktuar se, ne nje periudhe afatshkurter menyra me e mire e trajtimit te tyre eshte mbulimi higjenik nentoke. Kjo menyre eshte e njejte me ate qe perdoret gjeresisht ne shume vende te tjera europiane, e cila eshte edhe me e lire. Zgjedhja e menyres se mbulimit te plehrave nentoke si me e pershtatshme ne kushtet e Shqiperise mbeshtetet ne keto argumente:

- Kosto e larte e teknologjive te tjera ne krahasim me fondet qe disponohen;

- Perberja aktuale e mbeturinave urbane, pergjithesisht te varfra me fuqi kalorifike te ulet, nuk sugjeron ndonje teknologji tjeter trajtimi, p.sh. djegien;
- Njohuri te pakta mbi prodhimin e mbeturinave industriale ne vend dhe per karakteristikat e tyre.

Eshte e natyrshme qe ne te ardhmen ndoshta jo shume te larget, populisise se Tiranes do t'i kerkohet t'i hedhe plehrat ne kazane, te ndara sipas klasifikimit qe do te beje Bashkia.

II.4.4 Percaktimi i zonave me te pershtatshme per ngritjen e impianteve te asgjesimit te plehrave

Vendvendosja e impianteve te asgjesimit te plehrave eshte problem teper i rendesishem ekologjik, inxhinjerik por edhe ekonomik. Ato miratohen nga KRT e Bashkive (rretheve). Ne percaktimin e vendvendosjes mbahen ne konsiderate:

- Rrjeti rrugor i pershtatshem per qarkullimin e automjeteve te zakonshme dhe krahas tyre edhe ai i transportimit te plehrave;
- Nuk duhet te çoje ne ndryshimin e peisazhit natyror te zones, por te jete instrument per permiresimin e zonave te demtuara, madje per t'i perdorur dhe per qellime shlodhjeje;
- Karakteristikat natyrore te zones duhet te ruhen nga efektet e ndikimit te mjedisit-perhapja e ndotesive;
- Vendosja e tyre ne zona te degraduara, ose ne zona me interes per aktivitete nxjerrese.

Duke qene se impiantet e asgjesimit te mbeturinave jane te demshme per shendetin, ato duhet te kryhen ne distanca te pershtatshme per te shmangur rrezikun per banoret, per arteriet e komunikimit masiv dhe per te shmangur rrezikun per rjetin e ujit te pijshem. Raporti per perputhjen e mjedisit konsiderohet i plote kur tregon se eshte ne perimetrin e zones aktualisht te perdorur per shkarkimin e mbetjeve te ngurta urbane:

- 500 ml larg nga banesat
- 500 ml larg nga autostradat dhe rruget kombetare
- 1000 ml larg nga shtrati i siperm i liqeneve dhe burimeve te ujit te pijshem
- 2000 ml larg nga puset dhe zonat ku nxirret uje i pijshem.

Vendvendosja e impianteve nuk lejohet ne zonat, kur eshte e pranishme qofte edhe nje nder kushtet e poshtme:

- ne shpatet ose ne territoret e rreshqitshem ose ne fundin rreshqites te impiantit;
- ne zona me lageshti, si dhe zonat me vershime te lumenjve apo liqene, n.q.s. nuk ndertohen prita:
- ne zona te mbrojtura sipas planeve rregulluese, lokale dhe rajonale ne fuqi.

Nga sa me siper, mund te arrihet ne perfundimin se masat qe duhen ndermarre per te krijuar struktura te pershtatshme per zgjidhjen e ketyre problemeve mund te ndahen ne masa teknike dhe ne ato normative.

- Nga kendveshtrimi teknik do te jete e nevojshme pergatitja e impianteve te trajtimit ne nje periudhe aftmesme d.m.th. vendtrajtimi me agregate, qe ne situaten e sotme financiare te Shqiperise eshte e vetmja zgjidhje. Per momentin, nuk behet fjale per mundesine e realizimit te impianteve te nje teknologjie komplekse, sepse kostoja eshte shume e larte.
- Nje tjeter mase teknike eshte krijimi i impianteve te rikthimit dhe te impianteve te materialeve inerte, duke i konsideruar keto si mundesi alternative ne ndertimet rrugore.
- Per me teper, aktivitetet e riciklimit duhet te perfshijne materiale qe mund te riperdoren lehtesisht. Rikuperimi i plastikes, xhamit, aluminit mund te jete funksionale, neqoftese i bashkangjiten normat precize, te cilat do te detyronin industrite te riperdornin sasite e rikuperuara.

II 4. 5 Cilesia e ajrit dhe ndotja e atmosferes

Cilesia e mjedisit urban vleresohet bazuar ne shume faktoreve e dukuri me frekuence dhe amplitude te ndryshme. Shtimi me ritme te shpejta i transportit apo shfrytezimi intensiv i burimeve te ndryshme vleresohen si kercenimet kryesore per mjedisin, shendetin dhe mireqenien. Dukuria e urbanizimit eshte dukuri qe mbizoteron dallueshem veçanerisht ne qytetin e Tiranes. Keqesimi i cilesise se ajrit per shkak te zhvillimit te vrullshem te sektorit te transportit, te perdorimit ne shkalle te madhe te automjeteve te perdorura, administrimit te keq te hedhurinave, zhvillimit te

vrullshem te sektorit te ndertimeve, etj., jane dukuri e zakonshme.

Politikat e zbatuara dhe masat e marra per mbrojtjen e cilesise se ajrit kane per qellim qe te ulin perqendrimet e ndotesve ne shtresat e uleta te atmosferes, deri ne vlerat qe nuk jane te demshme per shendetin e njeriut dhe te mjedisit. Ky synim mund te arrihet vetem nepermjet pakesimit te vazhdueshem te sasise se pergjithshme te ndotesve qe shkarkohen ne ajer nga te gjithe kategorite e burimeve te ndotjes se ajrit.

Administrimi i hedhurinave te ngurta urbane perben nje hallke shume te dobet dhe nje sfide te vertete mjedisore si per autoritetet shteterore, ashtu edhe per shoqerine civile. Ne vendin tone nuk ka asnje impiant te trajtimit te hedhurinave te ngurta urbane. Ujrat e zeza dhe ujrat e perdorura industriale shkarkohen drejtperdrejt ne mjedis, pa asnje lloj trajtimi paraprak.

Siperfaqet e gjelbra ne qytet po vijne duke u zvogeluar vazhdimisht edhe pse ligji ndalon ne menyre taksative ndertimet ne siperfaqe te gjelbra, por ka raste jo te pakta te thyerjes se tij. Nga vrojtimet e QShKE-se rezulton se problemet e administrimit mjedisor trajtohen pas ose aspak nga organet e pushtetit vendor, te cilet per shkak te problemeve te mprehta sociale dhe te mungeses se infrastruktures jane pergjithesisht indiferente ndaj mbrojtjes se mjedisit.

II. 4.6 Cilesia e ajrit

Cilesia e ajrit eshte nje faktor i rendesishem nga pikpamja ekonomike, ekologjike dhe sociale, duke marre parasysh pasojat e saj per shendetin e njeriut, veçanerisht per sistemin e frymemarrjes dhe pergjithesisht per cilesine e jetes. Ndotja atmosferike shkakton demtimin e mjedisit natyror si dhe degradimin e monumenteve kulturore dhe historike. Ndotja e atmosferes eshte e lidhur me kushtet klimatike lokale, ashtu dhe me shkarkimet e ndotesve atmosferike. Shume probleme te cilesise se ajrit ne qytete shkaktohen nga prania e ndotesve te tille si SO2, grimcat e pezullta, NO2, oksidet, monoksidi i karbonit, komponimet organike flurore (volative) dhe metale te renda.

Ndotja atmosferike perben nje problem te veçante per qytetet ne pergjithesi, sepse pjesa me e madhe e burimeve atropogjene qe shkaktojne ndotje jane perqendruar prane ketyre zonave (industrite dhe trafikun rrugor i renduar), gje qe ndikon seriozisht ne cilesine e ajrit te thithur nga qytetaret. Ne Tirane qarkullojne çdo dite rreth 50 mije automjete nga te cilat 35 mije jane te Tiranes dhe 15 mije qe vijne nga rrethet, shumica e te cilave, per arsye te njohura, jane teper te amortizuara dhe qe shkaktojne ndotje shume larg limiteve te pranuara.

Cilesia e ajrit urban mund te shprehet nepermjet perqendrimit mesatar vjetor te SO2, te grimcave te pezullta dhe te NO2 qe hasen ne ajrin e qyteteve. Per sigurimin e informacionit te nevojshem lidhur me cilesine e ajrit ne qytetet kryesore te vendit, Instituti i Shendetit Publik dhe Instituti i Metereologjise po realizojne nje program monitorizimi.

Pasqyra 15. Normat sanitare shteterore per cilesine e ajrit atmosferik ne zonat urbane

Ndotjet	Monoksidi (mg/m3)	Koha mesatare
Monoksid karboni	2 6	24 ore per nje cast te dhene
Plumb	1.5	24 ore
Dioksid Azoti	150 500	24 ore per nje cast te dhene
Lende e Grimcuar (bloze)	50 150	24 ore per nje cast te dhene
Okside squfuri	150 500	24 ore per nje cast te dhene

II. 4.7 Shkarkimet e Gazeve Acide ne Ajer

- Gazet acide ne atmosfere dhe efektet e tyre. Shkarkimi i gazeve acide ne atmosfere eshte me pasoja te demshme per ekosistemet e ujerave te embla, te cilat jane te ndjeshme ndaj aciditetit, ashtu edhe per cilesine dhe perberjne kimike te tokes. Shkarkimi ne atmosfere i komponimeve te azotit eshte shkaktar edhe i dukurise se eutrofikimit ne ekosistemet tokesore dhe detare. Burimi kryesor i leshimit ne mjedis te substancave acidifikuese jane shkarkimet e gazta qe permbajne dioksid squfuri SO2, okside azoti NOx dhe amoniak NH3. Keto gaze prodhohen gjate djegies se lendeve organike te djegshme ne sektoret e sherbimit, te transportit, te prodhimit te energjise, industrise kimike, metalurgjike etj. Pas leshimit ne atmosfere keto gaze shperndahen ne hapesire dhe mund te qendrojne per disa kohe ne gjendje te difuzionuar

Gazet SO2, Nox, dhe NH3 bien drejtperdrejt ne siperfaqe te tokes, duke u vendosur mbi bimesine dhe elemente te tjera te mjedisit, ose bien ne gjendje te njome se bashku me deboren, shirat, mjegullen, etj. Keto gaze, si rezultat i zhvillimit te disa reaksioneve kimike, shnderrohen ne acid sulfurik dhe nitrik, si kur ndodhen ne atmosfere, ashtu edhe pas renies ne toke.

- Gazi sulfuror SO2: burimet dhe situata. Monitorimi i permbajtjes se gazit sulfuror ne ajrin urban kryen nga ana e Institutit te Shendetit Publik (ISHP) dhe e Institutit te Hidrometereologjise (IHM). Te dhenat e permbajtjes ne ajer te gazit sulfuror jane matur ne stacionin monitorues qe ndodhet prane ISHP. Seria e matjeve ne tabele jep ecurine e vlerave mesatare mujore per vitin 1998. Siç shihet vlerat e matura ne kete pike jane teper te uleta ne krahasim me normat sanitare te ketij ndotesi.

Duhet theksuar se ne asnje rast nuk verehet tejkalim i vleres kufi te SO2 per 24 ore (150

Pasqyra 16. Perqendrimi Orar i SO2, Nentor 1998

ra	8	8:30	9	9:30	10	10:30	11	11:30	12	12:30	13	13:30	14
asia g/m3	40	110	110	110	85	60	60	40	35	35	20	15	10

mg/m3) dhe as vlera kufi per nje çast te dhene (500 mg/m3). Per sa i perket ecurise ditore te permbajtjes se SO2, vihet re nje perqendrim me i larte i tij ne oret e para te mengjesit, kur edhe temperatura e ajrit eshte me e ulet.

- Oksidet e Azotit (NOx): burimet dhe situata. Oksidet e azotit (NOx) krijohen si ne proçeset natyrore, ashtu edhe nga veprimtarite njerezore. Ne pergjithesi, shkarkimet e oksideve te azotit nga proçeset natyrore jane rreth 15 here me te medha se shkarkimet nga veprimtarite njerezore. Burimi kryesor i oksideve te azotit ne natyre jane shperberja bakteriale e nitrateve organike, djegia e barit dhe e pyjeve, si edhe aktivitetet vullkanike. Shkarkimet e oksideve te azotit nga veprimtarite njerezore vijne kryesisht nga transporti, nga perdoruesit e tjere te energjise dhe nga proceset industriale. Ne proçesin e djegies, azoti i lendes djegese oksidohet me ajrin duke formuar oksid dhe dioksid azoti. Nje burim tjeter per oksidet e azotit eshte edhe perdorimi i tepruar i plehrave azotike ne bujqesi.

Shkarkimet e NOx-ve kontribuojne drejtperdrejte ne ndotjen e ajrit lokal dhe urban, si edhe indirekt si pararendes te formimit te smogut fotokimik. Perveç kesaj, ato kontribuojne ne problemet e ndotjes ne shkalle me te gjere, per shkak te zhvendosjes se tyre ne atmosfere ne distanca te medha. Shkarkimet e oksideve te azotit mund te kene efekte negative te shendetit te njeriut dhe mbi ekosistemet. Krahas oksideve te squfurit, oksidet e azotit luajne gjithashtu rol te rendesishem ne acidifikimin e mjedisit. Analiza e tendencave tregon per nje pakesim te shkarkimeve te NOx-ve.

- Shirat acide jane pasoje e reshjeve: shi, debore ose mjegull, te cilat jane bere acide per shkak te ndotjes se atmosferes. Po ashtu, shiu acid eshte pasoje edhe e grimcave te ngurta te acidifikuara. Reshjet qe bien ne nje atmosfere "te paster" normalisht jane fare pak acide, me nje vlere te pH rreth 5,6, ndersa rreshjet acide mund te kene nje vlere te pH me te vogel se 4.0. Shiu acid eshte nje shqetesim i madh per shkak te efekteve demtuese te fuqishme te tij ne uje, jeten ujore, bimesine dhe materialet e ndryshme (ndertesa, objekte, monumente kulturore etj.)

Aktiviteti njerezor eshte nje nga shkaktaret kryesore te shiut acid. Oksidet e squfurit dhe oksidet e azotit te prodhuara nga djegia e lendeve djegese fosile kombinohen se bashku me ujin e atmosferes per te krijuar shiun acid. Per kete arsye, masat e marra per pakesimin e shkarkimeve te dioksidit te squfurit dhe te oksideve te azotit nga burimet e medha, kane efekt te drejtperdrejte ne permiresimin e cilesise se ajrit ne zonat urbane dhe ndikojne indirekt ne evitimin e krijimit te shiut acid.

- Prirja e perqendrimeve te gazeve acide ne atmosfere. Monitorimi sasior i shkarkimeve nga burime te ndryshme te levizshme dhe te palevizshme te ndotjes me SO2 dhe NOx, ndonese eshte nje detyre e parashikuar nga ligji baze *"Per mbrojtjen e mjedisit"*, nuk kryhet ose kryhet ne menyre krejt te pjesshme. Te dhenat e grumbulluara per monitorimin dhe kontrollin e mjedisit jane te pjesshme dhe nuk lejojne te kryhet nje analize e hollesishme sasiore e kontributeve

sektoriale te gazeve acide. Inventari ishkarkimeve te gazta nga burime te ndryshme ndotjeje duhet kryer mbi bazen e metodologjive te caktuara qe bazohen ne njehsime dhe matje direkte. Te dhenat e mara nga institucionet mbeshteten ne njehsime indirekte te bilanceve materiale te djegies se lendes se djegshme dhe nuk bazohen ne matje te drejtperdrejta te shkarkimeve te gazeve ne dalje te oxhakut.

Efektet e acidifikimit ne vendin tone nuk ndjehen nga fakti i sasirave teper te vogla te gazeve acide te shkarkuara nga veprimtari te ndryshme qe zhvillohen ne vend, si edhe per pozicionin gjeografik te Shqiperise ne pjesen jug-lindore te Europes, e cila sikurse raportohet nuk ndikohet nga dukuria e acidifikimit si pasoje e ndotjes nderkufitare.

- Grimcat e ngurta. Lenda e grimcuar ne gjendje te pezullt ne ajer eshte nje nga ndotesit e ajrit dhe perben nje kategori te gjere ku perfshihen lendet e grimcuara te lengeta e te ngurta qe ndodhin ne atmosfere. Grimcat me te medha se 10 mikron jane te demshme per shendetin,

Pasqyra 17. Permbajta e lendes se ngurte ne ajer ne qytetin e Tiranes, 1998
(perqendrimi ne mg/m3 i pluhurit me permasa nen 10 mikron)

Pikat	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
Bashkia	197.86	163.27	127.23	146.93	143.17	142.22	112.73	132.82
Shesh Ataturk	344.74	252.68	-	183.41	174.28	175.06	175.06	186.07

sepse kane per te hyre ne pjeset e poshtme te mushkerive. Ato kontribuojne ne menyre te demshme ne pakesimin e shikimit, te shendetit te njerezve sepse mbajne metale dhe substanca te tjera teknike.

Lidhur me ndotjen e ajrit urban nga grimcat e ngurta, Instituti i Hidreometereologjise ka percaktuar gjate vitit 1998 permbajtjen e pluhurit qe vetebie (depozitimi i thate) ne ajrin e disa qyteteve te vendit (Tirane, Elbasan, Korçe dhe Fier). Vlera maksimale e depozitimit te thate prej 533 mg/m2/ dite (si mesatare dy mujore) verehet ne Elbasan ne muajt qershor dhe korrik. Qe ne veshtrim te pare bien ne sy ndryshime te konsiderueshme ne shperndarjen e depozitimeve te thata sipas qyteteve dhe muajve te vitit. Se pari, duhet shenuar se matja e depozitimit te thate ne Tirane dhe ne Elbasan deri ne muajin shtator eshte bere sipas metodikave qe lejon matjen e njekohshme te depozitimit te thate dhe te pluhurit te rene me reshjet.

Nga te dhenat hidrometereologjike rezulton se, ne Elbasan gjate muajit qershor kane rene 30.6 mm reshje te shperndara ne kater periudha, ndersa ne Tirane kane rene 18,9 mm reshje te shperndara ne dy periudha. Ne muajin shtator,ne stacionet Korçe, Elbasan dhe me vone ne Fier matjet jane kryer vetem per depozitimin e thate, ndersa ne Tirane vazhdoi te zbatohet metodika tjeter (depozitim i thate dhe pluhur i sjelle me reshjet) .Keshtu shpjegohen ndryshimet e medha ne rezultatin e depozitimit te thate per muajt shtator, tetor, nentor dhe dhjetor midis vlerave per Tiranen dhe per qytetet e tjera.

Ne stacionin e Tiranes dhe te Elbasanit vlerat e matura i kalojne ndjeshem vlerat limit (vlerat limit mujore 350 mg/m2 dhe vlera limit vjetore 200 mg/m2). por nuk e kalojne asnjehere vleren limit kritike mujore prej 700 mg/m2. Ketu duhet patur parasysh fakti se te dhenat e referohen mesatares 6-mujore. Ne Korçe hasen vlera me te ulta ne krahasim me qytetet e tjera.

- Monoksidi i karbonit (CO) formohet nga oksidimi i metanit, i cili eshte nje gaz qe formohet nga shperberja e lendes organike. Burim kryesor i krijimit te monoksidit te karbonit nga aktivitetet njerezore jane te gjitha proçeset e djegies kur ka mungese oksigjeni. Nga proçeset e ndryshme te djegies (ne automjete, impiante termike, veprimtarite industriale, etj.) shkarkohet monoksid karboni ne vlera qe luhaten shume ne varesi te shume faktoreve. Pa dyshim qe sasia me e madhe e monoksidit te karbonit shkarkohet nga trafiku i makinave. Sasia e monoksidit te karbonit qe shkarkon nje autoveture varet nga raporti ajer/lende djegese, shpejtesia, temperatura e dhomes se djegies, shkalla e kompesionit dhe nga shume faktore te tjere. Pra, ne rastin e trafikut te dendur dhe me shpejtesi levizjeje me te vogel se 20-25 km/ore, siç ndodh zakonisht ne qendrat urbane, nivelet e CO-se shkarkuar nga automjetet arrijne vlera maksimale.

Ndryshe nga veprimtarite industriale qe zhvillohen kryesisht larg zonave te banuara, qarkullimi i automjeteve ndodh ne pjesen me te madhe brenda zonave te banuara dhe shkarkimi i gazeve

dalese te tyre behet ne nivelin e tokes. Rritja e pershpejtuar e numrit te automjeteve ne Shqiperi keto vitet e fundit e ka shtuar shqetesimin e specialisteve e te qytetareve per ndotjen urbane nga automjetet. Per shkak te rritjes se theksuar te numrit te automjeteve, efektet e trysnise nga trafiku urban shfaqen me shume dhe me shpejt permes niveleve te larta te ndotesve te shkarkuar, nder te cilet vendin e pare nga sasia e ze monoksidi karboni ne sasira te konsiderueshme. Vlerat e ndeshura jepen si mesatare mujore dhe krahasuar me normat shqiptare per kete ndotes (2 mg/ m3 si mesatare 24 oreshe dhje 6mg/m3 per nje çast te dhene), tregojne se nuk ka tejkalim te normes.

- Ozoni troposferik: burimi dhe situata. Rritja e perqendrimit te ozonit ne shtresat e uleta te atmosferes (ozoni troposferik) shkaktohet kryesisht nga gazet e shkarkimeve te automjeteve. Ndonese nuk njihet plotesisht mekanizmi i shnderrimit te ndotesve qe shkarkohen nga automjetet (hidrokarbure, okside azoti), krijimi i smogut fotokimik eshte rezultat i reaksioneve qe zhvillohen ne atmosfere ndermjet hidrokarbureve dhe oksideve te azotit, ne prani te drites se diellit. Reaksionet

Pasqyra 18. Permbajtja e Ozonit (03) ne Tirane dhe Durres, 1998(perqendrimi: mg/m3)

Qyteti	*Pikematja*	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtat
Tirane	I.SH.P	38.40	39.64	63.54	56.00	61.36	56.00	76.12	47.40	30.
	Bashkia	25.80	20.38	29.65	32.57	37.18	36.04	52.29	13.97	10.
	Sheshi Ataturk	34.07	16.06	23.42	29.83	39.41	46.37	63.13	-	15.
	Lab. Kont. Barn	30.82	20.59	39.22	41.16	63.84	60.91	82.30	17.18	12.
	Shtepi femije	22.01	25.03	29.75	38.73	54.50	53.17	57.64	11.84	
	Stadiumi Dinamo	22.99	27.48	30.95	33.05	71.30	41.29	38.37	12.03	12.
Durres	Bashkia	23.91	24.05	40.67						

fotokimike japin oksidues, kryesisht ozon, i cili ka efekte te dukshme te smogut fotkimik siç jane ngacmimi i syve, efekte te fuqishme ne sistemin e frymemarrjes, veçanerisht kur ky eshte i prekur per arsye te ndryshme, zvogelimi i pamjes dhe demtimi i bimesise.

Ne pasqyre jepet ecuria e vlerave mesatare mujore te ozonit troposferik. Sikurse mund te pritet, keto vlera rriten gjate muajve te nxehte te vitit. Duke pasur parasysh normen prej 235 mg/ m3 qe jepet ne literature per kete ndotes, shihet se ne te gjitha rastet nuk verehet tejkalim i normes se lejuar per permbajtjen e ozonit ne shtresat e uleta te atmosferes.

Nga sa eshte trajtuar me siper mund te arrihet ne perfundimet:

- Ne periudhen 1997-98 ka ulje te metjshme e te ndjeshme te shkarkimeve te dioksidit te squfurit dhe te lendes se grimcuar nga burimet stacionare. ulje kjo qe detyrimisht do te reflektohet me nje ulje te mesatares se perqendrimit te ketyre dy ndotesve ne ajrin urban.
- Pakesimi i shkarkimeve te oksideve te azotit nga burimet stacionare nuk do te reflektohet ne pakesimin e perqendrimit ne ajrin urban, per shkak te rritjes se shkarkimeve nga mjetet e transportit.
- Kontributi i mjeteve te transportit ne ndotjen e ajrit me okside azoti do te rritet pavaresisht nga fakti i futjes se makinave me cilesore, te cilat shkarkojne shume me pak okside azoti se makinat e futura ne vitet e para te 90-tes.
- Se bashku me rritjen e numrit te mjeteve te transportit mund te pritet nje rritje graduale e vlerave te ozonit permes perqendrimit-kufi te lejuara ne shtresat e uleta te atmosferes. veçanerisht ne qytet e medha.

III. POPULLSIA E TIRANES DHE LEVIZJA MIGRUESE

Treguesit demografik perbejne nje instrument te fuqishem te drejtimit dhe administrimit urban dhe nderurban, midis komunave dhe brenda komnave. Te njohesh popullsine e qytetit, te komunave, brenda dhe midis tyre, karakteristikat e saj, do te thote te njohesh elementet e adminstrimit demografik, te cilat lidhen ngushte dhe reciprokisht me variablat e tjera ekonomike dhe sociale.

Pasqyra 19. Te dhena per popullsine ne vite *(ne mije banore)*

Viti	Popullsia e rrethit	Popullsia e Tiranes
1923	33.5	10.8
1938	54.1	25.1
1945	103.0	60.0
1950	114.2	80.6
1960	194.9	136.3
1970	254.0	171.3
1980	290.9	197.0
1990	368.2	253.1
1995	476.1	328.4
1998	610.1	423.7
1999	627.2	436.0

Ne vitin 1923 popullsia e Tiranes arrinte ne 10.800 vete dhe ne vitin 1945 ne rreth 60 mije vete, me nje rritje mesatare vjetore prej 108.1%. Ne vitet 1950 - 1990 popullsia e Tiranes eshte rritur mesatarisht per 102.9%, ndersa ne periudhen 1990-1999 me nje ritem mesatar prej 107.4%. Por, po te kihet parasysh ekzistenca e nje numri banoresh te paregjistruar gjate ketyre 10 vjeteve te tranzicionit, atehere kuptohet qe rritja eshte edhe me e madhe.

Gjithashtu, duke patur parasysh bumin urban te dhjetevjeçarit te fundit te ketij shekulli duhet theksuar se Tirana eshte qyteti me rritjen me te madhe, rritje e cila e krahasuar me ritmet e ndryshimit te popullsise se vendit, tregon per mbipopulliimin e shpejte te qytetit te Tiranes dhe per problemet e medha qe ky mbipopullim shkakton ne jeten e perditshme ekonomike dhe sociale te qytetit. Nje rritje e tille kerkon njohjen e karakteristikave sasiore dhe cilesore, jo vetem per menaxhimin territorial, por edhe per perfshirjen e popullsise, si pjese integrale e politikave te zhvillimit.

Analiza e ndryshimit te popullsise se qytetit te Tiranes pas vitit 1990 tregon per nje rritje te dukshme te popullsise sidomos ne vitet 1994 - 1996. Gjykohet se ky ndryshim ka ardhur si pasoje e rritjes ekonomike te vendit ne keto vite dhe sidomos e sasise se madhe te parave qe shqiptaret qarkullonin neper duar nga lulezimi ifirmave rentjere.

Sipas hartes me te fundit lokale, qyteti i Tiranes eshte i ndare ne 11 njesi administrative, me numer popullsie nga 22-65 mije banore secila. Ketu duhet theksuar se zonat me te populluara jane ato te njesive 1, 4, 11, 5, ne te cilat banon mbi 50% e popullsise se qytetit. Shperndarja e pabarabarte e popullsise brenda njesive te ndryshme percaktohet nga faktore te ndryshem, si kerkesa dhe oferta e tregut te banesave, deshires se individit dhe familjes per banim dhe mundesive konkrete te banimit, etj. Por natyrisht, duhet theksuar qe ndryshueshmeria me e vogel midis njesive ofron me teper mundesi per nje menaxhim me te mire.

Rritja e madhe e popullsise se Tiranes duhet t'i atribohet me teper migrimit (saldo migruese pozitive), sesa rritjes natyrore. Vihet re nje saldo me e madhe migruese ne njesite 4,5,6,7 dhe 11, duke treguar se keto jane njesite me terheqese per migrantet

Pasqyra e meposhtme tregon qarte se te ardhurit ne Tirane zakonisht vijne nga jashte rrethit dhe jashte qytetit, ndersa te larguarit pergjithsisht jane transferime nga njera njesi e qytetit ne tjetren, duke treguar keshtu se rritja migruese e Tiranes do te vazhdoj edhe ne te ardhmen.

Keto te dhena tregojne se 84% e te ardhurve vijne nga jashte qytetit te Tiranes, duke e

Pasqyra 20. Levizja migruese ne Tirane

Nr	Drejtimi nga vijne te ardhurit	%	Drejtimi ku shkojne te larguarit	%
1	Jashte Tiranes nga fshati	39	Brenda Tiranes ne qytet	82
2	Jashte Tiranes nga qyteti	34	Brenda Tiranes ne fshat	8
3	Brenda Tiranes nga qyteti	16	Jashte Tiranes ne qytet	7
4	Brenda Tiranes nga fshati	11	Jashte Tiranes ne fshat	3

rritur ate dhe vetem 18% largohen nga qyteti i Tiranes per ne drejtime te tjera.

Me kalimin e viteve, Qyteti i Tiranes ka krijuar tre satelitet e vete (Kamza, Vora, dhe Kraba (2276 banore)). Ne keto 10 vjetet e fundit keto qytete te vogla jane rritur jo thjeshte nga rritja natyrore e popullsise, por edhe nga levizja migruese, ku me e fuqishme kjo levizje eshte ne drejtim te Kamzes, si sateliti me i afert i Tiranes. Ritja e popullsise se Kamzes ne keto 10 vite eshte (1990 eshte 5.6 mije banore dhe ne 1998 eshte 14.2 mije banore) 112.3%.

Pasqyra 21. Te dhena mbi popullsine e rajonit te Tiranes

Qytetet	Deklarimi i Zyrave te Gjendjes Civile 31.12.1997		Deklarimi i Zyrave te Gjendjes Civile 31.12.1998		Ndryshim	Ndryshim
	Popullsia	Familjet	Popullsia	Familjet	Popullsise	Nr. familje
TIRANE	345	109	423	134	78	25
KRRABE	2		2			
KAMEZ	7	2	14	3	6	1
VORE	4	1	5	1	1	
Gjithsej	359	112	445	139	86	26

Pra, vihet re se vetem ne periudhen 1997 – 1998 (gjate nje viti), popullsia qytetare e Tiranes dhe e qyteteve satelite te saj eshte rritur mjaft. Ne keto kushte, vetem popullsia e Tiranes eshte shtuar per 78.624/345.049=22.8%, gje qe flet per nje "bum urban" qe po perballon qyteti i Tiranes. Proçesi i rritjes se madhe te Tiranes e ben teper te veshtire dhe shume te kushtueshme nga ana ekonomike nderhyrjen efikase te qeverise dhe te organeve te pushtetit lokal per plotesimin e nevojave baze si uje, energji elektrike dhe kanalizimet e ujrave te zeza. Per me teper, kjo rritje e Tiranes po shtrihet edhe ne toka produktive bujqesore, duke sjell ne kete menyre konsekuenca te rendesishme per popullsine dhe per te ardhmen ekonomike te vendit. "Bumi urban" ne vendin tone dhe veçanerisht per Tiranen po ballafaqohet me keto probleme:

- A do te jene ne gjendje qytetet (Tirana) qe te perballojne periudhen e tranzicionit sipas regullave te reja te lojes?
- A do te jete e afte struktura e sotme urbane te rezistoje ndaj "operacioneve" te kushteve te reja?
- Ç'operacione" te tjera do behen dhe cila do te jete kostoja urbane dhe abjentale qe do te paguhet per to?

Krahas rritjes se popullsise se qyteteve satelite vihet re edhe nje rritje e numrit te familjeve me shume anetare. Kjo vjen pasi me te prirur drejt emigrimit jane familjet e varfra dhe me shume pjestare, duke qene se ato kane edhe me teper probleme ne vendin origjine. Por, duhet theksuar se gjithashtu keto familje ka mundesi te jene edhe me problematike edhe ne zonen destinacion.

Pervoja boterore deshmon se qytetet satelite jane nje ide e mire dhe e perdorur me sukses si strategji zhvillimi dhe urbanizimi ne vende te ndryshme si ne Japoni, Kore e Jugut, Poloni, etj.. pasi ato nuk lejojne grumbullimin e madh te banoreve ne kryeqytet ose ne qytetet e medha, por krijojne mundesi per nje shperndarje te popullsise ne zonen periurbane. Ne keto raste, problemi shtrohet se cilat jane tiparet qe duhet te marrin qytetet satelite, ku me teper theks duhet kushtuar ndaj tipareve te urbanizimit ne raport me tiparet e rirruralizimit urban.

Ne se do te analizohen te dhenat demografike te komunave te Tiranes, do te vihet re se komunat me terheqese jane veçanerisht Kamza dhe Paskuqani e me pas tyre edhe Zallherr, Vaqar dhe Vore. Ndersa komunat me pak terheqese, por gjithsesi me saldo migruese pozitive, jane komunat e Kasharit, Dajtit, Petreles, Prezes, Berzhites dhe Pezes. Pra, synohen me teper komunat qe jane me afer Tiranes dhe me pak ato qe jane me larg dhe ne zona malore. Tipar tjeter i levizjes se popullsise ne komunat e Tiranes eshte se ne keto kumuna ka shume te ardhur dhe shume te larguar, por ne te gjitha komuna se bashku ka me shume te larguar. Kjo prirje vihet re per arsyen se nje pjese e komunave kane kushte relativisht te mira dhe sherbejne si nje baze per migrimin me etapa. Pra, te ardhurit nga zona shume te varfra te vendit, sidomos nga zonat

veriore dhe verilindore, vijne ketu sepse gjejne kushte me te mira dhe çmim te banesave relativisht me te lira (por gjithsesi jane prane qytetit te Tiranes) dhe ne nje etape te dyte, mbas permiresimit te kushteve ekonomike, mund te tentojne per nje etape te dyte migrimi drejt rrethinave ose brenda Tiranes. Pasqyra e meposhtme tregon se dukurite e ardhjes dhe largimit ne komunat e rrethit te Tiranes kane prirje te ndryshme.

Keshtu te ardhurit ne pergjithesi vijne nga fshatrat si jashte dhe brenda rrethit te Tiranes (95%), ndersa te larguarit ne pjesen me te madhe te tyre bejne nje zhvendosje te vogel, duke mbetur brenda rrethit (97%), prej te cileve 66% tentojne te levizin nga fshati ne drejtim te qytetit dhe 31% ne drejtim te komunave te tjera, ku kushtet ekonomiko sociale jane me te favorshme. Nga ana tjeter, ashtu si levizja nga qyteti ne fshat eshte shume e ulet (5%), po ashtu mjaft e ulet eshte edhe largimi i banoreve nga rrethi i Tiranes (3%). Ne keto kushte, ndermarrja e politikave te drejta te zhvillimit duhet te behet jo vetem duke studjuar treguesit baze te ndryshimit te popullsise ne pergjithesi dhe levizjen migratore midis rretheve dhe zonave te ndryshme, por duke i studjuar keto dukuri me ne detaje, pra edhe zhvendosjen brenda rrethit (sidomos per Tiranen) dhe zhvendosjet midis njesive te ndryshme administrative te qytetit te Tiranes. Vihet re se njesite administrative me te populluara jane ato qe kane edhe numrin me te madh te personave per nje familje dhe ku varferia eshte edhe me e madhe. Keto kushte behen nje baze per rritjen ne potence te dukuri te tilla si kriminaliteti, droga, prostitucioni, etj., sepse eshte i njohur korelacioni i madh midis varferise dhe dukurive negative te sistemit shoqeror qe po jetojme.

Pasqyra 22. Levizja migruese ne komunat e Tiranes

Nr	Drejtimi nga vijne te ardhurit	%	Drejtimi ku shkojne te larguarit	%
1	Jashte rrethit nga fshati	81	Brenda rrethit ne qytet	66
2	Brenda rrethit nga fshati	14	Brenda rrethit ne fshat	31
3	Jashte rrethit nga qyteti	3	Jashte rrethit ne fshat	2
4	Brenda rrethit nga qyteti	2	Jashte rrethit ne qytet	1

Gjithashtu duhet theksuar se mes prirjeve te pergjithshme te migrimit te popullsise, migrimi drejt Tiranes dhe zones urbane dhe rurale te rrethit te Tiranes eshte me i fuqishmi, sepse ketu perqendrohen me nje intensitet mjafte te larte te gjitha llojet dhe format e zhvendosjes se popullsise, si nga fshati ne qytet, nga zonat malore drejt zonave kodrinore e fushore, nga qytetet e vogla drejt qyteteve te medha, nga zonat me te pazhvilluara drejt zonave me te zhvilluara, nga i gjithe vendi drejt kryeqytetit etj. Por, studimi ne teresi dhe ne detaje i kesaj dukurie kerkon nje sistem evidentimi dhe perpunimi me te perparuar, duke e bere imperativ te kohes ndertimin e nje sistemi me te plote evidencash statistikore per studimin e popullsise dhe sidomos informatizimin e ketij sistemi evidencash. Sipas konsideratave te mesiperme, mund te vleresoet evolucioni i popullsise se Tiranes per 5 vjetet e ardhshem. Duhet theksuar se evolucioni ka lidhje esenciale me popullsine ne moshe pune. Baza e migrimit eshte zhvendosja drejt kushteve me te mira te punes dhe te jeteses. Ne kushtet aktuale eshte vene re se migrantet kryesisht jane familje qe ne pjesen me te madhe te tyre kane ne baze forcat aktive te punes. Kjo do te thote se, ne qytetin e Tiranes vetem per te perballuar shtesen e forcave aktive te punes qe vjen si resultat i migrimin e brendshem do te jete e nevojshme te krijohen te pakten 7-8 mije vende te reja pune ne çdo vit, te cilat duhet t'ju shtohen vendeve te punes qe duhet te krijohen per zbutjen e papunesise dhe per shtesen e forcave aktive te punes qe vjen si pasoje e shteses natyrore te popullsise.

Pasqyra 23. Hipotezat ne lidhje me popullsine e Tiranes

Emertimi		2000	2005
Gjendja aktuale (31 Dhjetor 1998)	423.700 banore		
Rritja natyrore (2.0% ne vit)	8500 persona ne vit		
Migrimi ekzistues (ardhje – largime)	12000 persona ne vit		
Rrjedhje te reja Hipoteza 1 Hipoteza 2	 12000 persona ne vit 15000 persona ne vit		
Gjithsej Hipoteza1 Hipoteza 2		 464.700 470.700	 567.200 588.200

IV. PUNESIMI

Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale llogarit qe rajoni i Tiranes ne muajin Tetor 1999 kishte 164 mije forca aktive, nga te cilat 33.252 rezultojne te papune dhe qe perfaqsojne nje nivel papunese prej 21.4%, nga 18% qe eshte niveli mesatar i Republikes. Si renditje rajoni i Tiranes reshtohet i gjashti per papunesine e larte. Nga numri i mesiperm i te papuneve, 11847 jane meshkuj dhe 14563 femra ose respektivisht 42% dhe 44%. Pjesa dermuese e te papuneve prej 31.301 ose 93.7% e tyre jane te papune te perhereshem (kronik).

Pasqyra 24. Struktutra e te papuneve sipas grupmoshave dhe shkalles arsimore per te papunet kronik, Tetor 1999

Te papune gjithsej	33301
Sipas moshes	
- deri 20 vjeç	5160
- 21-34 vjeç	15875
Sipas nivelit arsimor	
- tetevjeçar	13146
- i mesem	16635
- i larte	1520

Nga analiza e pasqyrave te meposhtme arrihet ne perfundimin se papunesia po behet gjithnje e me teper problem teper shqetesues. Papunesia ne tre vjetet e fundit ka tendenca rritjeje. Nga viti 1997 e deri ne Tetor 1999, te papunet jane shtuar me 5867 vete, duke perfaqsuar 21% te forcave aktive per pune. Kjo dukuri eshte alarmante sidomos per mshat e reja. Keshtu te papunet me moshe deri ne 20 vjeç dyfishohen, ndersa mosha e grupit 24-34, qe eshte pjesa me vitale e forcave te punes, perfaqson rreth 50% te te papuneve.

Pasqyra 25. Niveli i papunesise, 1997 dhe 1998

Emertimi	Fundi i vitit	Nga gjithsej sa k/familjar	Sipas moshes			Sipas nivelit arsimor		
			deri 20 vjeç	21-34	mbi 35 vjeç	tete-vjeçar	i mesem	i larte
Te papune **1997**	27563	11571	2528	14219	10816	11855	14989	719
Te papune **1998**	33252	13955	5710	16950	10592	14404	18185	663
Diferenca 1998-1997	+5689	+2414	+3182	+2731	-224	+2549	+3196	-56

Burimi: Drejtoria e Statistikes. Bashkia e Tiranes

Mungesa e investimeve private, por edhe te atyre shtetrore, ne sektoret qe angazhojne me shume fuqi punetore, sidomos ne industri dhe zgjerimi i privatizimit te sektoreve strategjik gjykohet se do te thellojne me tej dukurine e papunesise. Duke shkuar me tej, alarmant behet problemi i shtimit te te papuneve kryefamiljar. Ne fund te vitit 1998, ne krahasim me vitin 1997, numri i tyre eshte rritur 21%.

Pasqyra 26. Numri i te zeneve ne pune ne sektorin publik

Vitet	Nr. mesatar i punonjesve	Gjendja ne fund	Fondi i pagave (milione leke)	Paga mesatare mujore
1993	67200	58933	2246	2785
1994	54162	50912	3046	4686
1995	46771	45110	3546	6318
1996	41993	41870	4629	9186
1997	38838	38861	4765	10224
Buxhetor 1997	24506	24482	2839	9654
Jo buxhetor 1997	14332	14379	1926	11199
1998	37042	36641	5706	12837
Buxhetor 1998	23944	23706	3705	12896
Jobuxhetor 1998	13098	12835	20001	12730

Burimi: Drejtoria e Statistikes. Bashkia e Tiranes

Niveli i rritjes se papunesise ne rajonin e Tiranes mund te studjohet edhe nga pikpamja e punonjesve te zene ne pune. Sipas te dhenave statistikore te Bashkise se Tiranes, numri i te

zeneve me pune ne sektorin publik jepet ne pasqyren 26. Shifrat e mesiperme flasin per gati pergjysmim te punonjesve te zene ne pune, nga 67.200 ne vitin 1993 ne 37.042 ne fund te vitit 1998. Arsyet e kesaj uljeje jane dy:

- largimi nga puna i punonjesve per arsye te privatizimit apo te likujdimit te ndermarrjeve;
- largimet nga puna te punonjesve, per arsye te shkurtimeve dhe ristrukturimeve ne administraten shtetrore si dhe te sektoreve buxhetor (arsim, shendetesi, etj.). Me nivelin e punesimit eshte e lidhur drejtperdrejte edhe politika sociale qe ben shteti per te ndihmuar familjet qe kane mbetur pa pune per arsyet e permendura ose qe kane te ardhura minimale.

Pasqyra 27. Te dhena per ndihmen ekonomike per rajonin e Tiranes

Viti	Familje qe marrin ndihme ekonomike			Fondi i ndihmes ekonomike (mije leke)		
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat
1993	15530	10145	5405	38228	41242	41980
1994	27128	13410	13748	550935	419569	131366
1995	22446	13526	8920	482028	381636	100392
1996	18908	12855	6053	420402	333468	86934
1997	17249	11805	5444	44113	350800	90313
1998	16753	11273	5480	513716	395040	118676

Keto shifrat jane shume te larta. Ato jane kushtezuar nga numri i te papuneve te tepert per shkak te ndryshimeve strukturore qe ka pesuar ekonomia dhe te ndryshimeve te sistemit, te cilat perfshihen ne koston e tranzicionit dhe qe shteti ne kuadrin e politikes sociale duhet te trajtoje familjet e tyre me ndihme ekonomike.

Por, ne te njejten kohe, duhet pranuar qe edhe ne kete fushe, sidomos ne vitet 1994-1996 (siç tregojne shifrat dhe ka vertetuar praktika) spekullimet kane qene masive. Kjo kursesi nuk do te thote qe edhe sot nuk ka familje qe perfitojne padrejtesisht. Gjithsesi, nje seleksionim perfekt ne kete mori te papunesh eshte teper e veshtire, per te mos thene e pamundur.

Pasqyra 28. Dinamika e numrit te pensionisteve te rajonit te Tiranes

Vitet	Numri i pensionisteve			Rritmi rritjes popullsise	Rritmi rritjes pensionisteve
	Gjithsej	Qytet	Fshat		
1993	69901	62897	6914	100	100
1994	70654	63361	7293	117.7	101.1
1995	72259	64451	7806	123.9	103.4
1996	75749	66979	8770	1458	108.3
1997	78876	69292	9614	153.6	112.8
1998	95052	78924	16128	166.6	135.9

Ne kuadrin e politikes sociale shteti harxhon shuma te medha per te perballuar numrin e pensio-nisteve, i cili ka rritje te ndjeshme.

V. ZHVILLIMI EKONOMIK

V.1. Prirjet e Zhvillimit te Biznesit ne Rajonin e Tiranes

Pervoja boterore per zhvillimin e vendeve te varfera njeh dy rruge:

- *Pervoja e pare,* inkurajimi dhe mbeshtetja e biznesit te madh, sidomos atij industrial.
- *Pervoja e dyte*, inkurajimi dhe mbeshtetja e biznesit te vogel.

Te dyja rruget kane dhene rezultate te rendesishme zhvillimi. Shtetet qe ndoqen rrugen e pare, pershpejtuan perqendrimin e kapitaleve dhe ndertimin e ndermarrjeve shume te fuqishme, qe aktualisht konkurrojne ne tregun boteror. Kjo rruge çoi ne diferencimin e madh te shoqerise dhe, per rrjedhim, ne tensione sociale, greva, demostrata, ndryshime te shpeshta te qeverive. Vendet qe ndoqen rrugen tjeter, ate te inkurajimit dhe biznesit te vogel, siguruan nje zhvillim te qendrueshem, mireqenie te pergjithshme ne ngritje, permiresim te eksporteve.

Per Shqiperine, nje vend ku mungonin kapitale per te ndertuar ndermarrje te medha, rruga e zhvillimit te bizneseve te vogla ka qene dhe mbetet rruga kryesore e zhvillimit. Pothuaj te gjitha bizneset private qe operojne ne vend, perfshire edhe ato te rajonit te Tiranes, mund dhe duhet te percaktohen si bisnese te vogla dhe te mesme. Nga vrojtimet e realizuara, vetem 0.2 % e kompanive kane mbi 100 punonjes, çka do te thote se politika shteterore e ndjekur deri tani ne Shqiperi per zhvillimin e sektorit privat duhet konsideruar politike e zhvillimit te sektorit te vogel dhe te mesem.

Zhvillimi i SME-ve eshte mbeshtetur nga Qeveria dhe organizma e organizata nderkombetare. Ne kuader vendi ne vitin 1991 u regjistruan 2 mije SME, ne vitin 1993 ky numer u rrit ne 9 mije dhe ne vitin 1994 arriti 16.400, nderkohe qe ne vitin 1997 pati nje renie nen 3 mije dhe perseri rritje ne 4.800 ne vitin 1998. Ky cikel zhvillimi sektorit privat perkoi me zhvillimin ekonomik - zhvillimi e renia e skemave piramidale, ecuria e procesit te privatizimit, situata politike dhe e rendit, etj.

Nje nga momentet per t'u analizuar jane fondet per linja krediti qe jepen nga donatoret, si hua te buta, dhe qe qeveria i kalon ato tek bankat si kredi tregtare, kuptohet me normat e interesave te tregut bankar. Keto te fundit vazhdojne te jene shume te larta, duke zvogeluar ne kete menyre kreditimin e biznesit.

Nga anketimet e kryera rezulton qe 82% e kompanive kane nevoje per kredi. Me shume se gjysma e tyre pohojne se kredia u duhet per qellime investimi dhe jo per kapital qarkullues. Teknologjia e kompanive te intervistuara dominohet nga pajisje te perdorura. Kompanite kane nevoje per permiresime teknologjike dhe mbeshtetje financiare dhe asistence teknike per perdorimin e kesaj teknologjie. Kjo eshte me e dukshme ne sektoret e prodhimit dhe te ndertimit, fakt ky qe lidhet me permiresimin e cilesise. Produktet dhe sherbimet qe sigurojne kompanite e rajonit te Tiranes destinohen pothuaj teresisht per tregun e brendshem.

Aktualisht, nder shqetesimet kryesore te biznesit, krahas burimeve financiare, mbetet niveli i informacionit per konjukturen e tregjeve te jashtme. Tjeter shqetesim i biznesit vazhdon te jete legjislacioni i komplikuar dhe ndryshimet e shpeshta te tij, perfshire ketu edhe zbatimin e Ligjit per Konkurrencen.

Pjesa dermuese e te intervistuarve, rreth 70%, mendojne se hartimi i nje strategjie per zhvillimin e SME-ve eshte e domosdoshme. Problemet qe ata nenvizojne si pengesa per zhvillimin e biznesit jane:

- Burimet e pamjaftueshme financiare;
- Konkurrenca e pandershme

- Burokracia administrative dhe korrupsioni;
- Mungesa e informacionit per tregjet dhe konjukturen e tyre;
- Fallsifikimi dhe fshehja e dokumentave nga shume biznese;

Teorikisht pranohet qe rritja ekonomike shprehet nepermjet tre matesave:

- Rritjes se prodhimit ne teresi
- Rritjes se zenies me pune
- Rritjes se te ardhurave per fryme

Arritja e objektivave te mesiperme mund te behen realitet vetem n.q.s. ne kuader rajoni, hartohet dhe punohet ne baze te nje strategjie te pergjithshme rajonale, pjese e se ciles te jete ajo e SME-ve; disa nga objektivat kryesore te se ciles mund te permblidheshin:

- Rritje e PBB te rajonit;
- Percaktimi i Prioriteteve, sektoriale (Industri: riaktivizimi i ndermarrjeve te privatizuara dhe atyre te ndaluara; Bujqesi: prodhim perimesh, rush, fruta, qumesht; Agrobisnes; Industri e lehte; Turizem; Ndertim; Transport; Sherbime;
- Asistim ne sigurimin e pronesise industriale;
- Asistim ne informacionin per mundesite e sigurimit te teknologjise dhe permiresimit te tyre;
- Asistim i trajnimit te menaxhereve sipas standarteve europiane;
- Rritje e nivelit te punesimit, nepermjet krijimit te vendeve te punes, sidomos ne industri qe siguron nje punesi te larte;
- Prodhim per eksport: perime, bostan, industrise se lehte e artizanatit, lekure, etj.
- Zhvillimi i infrastruktures: arsimore, kulturore, shendetesore dhe sherbime komunale.
- Nxitjen e investimeve te huaja, por edhe atyre te vendit ne fushen e prodhimit;
- Lehtesite financiare ne fushen e kreditimit (norma interesi, kolateral, sistemin e pagesave ne banka, etj.), ne politiken tatimore; doganore; krijimi i Fondeve te Zhvillimit;
- Mbrojtje te mjedisit

V.1.1 Tirana si nje zone potenciale biznesi: Avantazhet dhe Disavantazhet

Ka nje numer kriteresh kryesore qe nje investitor (i huaj) potencial merr ne konsiderate. me qellim qe te zgjedh nje vend dhe brenda tij nje rreth te caktuar per te ndertuar fabriken e vet. Ne nivelin kombetar, avantazhet dhe disavantazhet e Shqiperise si nje zone potenciale biznesi mund te pergjithesohen si me poshte:

Avantazhet

- mundesi biznesi te pashfrytezuara dhe tregje te brendshme;
- fuqi punetore me kosto te ulet, e arsimuar dhe fleksible;
- burime bujqesore dhe minerare te pashfrytezuara;
- permiresimi i struktures ekonomike dhe i klimes se investimeve;
- afersia ndaj tregjeve te Europes.

Disavantazhet

- stabilitet social dhe politik i paqendrueshem;
- probleme te brendshme te sigurise;
- kapacitete te uleta institucionale dhe te drejtimit;
- infrastrukture e dobet teknike dhe sociale;
- pronesi toke e paqarte.

Ne kete kuader, rajoni i Tiranes ka disa avantazhe baze, ne krahasim me rajone te tjera te Shqiperise, ne kuader te pozicionit potencial te biznesit. Keto jane:

Vendndodhja: Tirana ndodhet ne qender te vendit ku kryqezohen te gjitha koridoret. Keto rruge sigurojn lidhjen kryesore midis Greqise, Maqedonise, Bullgarise dhe Detit te Zi me pjesen tjeter te Europes perendimore.

Rezervat bujqesore: Rrethi ka toke pjellore te afte per kultivime bujqesore intensive.

Fuqia punetore: Prania e investimeve te huaja ne rreth po krijon tek popullsia nje

mentalitet industrial.

Qyteti: Pavaresisht nga kushtet e keqia te infrastruktures teknike dhe sociale dhe te problemeve te ndotjes se mjedisit, qyteti ka nje qender te gjalle dhe terheqese, qe tregon shenjen e pare te qarte te nje prospekti dinamik, veçanerisht ne tregti dhe ne drejtim te argetimit.

V.1.2 Investimet e huaja ne industri

Ndermarrjet industriale te huaja jane me nje rendesi te madhe ne ekonomine e Tiranes.

Nga te dhenat vihet re nje peshe e madhe e investitoreve te huaj ne aktivitetin e biznesit ne Tirane. Me teper ata jane te perqendruar ne aktivitetet kryesore te industrise, transportit, bujqesise, tregti dhe ne ndertim dhe me pak ne sferen e sherbimeve.

Pasqyra 29. Numri i ndermarrjeve te huaja dhe te perbashketa sipas degeve te industrise

Emertimi	Gjithsej		Kompani		% e j.v dhe te huaja ndaj totalit
	P. juridik	Vendase	Te perbashketa	Te huaja	
Gjithsej	6504	4058	1327	1119	37.6
Bujqesi	59	40	12	7	47.5
Industri	906	608	171	127	49.0
Ndertim	527	384	77	66	37.2
Tregti	4087	2463	903	721	39.7
Transport	267	152	60	55	43.1
Sherbime	658	411	104	143	22.3

Gjate krizes se 1997, shume nga ndermarrjet e huaja u demtuan, por per nje periudhe te shkurter shumica e tyre arriten nje rigjenerim te plote. Bazuar ne intervista dhe ne informacione te tjetra cilesore, mund te behet dallimi e ndermarrjeve te huaja sipas vendimit strategjik dhe maredhenieve te tyre me Shqiperine, duke i ndare ne dy grupe kryesore:

Grupi i pare bashkon ndermarrjet qe kane investuar ne Tirane bazuar ne shpresat per fitim ne periudhe afatshkurter, duke shfrytezuar avantazhin e nivelit te ulet te pages, perdorimin e fuqise se dores dhe kualifikimin e fuqise punetore ne deget tradicionale. Pa perjashtuar nje rishikim te politikes ne kushte me te mira te stabilitetit ekonomik dhe social, keto firma nuk mund te konsiderohen si perdorues potencial te Parkut Industrial. Me rezerva te forta, eshte vleresuar se ky lloj sipermarresi perben rreth 50-60% te ndermarrjeve industriale te huaja te krijuara ne Tirane. Per keto ndermarrje nuk jane nenvleftesuar nevojat e e mundesive te realokimit, por prioritetet e tyre me kalimin e kohes fokusohen ne aktivitete te tjera sipermarrese, qe premtojne rezultate te menjehereshme dhe sjellin me pak te ardhura.

Grupi i dyte bashkon ndermarrje qe kane vendosur te investojne ne Tirane per nje perspektive afatgjate, duke patur parasysh avantazhet krahasuese strategjike te vendit. Keto ndermarrje jane fokusuar ne krijimin e kapitaleve te fuqishme, st: uktura funksionale dhe administrative ne vend, te inkorporuara ne ekonomine shqiptare. Shumica e tyre kane marre me qera fabrika te vjetra, me çmime relativisht te larta, duke mos plotesuar teresisht nevojat e tyre te tashme ose te ardhshmen. Duhet te permendim se disa nga investitoret e huaj tashme kane shprehur interesa te fuqishme ripozicionimi dhe mund te konsiderohen si perdorues potencial te Parkut Industrial

Nje pike tjeter me interes eshte se shume banka te huaja kane hapur aktivitetin e tyre ne Tirane dhe ato jane te gatshme te ekzaminojne alternativat e programeve te financimit te zgjerimit dhe te rinovimit, sidomos per ndermarrjet e huaja dhe ato te perbashketa ne kete rajon.

Si perfundim, zhvillimi i Parkut Industrial mund te sjell nje ripozicionim te interesave te investimeve nga ana e investitoreve te huaj. Duke marre parasysh madhesine e rendesishme te ketyre investimeve, ky interes duket te konsiderohet nje faktor pozitiv, ne baze te te cilit mund

te bazohet vendimi per nje Park Industrial. Gjithashtu, ekzistenca e Parkut Industrial do te riforcoje fuqishem berjen terheqese te zones per investitoret e huaj (shumica nga vendet fqinje). Nga ana tjeter, eshte gjithashtu korekte te theksohet se asnje investor i huaj potencial nuk do te mendoj te mos investoj ne Shqiperi nga mungesa e Parkut Industrial. Kapercimi i te gjitha papershtashmerive strukturore te ekonomise shqiptare eshte konsideruar si prioriteti i pare investues, perpara se te proçedohet me vendimin per strategjne e vendndodhjes se investimit.

V.1.3 Investimet industriale te shqiptareve

Ka afersisht rreth 4058 ndermarrje shqiptare, nga te cilat 608 ndermarje ne industri. Pjesa me e madhe e ndermarrjeve shqiptare jane te vogla, qe punesojne me pak se 5 punetore dhe veprojne ne kuadrin e pronesise dhe aktivitetit te familjes. Problemet kryesore qe perballojne ndermarrjet shqiptare mund te grumbullohen si me poshte:

- Paisje te vjetra;
- Financimi;
- Hyrja ne treg;
- Menaxhimi dhe sistemi i veprimtareise;
- Njohurite teknike dhe te menaxhimit.

Sipas kultures se biznesit dhe sjelljes sipermarrese, dallohen tre tipe ndermarrjesh:

- Ndermarrje, shumica te zoteruara nga individe dhe me aktivitet familjar, qe realizojne prodhimin e produkteve tradicionale dhe kane nje sistem shitje dhe menaxhimi te pazhvilluar. Ne pjesen me te madhe ato jane ndermarrje shume te vogla. Gjithashtu, eshte e sigurte se disa prej tyre do ta gjejne pozicionin e tyre ne treg ne vitet e ardhshme, por ky tip ndermarrjesh nuk mund te quhet me fleksibilitet te mjaftueshem dhe i axhustueshem ndaj kerkesave te reja te biznesit.
- Ndermarrje qe duhet te mbajne strukturen tradicionale, por qe kane aftesine e nevojshme per tu perfshire ne mjedisin e ri te biznesit.
- Ndermarrje qe, pavaresisht nga papershtashmerite strukturore, mund te konsiderohen si lojtar te rendesishem ne tregun lokal dhe me gjere, qe kane ne dispozicion mundesi serioze per te stabilizuar dhe forcuar pozicionin e tyre ne mjedisin e biznesit.

Ne lidhje me karakteristikat e veçanta qe konsiderohen te rendesishme, vetem nje pjese e dy tipeve te fundit te ndermarrjeve mund te konsiderohen si perdorues potencial te Parkut Industrial. Vleresimet sasiore jane krejt te veshtira dhe mund te çojne ne rezultate te gabuara. Sipas informacionit sasior dhe "ndjeshmerise" qe ne kemi patur duke punuar ne kete fushe, kjo pjese per momentin eshte ne minoritet te madh ne krahasim me ndermarrjet shqiptare ne total. Duke folur ne pergjithesi, duket e veshtire te parashikohet veprimi i ardhshem i sipermarresve shqiptare ne zhvillimin e Parkut Industrial. Per ta, kushtet e pasigurise ekonomike dhe jostabilitetit, penetrimi ne treg dhe struktura e prodhimit jane problemet kryesore qe duhet te perballojne ne kete moment. Si nje perspektive afatgjate, idea e nje parku industrial ne zone eshte trajtuar pergjithesisht ne menyre pozitive, por pa ndonje entuziazem te veçante.

Nga ana tjeter, vetem per pak ndermarrje shqiptare, qe kane patur sukses ne kapercimin e fazes se pare te punes dhe qe mund te konsiderohen si te stabilizuara ne kete zone, idea e nje parku industrial ndihet te jete nje alternative reale e biznesit te ardhshem. Lehtesirat siç jane furnizimi i regullt me energji, siguria, hapesirat, rruget e brendshme, stacioni i ndihmes se shpejte dhe i zjarrfiksave jane konsideruar faktore te rendesishem, por qe nuk jane faktoret e vetem per ripozicionimin. Çmimi i tokes dhe nxitje te tjera speciale per ripozicionim jane theksuar si krirere kryesore mbi te cilat do te merren vendimet per investime nga sipermarresit shqiptar.

Ne lidhje me prospektet e ardhshme jane vene re interesa nga sipermarresit shqiptare per te investuar ne industri dhe ne sherbime. Per shqiptaret, kushtet e pasigurise ekonomike dhe politike mund te konsiderohen si pengesa kryesore per te transferuar kapitalin nga kursimet private ne aktivitete investuese. Besohet se ekzistenca e Parkut Industrial do te inkurajoje iniciativa te reja investuese nga ana e ndermarrjeve shqiptare. Por, kjo eshte gjithashtu subjekt

i kufizimeve strikte siç jane kushtet ekonomike, nxitesat e ndryshem dhe mundesia per te mare kapital hua.

V. 2 Bujqesia

Ne vitin 1990 rrethi i Tiranes prodhonte rreth 6% te produktit bujqesor te vendit, duke shfrytezuar 33.2 mije ha toke bujqesore, nga e cila 23.4 mije ha ishte toke are, pemishte 3.2 mije ha, vreshta 2.1 mije ha, ullishta 4.4 mije ha. Ne te njejtin vit kishte rreth 18.5 mije koke lope, 50.4 mije krere dele, 45.9 mije krere dhi, 9.1 mije derra dhe 686.7 mije koke shpend shtepiak. Qe prej vitit 1990 bujqesia ka qene motori i rritjes se Shqiperise, duke rritur pjesen e vet ne PPB nga 40.2% ne 1990, ne 56.0% ne vitin 1997, dhe 55,6% ne vitin 1999. Kjo gje ishte pasoje e proçesit radikal te reformes, i aplikuar nga shteti shqiptar, e cila u fokusua ne shperndarjen e tokes dhe liberalizimin e tregut. Ne rrethin e Tiranes, e gjithe toka bujqesore eshte e privatizuar. Shumica e saj u eshte shperndare ne familjeve fshatare te rrethit, ne parcela te vogla. Produktet kryesore bujqesore ne rreth sot jane gruri, theker, miser, frutat, perimet. Produkte te tjera bujqesore te rrethit jane duhani, patatet, fasulet dhe elbi. Ne blegtori, rrethi ka rreth 26.5 mije lope, 57.2 mije dele, 40.1 mije dhi, 47 mije derra dhe 451.6 mije shpend shtepiak.

Problemet kryesore ne prodhimin bujqesor te rrethit jane:

- fragmentimi i tokes (fermeret zakonisht zoterojne 2 ose 3 parcela te vogla toke);
- kualifikimi i kufizuar per prodhimin dhe informimi i paket per problemet teknike dhe te marketingut;
- mungesa ose pamjaftueshmeria e sistemit te ujitjes se tokes;
- mungesa e kapitalit dhe e mundesive per ta marre hua;
- tregu i pamjaftueshem i lendeve te para dhe i prodhimit perfundimtar.

Megjithate, Tirana ka klime te favorshme per bujqesi dhe toka te plehruara. Nje program per shkembimin e ngastrave te tokave do te reduktonte problemin e fragmentimit te tokes. Kualifikimi i ulet per prodhimin dhe informacionin pritet qe te minimizohen me ndihmen e projekteve te aplikuara nga OJQ dhe institucione te ndryshme, siç jane FAP, UNIDO, QABI dhe te Dhomes se Tregtise, qe ofrojne kurse trajnimi dhe sherbime konsulence si per problemet teknike dhe marketingu. Gjithashtu, problemi i ujitjes do te jete me i vogel kur te plotesohet rinovimi i infrastruktures ekzistuese.

Bujqesia pritet qe te vazhdoje te veproje si motori i ekonomise shqiptare, te pakten edhe per disa vite, deri kur qeveria qendrore te marre masat e nevojshme per te mbeshtetur rritjen. Masat qe i referohen nivelit kombetar (permiresimi i liberalizimit te çmimeve dhe i regjimit tregtar, adoptimi i regullave me qellim permiresimin e standarteve te sigurise se ushqimeve, te krahasueshme me Bashkimin Europian, etj.) jane konsideruar se jane pertej qellimit te ketij studimi.

Me ndihmen e projekteve te OJQ-ve dhe institucioneve te ndryshme (veçanerisht FAP and QABI) prodhimi bujqesor i Tiranes pritet qe te rritet ne vitet e ardhme. Produkte kryesore priten te jene ato qe kultivohen edhe sot ne kete rreth, ne raporte pak a shume te njejta. Ato jane: gruri thekra, misri, perimet, frutat, patatja dhe foragjeret. Megjithate, kjo rritje varet shume nga bashkeveprimi efektiv midis projekteve, dhe gjithashtu nga pjesemarrja e fermereve ne keto projekte.

V.2.1 Vendi i bujqesise te rrethit te Tiranes ne rang vendi

Niveli i zhvillimit te bujqesise ne rajonin e Tiranes jepet i detajuar ne pasqyrat 6-13 tek aneksi.

V. 2.2 Gjendja e agro-biznesit ne rajonin e Tiranes. Prirjet dhe shqetesimet

Pasqyra 30. Fushat kryesore te agrobiznesit ne rajonin e Tiranes

Nr	Lloji i Agrobiznesit	Nr. subjekteve qe operojne
1	Fabrika bloje	12
2	Prodhues buke	138
3	Prodhues makarona	4
4	Biskoteri	3
5	Pije alkool	35
6	Prodhues birre	14
7	Prodhues pije freskuese	32
8	Prodhues qumeshti	13
9	Baxho	12
10	Prodhues sallami	11
11	Prodhues vaj ulliri	8
12	Prodhues karamele	6
13	Perpunues kafe	3
14	Pasticeri - byrektore	63
15	Konservim	2

Fushat kryesore te agrobiznesit qe operojne ne rajonin e Tiranes permblidhen:

- Kapaciteti ditor i fabrikave te blojes te rajonit te Tiranes eshte 505 ton drith, ne nje kohe qe nevoja per miell e Tiranes arrin ne 300 ton, ndersa kapaciteti depozitues eshte 15 mije ton ose rreth 50 dite rezerve.

Sipas te dhenave te siperme per vitin 1998 jane prodhuar 20.254 ton miell, gje qe do te thote se n.q.s. normalisht punohej 280 dite pune ne vit, prodhimi do te qe 141.400 ton. Kuptohet qe kapaciteti prodhues i fabrikave te miellit shfrytezohet shume pak. Ne keto rrethana, kur Tirana ka gjithe keto kapacitete te lira, kur papunesia eshte teper e larte, a nuk do te ishte e nevojshme marrja e masave per mbrojtjen e industrise se blojes nepermjet instrumenteve te nevojshem, gje qe kuptohet se do te kurseheshin edhe burime te rendesishme valutore nga diferenca e çmimit midis miellit dhe drithrave te importuara.

- Per shkak te konkurrences, prodhimi i makaronave po shkon drejt shuarjes.
- Ne industrine e perpunimit te qumeshtit punojne 3 fabrika me kapacitet prodhues ditor 430 kv. Megjithese fabrikat grumbullojne qumesht e deri ne rrethe si Lushnja, Kruja, etj., aftesite e tyre i shfrytezojne 30-40%. Baxhot operojne ne zona te thella malore me kapacitet ditor 40kv.
- Kapaciteti ditor i prodhimit te birres llogaritet 1600 Hl, ndersa ne fakt ai eshte 950-1000 Hl.
- Prodhimi i pijeve freskuese gjykohet ne nivelin 1100 Hl, nga e cila rreth 70% i takon Coca-Cole. Peshe te rendesishme ze edhe prodhimi i ujit te pijshem ne nivelet 350-400 Hl.
- Ne rrethin e Tiranes realizohen 6800-7000 Hl-vere, ne nje kohe qe gjithsej prodhimi i rrethit nuk kalon shifren 3800 ton. Sipas specialiteteve te sektorit te bujqesise prodhimi i veres realizohet pothuaj teresisht me rush te ardhur nga Maqedonia.
- Lidhur me prodhimin e konservave, duhet thene se ne rajonin e Tiranes ka vetem dy punishte teper te vogla, ku punohet teresisht me dore. Ne to perpunohen sasira krejtesisht te paperfillshme. rreth 300 kv ne vit. Punishte per prodhim salce-domate nuk ekziston asnje. E njejta gje mund te thuhet edhe per prodhimin e reçeleve dhe te kompostove. te cilat jane teresisht te paperfillshme

Nga studimi i te dhenave te siperme dhe nga sa parashtruam mund te arrihet ne disa perfundime e rekomandime:

- Ndryshe nga e kaluara. kur shumica e tokes arre destinohej per drithra buke. aktualisht struktura e mbjelljeve ka ndryshuar per mire: eshte zvogeluar siperfaqja e mbjelle me drithra dhe eshte ulur prodhimi i tyre me 35% ne krahasim me 1990. Siperfaqet e mbjella me perime dhe foragjere zene respektivisht 16.6% dhe 45% te fondit te tokes arre.
- Prodhimi i perimeve prej 53.172 ton ne 1999 per nje popullsi prej 600 mije banore eshte jashtezakonisht i paket per konsum te fresket. pa bere fjale per teprica per perpunim. Pra. ..

perfundimi eshte teper i qarte: te studiohet mundesia dhe te percaktohen instrumentet e nevojshme qe prodhimi i perimeve te rritet jo njehere, por disa here.

Prodhimi i perimeve ka sezon te shkurter. Kjo do te thote qe te stimulohet ndertimi i serave per te zgjatur sezonin e perimeve dhe sasine e tyre, ndryshe as qe mund te behet fjale per te ashtuquajturin konvejez te gjelber te perimeve. Shtimi i llojshmerise dhe sasise se perimeve do te ndikonte ne lehtesimin e dy problemeve social-ekonomike te rendesishme: a) ne kursimin e nje sasie te konsiderueshme te valutes, qe shkon per importin e tyre dhe; b) perimet, duke qene kultura shume intensive, do te angazhonin me shume punonjes. Eshte e kuptueshme qe ne kushtet e nje prodhimi perimesh kaq te ulet te behet fjale per ngritjen e industrise se perpunimit te tyre.

- Rajoni i Tiranes ka kushte klimaterike e tokesore te favorshme per kultivimin e vreshtave, por nje gje e tille nuk ndodh ne realitet. Ne vitin 1990, rajoni i Tiranes kishte 2100 ha vreshta, ndersa ne vitin 1999 siperfaqja e tyre zbriti ne 349 ha, nga te cilat 322 ha ne prodhim. Arritja e siperfaqes se vreshtave te fillimeve te viteve te tranzicionit do te kerkonte edhe shume vjet, por edhe shume investime.
- E njejta gje, sikurse per vreshtat, mund te thuhet edhe per pemet frutore, sidomos per disa fruta qe eshte permendur Tirana si: pjeshka, dardha, fiku, etj. Por, ne dallim nga vreshtaria, riperteritja e pemetarise do me shume kohe e investime.
- Aktualisht rajoni i Tiranes prodhon aq qumesht sa edhe perime, rreth 50-51 ton, ne nje kohe qe nevojat jane disa here me te medha. Eshte e qarte qe nevojat per qumesht te fresket ne shumicen plotesohen nga rrethet, pa folur per djathrat, gjalpin e te tjera bulmetra qe ne pjesen dermuese plotesohen kryesisht nga importi.

Perfundimisht, per rajonin e Tiranes ne sferen e bujqesise duhet studjuar e zgjidhur veçanerisht rritja e prodhimit dhe perpunimit te perimeve, rrushit, qumeshtit, frutave. Keto probleme mund te vihen ne rrugen e zgjidhjes vetem ne kuadrin e ndertimit te Strategjise se Pergjithshme te Zhvillimit te Ekonomise, pa nenvleftesuar strategjite e pjesshme: zhvillimit te bujqesise, eksportit apo te importit e ndonje tjeter.

V. 2.3 Industrializimi i ullirit ne rrethin e Tiranes

Olivikultura ne Shqiperi ka specifikat e veta. Me ullirin eshte lidhur zhvillimi social-ekonomik i nje pjese te mire te popullsise se vendit. Ai konsiderohet nga pasurite e rendesishme te vendit. Ulliri shtrihet ne zonen klimatike mesdhetare, qe perfaqeson 36% te territorit te vendit dhe ku banon rreth 60% e popullsise. Disa te dhena nga nje studim i kryer kohet e fundit jepen ne pasqyren e meposhtme.

Sipas specialsiteve, per arsye te kujdesit akoma te pamjaftueshem si trajtime, pleherime.

Pasqyra 31. Numri i rrenjeve te ullirit dhe prodhimi sipas komunave

Nr.	Komuna	Nr. i rrenjeve	Rendimenti kg/rrenje	Prodhimi (ton)	Distanca (km)
1	Baldushk	12000	37	444	18
2	Babrru	3700	18	67	7
3	Berxull	1000	38	38	15
4	Berzhite	13000	24	312	16
5	Dajt	26000	33	858	12
6	Kashar	4000	34	136	16
7	Ndroq	50000	30	1500	17
8	Petrele	25000	25	625	12
9	Preze	16000	25	400	22
10	Peze	10000	19	190	22
11	Sauk	9000	21	189	3
12	Vaqar	5000	23	115	11
13	Vore	65000	18	1170	17
14	Zall-Herr	17000	29	493	16
	Gjithsej	257000	25.4	6537	-

krasitje e te tjera, konstatohet renie e rendimentit te ullirit. Gjykohet qe ndertimi i linjave te perpunimit te ullirit ne teresi ne rrethin e Tiranes ka efektivitet sepse: lehteson punen e fshataresise, sigurohen me shume te ardhura nga perpunimi se sa nga shitja e paperpunuar, menjanohet transporti dhe shpenzimet per te, rritet cilesia e vajit nga perpunimi i fresket si dhe hapen fronte te reja pune.

Elementet qe e bejne te leverdishem agro-biznesin e perpunimit te ullriti ne rajonin e Tiranes mund te permblidhen:

- *Furnizimi*, eshte i garantuar sepse ekziston prodhimi i vete rrethit, por duke qene ne qender te rajonit mund te grumbullohen edhe nga zonat perrreth. Duke patur pronesine mbi ullirin, fshataret jane te interesuar me shume per rritjen e prodhimit dhe te ardhurave te tyre.
- *Klientet*, ne rolin e bleresit, ne Tirane jane te garantuar. Vaji i prodhuar ne linjat e rajonit te Tiranes, veç nevojave te fshataresise, nuk plotesojne nevojat me se dy muaj per qytetin e Tiranes.

Konkurrentet prodhues nuk jane te intersuar te sfidojne njeri-tjetrin, perkundrazi u interson bashkepunimi per te ruajtur çmime te njejta te blerjes se lendes se pare dhe te produktit te gatshem, per te dale ne treg ne kushte te barabarta.

Faktoret, politiko-ligjor, ekonomik, social-kulturor, lokal e kombetar e favorizojne nje biznes te tille. Veprimtari te tilla i favorizon tradita shekullore e vendit, nevojat kombetare mbeten deficit per vaj ulliri, kerkesat per eksport jane te rendesishme.

Rajoni i Tiranes ka 9.2% te bimeve te ullirit ne rang vendi. Varieteti dominues i zones Tiranes eshte Ulli i bardhe i Tiranes, i cili eshte vajor, me cilesi te larte dhe me permbajtje 25-30% vaj ne kokerr. Ai eshte i pershtatshem per terrene te thyera dhe te varfera, rezistues ndaj te ftohtit, thatesires dhe semundjeve. Ky eshte variateti qe dominon ne Shqiperine e Mesme. Per orientim, per çdo lloj investimi qe mund te kryhet ne kete fushe, sipas linjes teknologjike te zgjedhur, ne forme tabele per orientim po japim disa te dhena, te nxjerra nga literatura dhe te verifikuara ne rrethet e jugut.

Pasqyra 32. Variante te investimit ne perpunimin e ullirit

Nr	Lloji i impiantit	Sip. e instalimit (m2)	Sip.per depozitim ulliri (m2)	Sip. te tjera	Depozita vaji (ton)
1	Familjar	50	40	20	10
2	Fushe	70	60	20	20
3	Industrial	120	100	30	40

Pasqyra 33. Te dhena per grumbullimin e ullirit ne Tirane

Nr	Muajt	Grumbullimi i ullirit (%)	Çmimi i blerjes se ullirit (USD/ton)	Rrezja e prodhimit (%)
1	Tetor	5	100-130	12-14
2	Nentor	20	150-200	16-18
3	Dhjetor	30	210-300	19-20
4	Janar	30	305-350	20-24
5	Shkurt	15	350	21-22

Burimi: Studim i FAO-se per ullirin e rajonit te Tiranes

Llogaritjet japin treguesit mesatar te meposhtem:

- kosto mesatare e prodhimit te vajit 1900-2490 USD/ton
- çmimi i shitjes se vajit ne tregun e brendshem 2700-3200 USD/ton
- kostoja e ndertimit te objektit llogaritet 140-180 USD/m2
- shpenzime montimi dhe instalimi mbi vleften e objektit 7-10%
- kur vaji eksportohet, malli nuk tatohet
- kur vaji shitet ne Shqiperi, malli tatohet me TVSH 20%
- shpenzimet per importimin e nje impianti te ullirit me transport taksor auto 3500 USD
- shpenzimet e kontraktimit, ofertat ne perqindje mbi vleren e impiantit 3%
- vlera e impianteve sipas tipit

-familjar 30000 USD
-Fushe 73000 USD
-Industrial 145.000 USD

Pervoja tregon se shoqerite qe merren me perpunimin e ullirit kane nevoje per 20-30 punonjes. Paga mesatare gjykohet 15 mije leke ne muaj. Nisur nga perqindjet e grumbullimit dhe rrezet e siperme prodhimi i vajit, sikur gjithe prodhimi te industralizohej do te qe:

Nisur nga pervoja shumevjeçare, varietet e ullirit qe kultivohen ne vendin tone kane periodicitet prodhimi, por duke marre ne konsiderate edhe probleme te organizimit te kesaj veprimtarie si dhe konsumin qe do te realizojne prodhuesit per nevojat e veta, gjykohet qe vetem 50% e sasise se siperme ose 600 ton vaj te realizohet nga industrializimi.

Pasqyra 34. Rezultate te analizes

Muajt	Grumbullimi i ullirit (ton)	Reze mesatare (%)	Prodhim vaji (ton)
Tetor	327	13	42.5
Nentor	1307	17	222.4
Dhjetor	1961	19	373.0
Janar	1961	22	431.4
Shkurt	980	22	215.6
Gjithsej	6537	19.6	1285

Per te perballuar nevojat per investime per perpunimin e ullirit ne rajonin e Tiranes, duke patur parasysh nevojat per linjat teknologjike dhe infrastrukturen tjeter, specialistet llogarisin se nevojiten rreth 1,2 milione dollare. Llogaritjet per efektivitetin ekonomik te perpunimit te ullirit ne rajonin e Tiranes ne menyre te permbledhur paraqiten:

1. Te ardhura nga shitja e vajit me çmimin mesatar te tregut 600T X 2500USD=1,5 milione USD
2. Kostoja e prodhimit 600T X 1800USD=1,08 milione USD
3. Fitimi para TVSH 1.500.000-1.080.000=420.000USD
4. TVSH 315.000X20%=63.000 USD
5. Fitimi Neto 420.000-63.000=357.000USD
6. Afati i velshlyerjes se investimeve 1.200.000/357.000 = 3,36 vjet

Ne rajonin e Tiranes zonat qe kane perparesi ne kultivimin e ullirit jane zona Vore-Preze, Peze-Ndroq, Lunder-Petrele dhe zona Linze. Rrethi i Tiranes ka rreth 4500 ha ullishte me mbi 300 mije rrenje ullinj, dhe prodhim mesatar vjetor 6300-6500 ton ullinj, me mundesi prodhimi 750-800 vaj ulliri. Vrojtimet shpjegojne qe rreth 20 % e ullirit shkon per kriposje, per nevojat e vete fermereve dhe per treg.

V. 3 Industria

Qe prej vitit 1996, prodhimi industrial i ndermarrjeve te sektorit publik te rrethit te Tiranes ka ndryshuar.

Aktualisht, vihet re nje rritje e prodhimit mall te shitur, i cili ne vitin 1998 ne krahasim me vitin 1997 ishte 39.6%.

Pasqyra 35. Prodhimi Industrial i Ndermarrjeve te Sektorit Publik (mije leke me çmimet korente)

Emertimi	1995	1996	1997
Industri nxjerrese	87506	196932	62853
Industria ushqimore	1764998	1932045	2114454
Ind tekstile dhe veshjeve	101300	28521	62991
Ind e lekure kepuceve	25458		
Punime me dru	57433	39340	30882
Industri e letres	442426	298588	85095
Ind kimike	619619	397482	387796
Fabrikime jometalore	335005	166872	284509
Metalurgji	32304	23569	0
Makineri e paisje	109801	58685	45824
Paisje elektrike	131950	93611	137924
Fabrikim mjete transporti	3660	6230	
Ind te tjera perpunuese	160398	133771	120611
Prodh shpern e elekt. gazi dhe uji	318217	341694	382107
Ndertim	11511	21574	
Tregti, riparim automjete	15713	5978	

Burimi: INSTAT

V. 4 Zhvillimi i Biznesit Privat

Ne analizen e zhvillimit te biznesit privat ne rajonin e Tiranes, duke dashur qe saktesia e te dhenave te jete sa me e madhe, ju drejtuam si burim te dhenash, departamenteve te Bashkise, zyres se INSTAT-it per Tiranen, te zyres rajonale te tatim-taksave, departamenteve te Keshillit te Rrethit te Tiranes. Qe ne fillim theksojme se keto te dhena ka raste qe jane deri diku te ndryshme (niveli i ulet i statistikave zyrtare), megjithate ato gjithsesi jane me te plota. Theksojme se ato jane vetem per kompanite dhe personat fizik qe ushtrojne aktivitetin ne menyre legale, pra qe jane te regjistruara dhe paguajne detyrimet ndaj shtetit.

Vleresohet se ekzistojne shume subjekte ekonomike, qe nuk raportojne nje pjese te aktivitetit te tyre me qellim qe te shmangin detyrimet e tyre, jo vetem ndaj zyres se tatim taksave, por edhe ndaj sigurimeve shoqerore etj. Gjthashtu, ekzistojne mjaft subjekte te paregjistruara (me aktivitet joformal). Sipas vrojtimit te bere dhe shkembimit te mendimeve me zyrtaret e tatim taksave, mendojme se subjekte te tilla zene me shume se 10 % te subjekteve ekzistuese. Subjektet e paregjistruara jane ne shumicen e tyre aktivitete mjaft te vogla ose te vogla (por qe kane vlere te konsiderueshme nga numri i madh i tyre) dhe shpesh jane te aktivitetit tregtar te sherbimeve dhe te artizanatit.

Mendojme se per zhvillimin ekonomik te vendit ne teresi dhe te rajonit te Tiranes ne veçanti, me problematike mbetet fshehja e nje pjese te xhiros se realizuar dhe e transaksioneve te kryera nga firma me te medha, sesa aktiviteti ilegal i ketyre "firmave te vogla".

Baza mbi te cilen zhvillohet ekonomia e rajonit te Tiranes jane dy:

- *Biznesi privat*, i cili perben bazen aktuale dhe perspektiven e zhvillimit ekonomik te rajonit;
- *Ndermarrjet akoma prone publike,* te cilat jane perfshire ose do te perfshihen ne format e ndryshme te privatizimit.

Pasqyra 36. Aktiviteti ekonomik sipas grupimeve te bizneseve, 199

Lloji i biznesit	Nr. i subjekte	%	ndaj Republikes
VIP	244	2.3%	0.7
Biznesi i madh	2156	20.7%	6.5
Biznesi i vogel	8000	77.0%	22.8
Gjithsej	10400	100.0%	30

Burimi: Zyra e tatim taksave, Bashkia e Tiranes

Nga pasqyra vihet re se peshe mjaft te madhe kane aktivitetet e klasifikuara ne biznesin e vogel, ku shumica e tyre jane persona fizik, dhe ushtrojne aktivitete tregtare. sherbimesh dhe artizanale. Momentalisht, personat fizike te klasifikuar ne biznesin e vogel paguajne detyrimin fiks dhe 1% mbi xhiron. Aktiviteti i tyre duhet trajtuar me kujdes dhe shpesh duhet ndihmuar, jo vetem sepse gjenerojne punesim dhe te ardhura, menaxhohen me lehte dhe jane me fleksible, por edhe sepse nje pjese e tyre mund te konsolidohen dhe te rritin aktivitetin e tyre. duke u bere nxites te rritjes ekonomike te rajonit.

Pasqyra 37. Subjektet VIP siaps degeve

Dega	Nr. i subjekteve	%
Import eksport	14	5.7%
Ndertim	54	22.1%
Prodhim	54	22.1%
Sherbime	23	9.4%
Tregti	80	32.8%
Sherbime te tjera	19	7.8%
Gjithsej	244	100.0%

Te dhenat tregojne se. me gjithe peshen e konsiderueshme qe kane VIP-at ne aktivitetin e prodhimit dhe te ndertimit (se bashku kane rreth 45% te numrit te firmave VIP). nje peshe me te madhe zene aktivitetet tregtare. te cilet ne vetvehte perbejne gati 1/3 e firmave VIP. Kjo tregon se ende jemi larg asaj qe duhet arritur. forcimi dhe rritja e madhe e prodhimit te brendshem. Aktualisht raporti import-eksport ne rang vendi eshte 1:4. Nga ana tjeter. po te analizojme shperndarjen sektoriale te firmave qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne kuadrin e biznesit te madh. natyrshem qe do te vihet re nje shperndarje me e gjere e aktiviteteve. bile ne klasifikimin e bere nga zyra e tatimeve ai eshte edhe me i gjere. me me shume detaje se sa "deget tradicionale".

Edhe ne aktivitetin e biznesit te madh vihet re se mbizoteruese jane aktivitetet tregtare. qe zene gati 54%. gje qe do te thote se gjate kesaj periudhe 10 vjeçare nuk eshte treguar kujdesi i

Pasqyra 38. Te dhena per bizneset ne Tirane

Dega	Nr. i subjekteve	%
Import eksport	44	2.2%
Ndertim	255	12.6%
Agjensi	27	1.3%
Botime	12	0.6%
Banka	9	0.4%
Bar Restorant	5	0.2%
Tregti te ndryshme	1193	55.3%
Farmaci	35	1.7%
Hoteleri	3	0.1%
Servis sherbime	120	5.5%
Konsulence	22	1.1%
Te ndryshme	431	21.2%
Gjithsej	2156	100.0%

duhur qe te nxiten aktivitetet prodhuese, te cilat gjenerojne zhvillim dhe me teper punesim. Gjithashtu duhet te theksojme se, bazuar ne bumin e madh urban qe po perballon Tirana, veprimtaria e ndertimit mbetet nje aktivitet mjaft i rendesishem, duke zene rreth 1/8 e firmave te biznesit te madh. Ky lloj aktiviteti nga njera ane eshte nje tregues i potencialit dhe i perpjekjeve per zhvillim, dhe nga ana tjeter tregon qarte mungesat e medha dhe dobesite e trasheguara ne drejtim te ketij sektori. Nga ana tjeter, rritja e madhe e aktivitetit te ndertimit eshte nje rrezik potencial per demtime te infrastruktures teknike.

Ne aktivitetin e biznesit te vogel, eshte e kuptueshme qe do te jete predominuese sfera e tregtise dhe e sherbimeve. Pasqyra e meposhtme gjykohet se e paraqet qarte kete veçori, por gjithashtu nga analiza e saj vihen re edhe shtremberimet dhe zhvillimet "jo ne drejtimet e duhura" te ketij lloj biznesi.

Nga keto te dhena arrihet ne perfundimet se:

Pasqyra 39. Te dhena mbi biznesin e vogel

Dega	Nr. i subjekteve	%
Ambulant	297	4.8%
Tregti	4206	67.6%
Agjensi	36	0.6%
Bilardo	120	1.9%
Berber	55	0.9%
Avokat	163	2.6%
Disko	5	0.1%
Dyqane	48	0.8%
Bar kafe	897	14.4%
Te ndryshme	398	6.4%
Gjithsej	6225	100.0%

- *Pesha mbisunduese e aktivitetit tregtar*, gje qe tregon se ekonomia jone (edhe e rajonit te Tiranes) ende po bazohen ne aktivitete joprodhuese dhe shpesh ne mallra te importit qe perballohen nga dergesat monetare te emigranteve shqiptare ne Europe si dhe nga burime te tjera te jashteme.
- *Ekzistenca e nje numri te madh bilardosh* (ketu duhet te permenden edhe lojrat e fatit), te cilat zene nje peshe te konsiderueshme prej gati 2%, peshe e cila flet qarte per problemet sociale qe mund te vijne nga keto lloj aktivitetesh. Duhet te theksojme se nuk jemi kunder bilardove dhe aktiviteteve te tera argetuese, por qendra te tilla shpesh nuk e kane kete funksion, por sherbejne ne te kundertetn, si burim i shpenzimeve me te medha te parave, qe çojne ne grindje rahje, vrasje, vjedhje, droge, etj.
- *Nje numer mjaft i madh i bar-kafeve*, gati 15%, gje qe flet per perdorim joproduktiv te kohes, sidomos ne kushtet e nje papunesie te madhe.
- Gjithashtu, *nje numer mjaft i madh i specifikuar nen emertimin aktivitete te tjera* (qe realisht do te thote i paspecifikuar) te ben te mendosh se duhet te punohet me mire per te patur statistika me te qarta.

Ne pergjithesi, duke studiuar strukturen e bizneseve te rajonit vihet re se:

- Ne 234 VIP-at, vetem 54 jane biznese prodhimi ose 23% e tyre, ndersa ne 2060 biznese te medha nuk ka asnje biznes prodhimi. Nje e tille do te thote qe te importohet me shume, te eksportohet pak, te mossigurohen fronte te reja pune. Ky sektor, siç duket, nuk ka leverdi dhe se ai nuk eshte ne gjendje te perballoje konkurrencen e huaj dhe se per ngritjen e tij duhen politika te veçanta, kohe dhe para.
- Ne VIP-at, 33% jane shoqeri tregtare dhe ne biznesin e madh ato zene me shume se 50 te tyre, fakt ky qe deshmon per leverdine e angazhimit ne kete sfere.
- Peshe te rendesishme ne bizneset e rendesishme kapin firmat e ndertimit, te cilat veprojne kryesisht ne sektorin e ndertimit te banesave.
- N.q.s. ne vitin 1998 jane regjiztruar 8790 subjekte ose 260 me teper se ne vitin 1999 do te thote qe shume subjekte per t'i shpetuar detyrimeve fiskale jane shmangur.
- Numri i te punesuarve ne bizneset private ka tendence rritje. Vetem per vitin 1998, ne krahasim

me vitin 1997, te punesuarit ne sektorin privat (sipas evidencave te bashkise) u rriten 49%.

Ne analizen qe i behet aktiviteteve tregtare sipas viteve, duhet te therasim ne ndihme te dhenat e marra nga INSTAT per Tiranen, me mendimin se jane me te kontrolluara sipas viteve. Por, menjehere ketu te bie ne sy "semundja kronike" e statistikave shqiptare. Per te njejtin fenomen, ne se do te marresh te dhena nga dy burime te ndryshme, do te arrish ne dy rezultate te ndryshme, sepse te dhenat nuk perputhen me njera tjetren. Ligji per statistiken ekziston dhe eshte i nje niveli mjaft te mire, por ai duhet te zbatohet me saktesi dhe ne bashkepunim mes institucioneve te ndryshme.

Ne pasqyren e meposhtme, gjeja e pare qe te bie ne sy eshte ndikimi i krizes se pranveres 1997 ne zhvillimin e aktivitetit te biznesit ne Tirane. Kjo periudhe solli nje frenim dhe "tkurje" te aktivitetit te biznesit, e cila vihet re sidomos ne subjektet e vogla. A jane braktisur me te vertete aktivitetet apo pronaret e tyre duke pare dobesite e shtetit jane ne nje pike qe "nuk e njohin shtetin"? Pa dashur te mohojme faktin se kjo krize i mbylli nje pjese te aktiviteteve, duhet te theksojme se dobesite e shtetit nga njera ane, politikat ekonomike jonxitese ndaj biznesit dhe lufta e dobet ndaj korrupsionit nga ana tjeter, kane bere qe nje pjese e aktiviteteve te ushtohen ne menyre ilegale.

Pasqyra 40. Te dhena per biznesin ne vite

Nr	Emertimi	1996	1997	1998
I	**Subjekte te regjistruara ne TVSH**	2840	3244	3173
A	Kompani shqiptare	1728	1493	2035
B	Joint ventures	581	782	599
C	Kompani te huaja	531	969	539
II	**Subjekte qe nuk jane te regjistruara ne TVSH**	7461	4292	5617
A	Tregti	3618	2676	2237
B	Prodhim	1392	617	1552
C	Intelektuale	462	201	554
D	Transport	287	327	299
E	Ambulante	1702	471	975
III	**Gjithsej**	10301	7536	8790

Burimi: INSTAT

Gjithsesi, renia e numrit te aktiviteteve eshte nje tregues negativ qe nuk mund te justifikohet perveçse me ndryshim te politikave te ndjekura dhe me perpjekje me te medha per te bere te mundur nxitjen dhe rritjen e aktiviteteve legale.

Rritja e zhvillimit ekonomik te Tiranes mund te argumentohet edhe me shtimin e te ardhurave tatimore sipas viteve. Dinamika e te ardhurave tatimore (pa te ardhurat lokale) paraqitet si me poshte:

Pasqyra 41. Realizimi i te ardhurave tatimore sipas viteve *(ne mije leke)*

Nr	Lloji i te ardhurave	1996	1997	1998	1999
1	TVSH	1944039	2002323	3800158	4089374
2	Akcize	1567046	372082	1303355	1539292
3	Tatim fitimi	2634718	2059149	3774077	5105189
4	Tatim mbi biznesin e vogel	142407	144088	241096	429999
5	Tatim mbi te ardhurat personale	325137	472264	671281	1385457
6	Te ardhura nga kazinote ddhe lojrat e fatit	36530	114034	104258	95217
7	Tatim mbi qarkullimin	1543003	33167	23563	737
8	Te ardhura nacionale	577408	407803	1153521	1868543
9	Tatim mbi ndertesat	86999	105060	96363	564
10	Tatim mbi token bujqesore	5	-	-	-
11	Shuma e te ardhurave tatimore	8857292	5758970	11167672	14514372
12	Te ardhura jotatimore	2822161	2566	16545	50795
13	Gjithsej te ardhura	11679453	5761536	11184217	14565167

Shenim:

- *Per vitin 1996, tatimi mbi vleren e shtuar u zbatua duke filluar nga gjashtemujori i dyte.*
- *Tatimi mbi qarkullimin eshte vetem per gjashtemujorin e pare 1996, pasi ne vazhdim u zevendesua me TVSH.*
- *Tatimi mbi ndertesat, duke filluar nga viti 1999, i ka kaluar per administrim Bashkise se Tiranes.*
- *Te ardhurat jotatimore, taksat doganore deri ne vitin 1996, raportoheshin nga drejtoria e tatimeve, ndersa prej vitit 1997 raportohen nga dogana.*

Oshilacionet e te ardhurave tatimore spjegohen me *situaten politike dhe ekonomike* te vendit ne teresi, situate te cilen Tirana e ndien me teper se rrethet e tjera si dhe me *evazionin e larte fiskal*, qe me kalimin e kohes behet me i sofistikuar (mosregjistrim subjektesh, zvogelim aktiviteti, fshehje ne bilance, etj.). Me gjithe oshilacionet e mesiperme, fakti qe viti 1999 eshte 30.3% me i larte se realizimi i vitit te kaluar tregon qe ne rajonin e Tiranes ka rritje te aktivitetit ekonomik dhe permiresim te punes se organeve financiare.

Ne fillim te tranzicionit, rajoni i Tiranes kishte ne inventar me shume se 130 ndermarrje ekonomike, te cilat funksiononin dhe ishin nga me te fuqishme ne rang vendi te tilla si: Kombinati i Autotraktoreve, kombinati i Tekstileve, Poligrafiku, Kombinati "J.Pashko", kombinati Ushqimor, ndermarrja e PTT, dhjetra uzina mekanike, ndermarrje te industrise se lehte dhe ushqimore, te transportit, te tregtise se brendeshme dhe te jashteme, ndermarrje te fuqishme bujqesore si ajo Gjergj Dimitrov, 17 nentori, Vora, Kamza, etj., te cilat llogaritet se perfaqsonin 30-35% te ekonomise se vendit. Duhet te theksohet se baza e biznesit ne Shqiperi (dhe ne Tirane) jane aktivitetet ne formen ligjore person fizik dhe me pak punonjes. Theksojme se, nga numri total i aktiviteteve te biznesit ne Tirane ne vitin 1997, 55.9% ishin persona fizik (me nje punonjes), pra vetepunesim, ndersa ne vitin 1998 ky raport ishte 56.5%, pra nje rritje fare te lehte, qe edhe pse si rritje nuk eshte e rendesishme, tregon se nuk ka asnje pirje ne drejtim te kundert.

Pasqyra 42. Struktura e biznesit

Emertimi	Gjithsej		Person fizik		Person juridik	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998
Gjithsej	16590	18659	10085	11362	6504	7297
1 punonjes	13177	14870	9276	10546	3901	4324
2-10	3259	3532	803	809	2456	2723
Mbi 10	154	257	7	7	147	257

Studimi i zhvillimit te biznesit sipas origjines se pronarit tregon edhe nje here pirjen normale se biznesmenet e huaj (joint ventures dhe firma te huaja) tentojne drejt bizneseve me te medha, pa mohuar se ne disa raste ata hapin aktivitete te vogla. Arsyet per kete jane:

- Rreziku ende i larte per biznes ne Shqiperi (ne Tirane). Ne keto kushte, ka mjaft te huaj qe vetem "nje kembe" kane futur ne Shqiperi dhe me mosbesim, jane gati qe ne rast trazirash te largohen menjehere, lehte dhe pa humbje.
- Burokracia shteterore shqiptare (edhe e Tiranes) qe ne disa raste i zvarit shume (pse jo, edhe kerkon ryshfet) nga biznesmene te ndryshem. Eshte logjike qe "te medhenjte" nuk i suportojne gjate zvaritjet.
- Struktura nxitese ligjore e pafavorshme, e cila nuk ofron ndonje lehtesi me te madhe per te huajt ne krahasim me strukturat e vendeve te tjera te Europes Lindore dhe Qendrore. Ndersa veshtiresite i krijon vete infrastruktura teknike dhe sociale, gje qe duket nga zvogelimi i numrit te te punesuarve tek bizneset e huaja.

Pasqyra 43. Te dhena mbi bizneset dhe te punesuarit ne to

Emertimi	Gjithsej		Vendas		Joint venture		Te huaja	
	1997	1998	1997	1998	1997	1998	1997	1998
Gjithsej	16590	18659	4058	4640	1327	1453	1119	1204
1 punonjes	13177	14870	2666	3016	574	595	661	713
2-10	3259	3532	1316	1446	716	820	424	457
Mbi 10	154	257	76	185	37	38	34	34

Ne perfundim, duke bere nje sinteze te numrit te aktiviteteve te biznesit ne Tirane sipas degeve ku e ushtrojne aktivitetin dhe sipas numrit te punetoreve do te kemi pasqyren e meposhtme. Edhe nje here vihet re qarte dominimi i aktivitetit te tregtise dhe te sherbimeve; kjo sepse keto jane aktivitete qe duan pak kapital dhe se e kthejne fitimin shume te shpejte. Por, nga ana tjeter ato nuk mund te trajtohen si bartes te zhvillimit ne ekonomine e nje rajoni.

Pasqyra 44. Subjektet ekonomike private sipas deges dhe numrit te punetoreve, 1998

Emertimi	Gjithsej	Bujqesi	Industri	Ndertim	Tregti	Transport	Sherbime
Gjithsej	18659	140	1593	668	11115	1818	3325
1 te punesuar	14870	99	1024	391	8996	1585	2775
2-10	3532	31	484	232	2068	218	499
Mbi 10	257	10	85	45	51	15	51

Perfundimisht, megjithese nuk eshte e perfshire ne tabelen e prodhimit industrial te ndermarrjeve te sektorit privat, nje dege industrie me mundesi investimesh domethenese eshte industria e materialeve te ndertimit. Kjo, sepse sektori i ndertimit ka nje kerkese mjaft te fuqishme dhe nje plotesim te pamjaftueshem te kesaj kerkese.

V.4.1. Turizmi

Nje fushe qe iu ofron investitoreve te huaj mundesi te medha ne te ardhmen eshte sektori i pazhvilluar i turizimit shqiptar. Kompanite e huaja kane treguar interes te konsiderueshem ne zhvillimin e turizmit klimaterik, kurse ate detare dhe te golfit ne te gjithe vijen bregdetare te vendit. Megjithate, mungesa e infrastruktures, ne te gjithe vendin dhe ngjarjet e vitit 1997, kane shtyre ne drejtim negativ prospektet per nje zhvillim turistik te vendit ne te ardhmen e afert. Ne rrethin e Tiranes sot ka 3 hotele shteterore dhe 32 hotele private te klasave te ndryshme turistike, qe kane 1571 shtreter (856 dhoma), te cilat ne vitin 1998, kane pritur 32630 turist shqiptare per 49844 nete dhe 19744 te huaj per 70967 nete.

Rrethi i Tiranes ka zona terheqese qe mund te jene zona te zhvilluara tursitike. Midis tyre jane Mali i Dajtit, rreth 20 km. nga qyteti, me nje mjedis kulturor dhe fizik piktoresk si dhe keshtjellat e Petreles dhe te Prezes, te njohura per historine e tyre. Keto zona garantojne nje potencial zhvillimi turistik per rrethin, por nuk eshte parashikuar asgje per te filluar gjate tre-kater viteve te ardhshme, per arsye te shkaqeve te permendura me siper. Gjate kesaj periudhe nuk pritet te kete ndonje zhvillim shume te madh turistik ne rrethin e Tiranes.

V.4.2 Tregtia dhe sherbimet

Ndermarrjet qe veprojne ne tregti (veçanerisht ne tregtine me shumice) dhe ne sherbime jane mjaft te shperndara ne pjese te ndryshme te qytetit. Rritja e pritur e popullsise urbane dhe zhvillimi i sektoreve primar dhe sekondar te ekonomise, do te gjeneroje kerkese te metejshme per tregtine dhe sherbimet. Siç tregon pervoja e dekades se fundit ne Shqiperi dhe deri sa te ekzistojne çmime te liberalizuara dhe regjim tregtar i permiresuar dhe i mbeshteur ne vazhdimesi nga qeveria, forcimi i sektorit terciar pritet te vazhdoje me efektivitet. Tregtia me shumice, sherbimet e biznesit, sherbimet sportive, argetimi etj.jane konsideruar si nensektore me potencial intersant dhe dinamik.

Gjithashtu, zhvillimi i tregtise dhe i sherbimeve kerkon te zbatohen projektet e meposhtme te infrastruktures:

- permiresimi i rrugeve urbane;
- permiresimi i ndriçimit te rrugeve;
- krijimi i hapesirave te parkingut ne qender te qytetit;
- permiresimi i sherbimit te energjise elektrike dhe i telekomunikacionit.

V.4.3 Nje analize e mundesive investuese

Problem per te kryer nje investim ne Shqiperi eshte ai i te drejtave te paqarta te pronesise Megjithate, vihet re se ka nje zhvillim pozitiv ne kete fushe, dhe ne fakt investitoret e huaj qe

jane aktiv ne Shqiperi kane gjetur menyra se si mund te negociohen zgjidhjet dhe mund te arrihet qe aktiviteti te kete fitim. Ne se ky eshte problemi kryesor, atehere kosto e ulet, fuqi puntore e shkolluar, ekonomia ne rritje, vend ne permiresim dhe pozicioni i shkelqyer i vendit, jane arsyet kryesore te prodhimit/investimit ne Shqiperi. Megjithese, paga mesatare per punetoret eshte rreth 40-60 dollare, norma e prodhimit per punonjesit e trajnuar eshte shume e larte. Gjithashtu, Shqiperia ka kapital te pashfrytezuar ne lidhje me rezervat natyrore dhe te punes, te cilat mund te te mbeshtesin nje rritje te madhe ekonomike ne te ardhmen.

Komunikacioni eshte i veshtire dhe progresi eshte i ngadalte. Gjithashtu, infrastruktura eshte e varfer dhe me rruge standarte qe jane te ngushta dhe ne kushte te keqia, si dhe nevojat komunale te paplotesuara. Me nje planifikim dhe me investimet e duhura ne lidhje me nevojat (energji elektrike dhe uje) mund te behet permiresimi i tyre (perdorim i gjeneratoreve, gjetja e burimeve te veçanta te ujit, etj.).

V.4.4 Industria tekstile dhe e kepuceve (Prodhimi me metoden Fason)

Ekziston nje potencial i madh per perftime te menjehershme ne prodhimin me metoden fason ne industrine tekstile dhe te kepuceve. Firmat Italiane (ne veçanti) Greke dhe Europiano-Perendimore jane tashme investitor aktiv ne kete zone. Firmat si Rebook, Nike, Jantzen dhe firma te tjera me te vogla nga Europa jane perqendruar per te prodhuar ne Shqiperi dhe firma te tjera jane ne ardhje çdo muaj. Kapacitete prodhuese te paperdorura jane ne gjendje aktualisht per joint ventures dhe/ose per kontrator agjent.

Ne rajonin e Tiranes funksionojne disa firma qe punojne me sistemin fason. Ky lloj biznesi eshte shtrire veçanerisht ne prodhimin e konfeksioneve dhe te faqeve te kepuceve. Ne keto dy veprimtari rajoni i Tiranes trashegoi qe nga sistemi i kaluar nje infrastrukture fizike e njerezore te zhvilluar per kohen. Ato, perveç ndertesave, makinerive dhe fuqise punetore e personelit inxhinjero-teknik te kualifikuar ,kishin edhe nje organizim linjash prodhimi te brendshme mjaft te organizuar. Dy NPV-te e Tiranes (pa te Ushtrise), eksportonin rreth 40% te prodhimit. Meqenese ekzistojne si infrastruktura fizike dhe fuqia punetore e kualifikuar, inkurajimi i rritjes se metejshme te prodhimit te konfeksioneve mbetet nje rezerve e rendesishme e zhvillimit ekonomik te Tiranes dhe zbutjes se problemit te papunesise.

E njejta gje duhet thene edhe per industrine e kepuceve. Sipas studimeve te specialisteve qe mbulojne kete fushe, vendi ka nevoje per 6,5-7 milione pale kepuce ne vit. Theksojme se ne vitin 1990 Shqiperia prodhonte rreth 6 milione pale. Momentalisht prodhimi ne vend eshte teper minimal dhe nevojat e konsumatoreve perballohen nga dy burime: firma "Gabi" dhe importi. Mungesa e prodhimit ne vend dhe importi i kepuceve ka çuar ne rritjen drastike te çmimeve. Çmimet mesatare te shitjes se kepuceve te burrave ne vitin 1998 ne raport me 1996 u rriten 83% dhe ato te grave 103%. Inkurajimi i prodhimit ne vend, ne kete kuader edhe ne Tirane ku ka qene fabrika me e madhe e kepuceve ne vend, do te lehtesonte plotesimin e nevojave te popullit dhe zhvillimin e rajonit. Eksperienca tregon se punetoret shqiptar te kualifikuar kane treguar se jane po aq produktiv sa ata europian, por me nje kosto mjaft me te ulet.

V. 4.5 Ndertimi

Ne rajon, ky sektor eshte nje nga sektoret me rritjen me te madhe dhe me te forte. Nderkohe edhe konkurenca po rritet me shpejtesi: jane 668 firmat private te regjistruara ne ndertim. Shumica e kompanive te ndertimit zoterohen nga shqiptare. Krahas tyre funksionojne edhe 16 joint-ventures, kryesisht me kompani greke dhe italiane. Keto firma perdorin kryesisht lende te para shqiptare, tulla, hekur, çimento importi greke. Konstruktet e ndertimeve jane tipike me beton ose me tulla; shume pak perdoren konstruksionet e drurit. Materialet e brendeshme te ndertimit jane me moderne dhe vazhdimisht perdoren me teper materiale importi, duke perfshire materiale suvatimi, panele, mure parafabrikate (mure metalike me xhama dyfishe), dysheme dhe mure me pllaka dhe dritare me konstruksion metalik.

Projektet e medha te infrastruktures per firmat e ndertimit do te sigurojne ne Shqiperi, nje

treg te rendsishem. Ne fakt, kushtet e sotme te infrastruktures shqiptare kerkojne qe ne nje periudhe afatmesme sherbime te tilla ndertimi te rriten ne menyre te konsiderueshme.

Deri sa te ardhurat edhe per nje fare kohe do te jene te uleta dhe industria do te dominohet nga biznesi i vogel, firmat e ndertimit do te kene ne fokus, kliente te tyre, donatoret nderkombetar dhe kompanite ndertuese, agjensite shtetrore kombetare dhe lokale si dhe njerezit e sapopasuruar. Ndertesat e reja te banimit, rinovimet e fabrikave te vjetra dhe ndertimi i fabrikave te reja jane me te perhapurat ne Tirane, por ecja e ndertimit eshte e ngadalte. Perseri, te drejtat e paqarta te pronesise e bejne ndertimin nje orvatje me rrezik. Jane aktive vetem pak firma nderkombetare, por interesi vazhdon te rritet, dhe shume firma jane ne pritje qe per problemin e te drejtes se pronesise te kene nje mesazh te qarte nga qeveria shqiptare.

Qeveria, e mbeshtetur nga Banka Boterore, po zhvillon nje metodike qe te perputhe kerkesen per zona te reja banimi qe trajtojne probleme te planifikimit dhe te rregullimit te perdorimit te tokes, zgjedhjes se investimeve, pjesemarrjen e komunitetit dhe mbulimin e kostos. Kjo menyre e re po testohet ne Tirane permes nje kredie te Bankes Boterore prej 10 milion dollare dhe me vone do te zbatohet edhe ne qytetet e Durresit, Shkodres dhe te Fierit.

Vellimi i madh i ndertimeve, sidomos keto vite te fundit, per shkak te bumit te mbipopullimit dhe zhvillimit te rajonit te Tiranes, kane rritur ne menyre te ndjeshme kerkesen e tregut per materiale ndertimi. Programet e ndihmes se Komunitetit Nderkombetar per Shqiperine parashikojne fonde te rendesishme investimesh per ndertimin e akseve rrugore te perfshira ne programin e korridorit te 8, te programeve PHARE - per ndertimin e rrugeve ne fshat, etj. Zbatimi i ketyre programeve do te kerkoje sasira te konsiderueshme materialesh inerte ndertimi. Ne programet qeveritare, parashikohet te rehabilitohen 550 km dhe ristrukturohen 250 km rruge kryesore dhe rreth 1000 km rruge ushqyese (qe lidhin akset kryesore me zonat rurale). Jane pikerisht keto zhvillime dhe fillimi i ketyre projekteve te cilat kane favorizuar dhe do te favorizojne edhe ne te ardhmen zhvillimin dhe dinamiken ne rritje te prodhimit te materialeve te ndertimit ne teresi, dhe te inerteve ne veçanti. Pervoja e deritanishme e linjave te prodhimit te inerteve ne vend deshmon se rentabiliteti i prodhimit luhatet ne kufijte 30-45%, nje norme rentabiliteti relativisht e larte dhe e qendrueshme, ç'ka perben nje nder kerkesat kryesore per biznese me leverdi. Materialet inerte kryesore qe rezultojne jane: rere natyrore, rere betoni, granit 5-10, granit 10-20, çakull >20.

Pasqyra 45. Treguesit e prodhimit te materialeve te ndertimit

	Emertimi	Njesi e matjes	1992	1993	1994	1995
1	Gure gjithsej	000/m3	90	100	150	177
2	Inerte gjithsej	000/m3	1200	1800	2000	3400
	Per Tiranen 40%					
1	Gure	000/m3	36	40	60	70
2	Inerte	000/m3	500	720	800	1400

Burimi: Studim i Ministrise Ndertimit dhe Turizmit, 1995

Me prodhimin dhe tregtimin e materialeve inerte merren kryesisht firmat:

- Kompania "Farka", nje kompani shqiptare qe operon rreth 5 km ne verilindje te Tiranes, pergjate aksit te rruges kombetare Tirane-Elbasan, ne lumin Erzen.
- "Mak Albania" nje filial i Kharafi Group, kompani Kuvajtiane, e vendosur rreth 10 km ne jug-perendim te Tiranes, ne aksin e rruges Tirane-Plepa (Durres)
- "Halili M and S" sh.p.k. firme shqiptare e vendosur rreth 10-12 km ne verilindje te Tiranes, ne rrugen Tirane-Fushe-Kruje.
- "Superbetoni" dhe nje kompani italiane te vendosur ne lumin e Tiranes

Kapacitetet prodhuese te firmave individuale variojne nga 10-18.000 m3/vit rere natyrore dhe rere betoni dhe 20-30.000 m3/vit granit 1 dhe 2.

Te 5 kompanite operuese ne zone vleresohet te arrijne nje kapacitet prodhues prej 800 mije deri 1 milione m3/vit, tregues qe pasqyrojne rreth 70% potencial te zones, ndersa boshlleku mbushet nga firma te vogla.

V. 4.6 Perpunimi i drurit

Bazuar ne koston e ulet te fuqise punetore te kualifikuar, firma Italiane, Gjermane dhe Greke tashme kane kontraktuar me perpunues lokal te drurit dhe te berjes se mobiljeve, me qellim prodhimin per tregjet e perendimit. Megjithate, keto perpjekje jane te kufizuara. Burimet e varfera te menaxhimit, duke perfshire edhe prerjen dhe mungesa e masave parandaluese kunder insekteve dhe semundjeve, e kane reduktuar ndjeshem numrin e drureve ne prodhim. Druret qe u bene gati per prodhim, pas nje programi ripyllezimi qe ka filluar shume vjet me pare, tashme ne shume raste jane prere dhe jane perdorur per mobilje.

Megjithate, po ndermerren programe te medha te financuara nga donatore per te permiresuar produktivitetin e burimeve shqiptare te lendes drusore. Nje mundesi e menjehereshme ekziston edhe per firmat nderkombetare qe presin te punojne me metoden facon te prodhimeve te drurit (te ngjashme me ato qe kane qene te suksesshme ne sektorin e tekstileve dhe kepuceve)

Fillimisht disa lloje lende drusore dhe te gjitha skicimet eshte e nevojshme te sillen nga jashte, perderisa furnizuesit lokal jane jokonkurues dhe kualifikimi eshte i kufizuar. Transporti ka gjithashtu probleme sepse mungojne pajisjet moderne. Nje problem i madh mbetet mungesa e forcimit te ligjit per kerkesen per licensim. Investitoret e huaj, qe tashme kane filluar prodhimin e mobiljeve dhe firmat shqiptare qe kane aktivitet ne kete fushe, jane me fitim te konsiderueshem.

V. 4.7. Disa Probleme te Privatizimit te Prones Publike ne Rajonin e Tiranes

Tirana, jo vetem ne regjimin e kaluar por edhe sot ne ekonomine e tregut, konsiderohet rajoni ekonomik me i rendesishem dhe me i zhvilluar i vendit. Ne Tirane ishin perqendruar dege te tilla te rendesishme si industria mekanike, poligrafike, tekstileve, rrobave te gatshme, perpunimit te drurit, industrise ushqimore, artizanatit, te sherbimeve komunale, te tregtise, te industrise ushtarake, transportit, etj. Inventari i ndermarrjeve ekonomike te rajonit te Tiranes nuk eshte i plote. Ai eshte perpiluar bazuar ne kujtesen e autoreve, sepse ne aparatet perkatese te Bashkise Tirane, te Ministrise se Ekonomise Publike dhe te Privatizimit dhe ne A.K.P. nuk disponohej nje gje e tille. E njejta gje mund te thuhet edhe per statusin aktual te tyre. *(Per te dhena te hollesishme referojuni pasqyrave 14-16 tek Aneksi)*

Çfare perfundimesh mund te arrihen nga studimi i statusit aktual te ish ndermarrjeve te rajonit te Tiranes?

- Qellimi kryesor i privatizimit ka qene jo zhveshja e shtetit nga pronat dhe dhenia e tyre privateve, por rritja e efektivitetit te ekonomise, rritja e prodhimit, punesimi dhe permiresimi i nivelit te jeteses se populisise. Fakti qe shumica e ish ndermarrjeve, te cilat kane nderruar pronarin, nuk funksionojne apo funksionojne me kapacitet te reduktuar, qe papunesia ne Tirane jo vetem eshte nga me te lartat ne vend dhe me tendence rritje, tregon se privatizimi nuk i ka sherbyer rritjes ekonomike te rajonit, por thjeshte nderrimit te pronarit.
- Legjislacioni i privatizimit, ne funksion te qellimit themelor te tij, tregon se nuk ka qene i plote. Ai nuk detyron pronarin e ri, qe brenda nje periudhe te caktuar me ligj te ruaje apo te permiresoje treguesit kryesor te ndermarrjes, ne te kundert te kishte sanksione detyruese dhe te forta.
- Ne organet perkatese te shtetit qe merren me privatizimin nuk ka patur dhe nuk ka akoma organe monitorizuese qe te ndjekin ecurite e ndermarrjeve pasprivatizimit te tyre, duke propozuar dhe nderhyrjet e nevojshme nga organet vendimarrese.
- Vihet re nje mungese bashkepunimi midis ministrive te linjes me MEPP, AKP dhe organet e pushtetit vendor per problemet e privatizimit, dhe, si rrjedhim ne kete proçes jane vertetuar mangesi te rendesishme.
- Nga ndermarrjet qe kane mbetur pa privatizuar, gjykojme qe shume prej tyre te mund te kalojne ne prona te pushtetit vendor.

- Per ndermarrjet qe deri tani i kane rezistuar ekonomise se tregut (Birra Tirana, Telekom, etj.) qe jane nga siguruesit kryesore te ardhurave te buxhetit, mund te rishihet afati i privatizimit.
- Per ndermarrjet qe nuk funksionojne aktualisht duhet menduar se çfare duhet bere me ato qe mund te rivihen ne pune, qofte edhe pjeserisht, dhe çfare duhet bere per ato qe nuk kane perspektive rivenie ne pune.
- Problemet e siperme duhet te jene pjese perberese e strategjive rajonale, degesore dhe te pergjithshme te ekonomise, qe gjykohet te hartohen sipas programit te qeverise.

VI. MJEDISI I BIZNESIT (VROJTIMI I BIZNESEVE TE TIRANES)

Kjo pjese paraqet rezultatet e vrojtimit te kryer nga Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike ne kuadrin e projektit "Politikat Ekonomike per zhvillimin e rajonit te Tiranes". Ky vrojtim kishte per qellim te vleresonte qendrimin e biznesit kundrejt politikave te ndryshme ekonomike si dhe perceptimin e biznesmeneve per mjedisin ku ata veprojne.

VI.1 Metodologjia

Me ane te nje pyetsori te ndertuar per te studjuar zhvillimin e biznesit ne rajonin e Tiranes dhe per mendimet e biznesmeneve tiranas per problemet e ndryshme qe trajton studimi, ne baze te kritereve shkencore u realizua identifikimi dhe perzgjedhja e biznesmeneve te fushave te ndryshme te aktivitetit dhe te madhesive te ndryshme te biznesit (me ndihmen e pushtetit vendor dhe te zyras lokale te takse- tatimeve). Fillimisht u krye nje prove pilot me 10 biznese, per te testuar pyetsorin e ndertuar. Ne baze te rezultateve te proves pilot, u permiresua pyetsori i ndertuar dhe u ndertua varianti perfundimtar i tij. Ne percaktimin e shembullit te vrojtimit u paten parasysh tre kriteret e meposhtme:

- Deget aktivitetit ekonomik;
- Shperndarja e bizneseve private sipas zonave te Tiranes;
- Madhesia e bizneseve;

Pyetsoret e shperndare kishin shperndarjen degesore te meposhtme: ne tregti 40%, ne sherbime 20%, ne industri 15%, ne ndertim 15% dhe ne transport 10%.

Ne shperndarjen e bizneseve sipas zonave te Tiranes u perdoren te dhenat e Bashkise se Tiranes ne librin e shperndarjes se bizneseve sipas rrugeve. Ky liber ekzistonte ne Bashkine e Tiranes me qellim grumbullimin e tatim-taksave. Ne kete menyre u mbajt parasysh qe shpemdarja e pyetsoreve te ishte me e madhe ne zonat me intensive te biznesit, por gjithnje duke qene te shperndare ne te 11 njesite rajonale te kryeqytetit. Variabli madhesi e ndermarrjes u pat parasysh ne baze te numrit te punetoreve. U zgjodh variabli numer punetoresh si me i besueshem per aktivitetin e ndermarrjeve. Natyrisht qe variabli me i mire do te ishte xhiro mujore, por ne kushtet aktuale te fshehjes se xhiros nga biznese te ndryshme, ky variabel u gjykua se nuk ishte me i miri.

Perpunimi i te dhenave nxorri mjaft perfundime te vlefshme, qe ne pergjithesi perputheshin me pikpamjet dhe mendimet e grupit te studjuesve per problemet qe trajton studimi.

VI. 2 Analiza e Rezultateve

Kjo pjese paraqet rezultatet e analizes se vrojtimit te 142 firmave te vendosura ne rajonin e Tiranes.

Kjo ndarje eshte perpjekur te ruaje raportin e perfaqesimit te firmave, sipas te dhenave te INSTAT-it mbi numrin e bizneseve sipas degeve.

Vihet re se shembulli i zgjedhur per nga data e krijimit te aktivitetit mbulon pothuajse



QSHEK: Vrojtimi i Bizneseve te Tiranes
Dhjetor 1999

Grafiku 1. Fusha e Aktivitetit Kryesor te Firmave te intervistuara

te gjithe periudhen e tranzicionit shqiptar, gje qe mundeson marrjen e opinioneve nga biznese qe kane kaluar ne pothuajse te gjitha veshtiresite apo barrierat e ketyre 10 vjeteve.

Pasqyra 46. Viti i krijimit te aktivitetit

Viti	Nr. i firmave	Perqindja	Perqindja kumulative
1991	6	3.57	4.3
1992	17	12.14	16.4
1993	19	13.57	30.0
1994	16	11.43	41.4
1995	23	16.43	57.9
1996	24	17.14	75.0
1997	19	13.57	88.6
1998	12	8.57	97.1
1999	4	2.86	100
Gjithsej	140	100	



QSHKE, Vrojtimi I Bizneseve te Tiranes, Dhjetor 1999

Grafiku 2. Forma e kompanise sipas pronesise

Pasqyra 47. Numri i bashkepronareve

Bashke-pronare	Nr i Firmave	Perqindja	Perqindja kumulative
1	90	72	72
2	22	17.6	89.6
3	3	2.4	92
4	6	4.8	96.8
5	2	1.6	98.4
6	1	0.8	99.2
10	1	0.8	100
Gjithsej	125	100	

Perfaqesimi reflekton kapitalin e paket te huaj qe ka hyre ne Shqiperi ne keto vite te tranzicionit. Vetem 6% e firmave te intervistuara jane kompani te huaja. Ketu duhet te kemi parasysh se kjo shifer nuk tregon tendecen e vertete te penetrimit te kapitalit te huaj ne Shqiperi por tendencen e penetrimit te tij ne Tirane, ku edhe kushtet per biznes krahasuar me ato te rretheve apo rajoneve te tjera jane me te mira.

Nga rezultati i mesiperm duket se ne klasen e re te sipermarresve shqiptare akoma nuk mund te flitet per konceptin e "bashkeqeverisjes" (Corporate governance). Pronesia eshte e perqendruar ne pak duar, gje qe nuk presupozon asgje te mire per nje



QSHKE, Vrojtimi i Bizneseve te Tiranes, Dhjetor 1999

Grafiku 3. Pronesia sipas numrit te bashkepronareve

zhvillim te tregut te kapitalit. Kjo, sepse shkembimet e pronesise nuk do te kishin ate densitet qe kerkon nje treg i tille. Gjithashtu, ky tregues eshte edhe shenje e mentaliteti, te themi provincial, i sipermarresve shqiptare, te cilet shpesh here preferojene te mos zgjerojne biznesin e tyre se sa ta zgjerojne ate, duke futur edhe te tjere brenda. Nje mentalitet i tille ka rezultuar edhe nga rezultatet e vrojtimeve te meparshme QSHKE-si (studimi i ekonomise informale dhe vrojtimi ne kuadrin e inisiatives Anti-Korrupsion).

Lidhur me moshen e pronarit kryesor, vrojtimi tregoi se mosha mesatare ishte 44.8 vjeç dhe nje nje pjese e mire e sipermarrsve te Tiranes (rreth 35% e tyre) jane ne moshe te re (nen 40 vjeç) gje qe premton te ardhme per zhvillim te metejshem dhe nje kohesisht edhe nje potencial te fuqishem te ketij brezi.

Grafiku 4 tregon se niveli arsimor i sipermarresve te Tiranes eshte shume i larte. Mbi 66% e tyre jane me arsim te larte, qe presupozn edhe nje kulture sipermarrese. Po te krahasohet kjo shifer me rezultatet ne nivel republike, qe kane dale nga vrojtimet e meparshme te QSHKE-



Grafiku 4. Niveli arsimor i pronareve

Pasqyra 48. Kreditimi i biznesit

	Nr. Firmave	Perqindja	Perqindja Kumulative
Po	28	20.14	20.14
Jo	111	79.86	100
Gjithsej	139	100	

se, del se Tirana per nga pikepamja e arsimimit te sipermarresve qendron shume lart. Kjo eshte e kuptueshme kur merret parasysh se Tirana eshte edhe qendra me e madhe edukative dhe kulturore ne vend.

Nga pasqyra 48 shihet se nje pjese e firmave (20 %) pohojne se kane marre kredi ose borxh per fillimin dhe vazhdimin e aktivitetit (1 ne çdo 5 biznesmene e ka filluar aktivitetin me borxhe). Po te kemi parasysh qe kredititmi i biznesit nga sistemi formal bankar keto vite ka qene ne shifra shume te uleta, atehere dalim ne perfundimin se ne Tirane vepron nje treg i fuqishem investues informal.

Nevojat e biznesit, sidomos atij te vogel dhe te mesem per kapital, dihet qe jane shume te medha. Prandaj, nje nga rekomnadimet qe del terthorazi nga ky rezultat eshte se biznesi privat i vogel dhe i mesem duhet ndihmuar me kredi, pasi ecuria e tij do te thote edhe rritje te qendrueshme ekonomike. Nga krahasimi i te dhenave mbi numrin e punonjesve ne fillim te aktivitetit dhe sot duket se firmat ne te gjitha deget kane pesuar rritje ne numrin e te punesuarve. Me e madhe rritja eshte ne ndertim dhe ne industri (kjo e fundit presupozon ndermarrjet dhe fabrikat e vogla, dhe njekohesisht ketu duhet te kemi parasysh se behet fjale per biznese private). Nderkohe, ne sektorin e sherbimeve dhe te tregtise kjo diference

Pasqyra 49. Numri mesatar i te punesuarv ne fillim te aktivitetit dhe sot

Deget	Nr. i Firmave	Fillim i aktivitetit	Sot
Industri	26	11	31
Ndertim	21	13	42
Transport	13	10	18
Sherbime/pa Transport	29	5	10
Tregti	45	3	7
Gjithsej	134	8	21



Grafiku 5. Numri i punonjesve ne fillim te aktivitetit dhe sot

eshte me e vogel, gje qe eshte e kuptueshme pasi keto dege jane te atilla qe nuk kerkojne shume investim ne force punetore. Biznesmenet e kane filluar vete dhe vete vazhdojne ta mbajne aktivitetin qe kane nisur. Duke pare pasqyren e rritjes se numrit mesatar te te punesuarve ne keto biznese lind menjehere mendimi se krijimi i nje mjedisi te shendoshe per zhvillimin e biznesit do te kishte ndikim shume te madh ne uljen e papunesise, gje qe ne fund te fundit eshte ulje e tensioneve sociale.

Ne perpilim e pasqyres se mesiperme jane perjashtuar nga llogaritja ato te dhena te cilat dilnin shume jashte tendeces se pergjithshme. Per kete, si baze eshte marre indikatori i devijimit standart, me idene qe te mund te flitet xhiro mesatare mujore te krahasueshme nga dega ne dege.

Krahasimi i te dhenave te pasqyrave jepet ne grafikun e meposhtem. (shiko edhe pasqyren e perqindjes se rritjes). Nga pasqyra shihet se perqindjen me te madhe te rritjes se biznesit e raportojne firmat e degeve te industrise dhe ndertimit. Llogjikisht, ne terma

Pasqyra 50. Xhiro mesatare mujore ne fillim te aktivitetit dhe sot (milione leke)

Deget	Nr. i Firmave	Fillim i aktivitetit	Sot
Industri	25	1.43	7.2
Ndertim	21	2.22	8.6
Transport	10	2.70	15.4
Sherbime/Pa Transport	47	1.68	3.1
Tregti	28	1.31	5.3



Grafiku 6. Xhiro mesatare mujore ne fillim te aktivitetit dhe sot

afatshkurter, keto jane dhe deget ku mund te investohet me fitime te madh. Sektori i ndertimit eshte e qarte se ka nje boom te jashtezakonshem keto vite ne Tirane per shkak te kerkeses se madhe per ndertime, ndersa sektori i industrise (sidomos per firmat e vogla dhe te mesme) qe shpesh here anashkalohet si sektor pa te ardhme (krahasuar me nivelin e teknologjise dhe te menaxhimit te firmave te huaja) tregon

Pasqyra 51. Rritja mesatare vjetore e biznes

Deget	Nr i Firmave	Rritje mesatare vjetore	Dev. Standart
Industri	23	31	40.68
Ndertim	19	24	38.07
Transport	12	11	7.29
Sherbime/pa Transport	23	15	13.95
Tregti	39	15	19.42

se tregu shqiptar ka nevoje per produkte te prodhuara ne vend.

Grafiku tregon qarte se Tirana eshte qender e firmave me te rendesishme te Republikes, tregu i te cilave shtrihet pertej tregut te vete Tiranes. Ekonomia informale eshte nje nga pengesat me te medha aktualisht te zhvillimit te biznesit te formal. Me fillimin e proçeseve derregulluese te vendit filloi te konturohej edhe nje strukture e re ekonomike, e cila deri ne ate kohe kishte ekzistuar vetem ne format me te thjeshta te saj - *ekonomia informale*. Kjo dukuri ekonomike u be e dukshme krahas rikrijimit te sektorit privat.



Grafiku 7. Tregu qe zoterojne firmat

Si rezultat i anarkise qe ndoqi fillimet e deshtetezimit te ekonomise, mungeses se vizionit te qarte per rolin e shtetit ne nje vend ne tranzicion drejt ekonomise se tregut, si dhe mungeses se pervojave mbi rruget e realizimit te liberalizimit ekonomik dhe te deshtetezimit te prones. sektori informal demonstroi nje zhvillim te shfrenuar

Ne vitet e para te tranzicionit eshte treguar nje vemendje e vogel ndaj sektorit informal. Ne pergjithesi, ai eshte pare si rruge qe ndihmon ne kapercimin e krizes dhe te polarizimit te thelle social te kesaj periudhe. pa menduar per rrjedhojat afat-mesme dhe afat-gjata te saj. Tashme. ky sektor ka arritur ne fazen qe po behet nje pengese serioze per sektorin formal. Duke iu shmangur taksa-tatime dhe detyrimeve te tjera ligjore. ky sektor ka avantazhin e perdorjes se nje çmimi me te ulet duke konkuruar keshtu ne menyre te pandershme biznesmente e rregullt. Sipas vrojtimit. 30% e tregjeve te Tiranes (te mesatarizuara) zoterohen nga sektori informal.

Sipas grafikut 8. deget ku sektori informal eshte me i pranishem jane sherbimet dhe ndertimet. Sherbimet kryhen kryesisht ne menyre individuale. gje qe zvogelon mundesine e "renies ne sy" dhe e ben me te lehte te vepruarit ne "informalitet". Ndersa ndertimi. qe siç eshte theksuar

disa here ne kete material ka pasur nje zhvillim shume te madh keto vite, ka pasur dy shtylla kryesore informaliteti:

se pari, ndertimet pa leje qe paten nje ecuri te shfrenuar dhe te pakontrolluar dhe;

se dyti, mundesine e perdorimit te krahut te punes nga migrantet e shumte te ardhur ne Tirane ne keto vite. Keta migrante, perveç se ishin te lire krijojne njekohesisht edhe mundesine e punesimit te paregjistruar, qe eshte nje nga format me te perhapura te informalitetit ne vend.



Grafiku 8. Perqindja e tregut rajonal te Tiranes qe zoterohet nga kompani informale

Te pyetur per veshtiresite qe ndeshin bizneset ne veprimtarine e tyre (biznesmenet duhet t'i vleresonin ne shkallen nga 1=veshtiresi shume e vogel deri ne 5=veshtiresi shume e madhe), vleresimet mesatare jepen ne pasqyren dhe grafikun e meposhtem:

Opinionet te sipermarresve tregojne se tre veshtiresite me te medha aktuale te bizneseve ne Tirane jane:

- Infrastruktura (infrastruktura fizike (rruget, telekomunikacioni), prodhuese (elektriku, uji);
- Niveli i larte i taksave;
- Paqendrueshmeria ekonomike.

Keto jane edhe prioritet ne te cilat duhet te fokusohen politkat e zhvillimit per te krijuar nje mjedis te qendrueshem per biznesin. Madje, biznesmenet i klasifikojne keto tre

Pasqyra 52. Veshtiresite e biznesit

Veshtiresite	Nr. i Pergjigjeve	Vleresimi mesatar
Aktet nenligjore dhe procedurat	141	3.06
Niveli i late i taksave	142	3.80
Kosto e larte e korrupsionit	140	3.22
Krimi dhe vjedhja	140	3.41
Burokracia shtetrore joefektive	138	3.15
Infrastruktura e papershtatshme	142	4.05
Paqendrueshmeria politike	142	3.56
Politikat ekonomike te papershtatshme te qeverise	140	3.14
Kontrolli i çmimeve	137	2.39
Politikat ekonomike te papershtatshme te pushtetit lokal	137	2.71
Inflacioni	139	2.87
Financimi	139	3.47
Pushteti gjyqesor i dobet	138	3.42



Grafiku 9. Veshtiresite me te medha te bizneseve te Tiranes

veshtiresi edhe perpara problemit te financimit, i cili ne kushte te tjera duhet te ishte nder problemet kryesore te zhvillimit te biznesit. Keto jane veshtiresite me te medha qe shprehin biznesment, por nga ana tjeter duhet te kemi parasysh se sipas shkalles se vleresimit çdo alternative qe eshte mbi 3 (nivelin mesatar) eshte problem i konsiderueshem. Keshtu qe, perveç tre alternativave te fundit, kontrolli i çmimeve (Shqiperia eshte shume e liberalizuar ne kete drejtim), politikat

ekonomike te pushtetit lokal (per momentin nuk ka shume mundesi te ndikoje ne ekonomine lokale per shkak te kufizimeve buxhetore) dhe inflacionit (qe eshte vendosur nen kontroll), te gjitha alternativat e tjera jane probleme te konsiderueshme per mjedisisn e biznesit dhe duhen marre ne konsiderate.

Korrupsioni mbetet gjithashtu nje pengese serioze per zhvillimin e biznesit. Ky fenomen, perveç se eshte nje menyre per te stimuluar konkurencen e pandershme, eshte edhe nje fenomen me nje kosto te larte. Sipas te dhenave te vrojtimit, 55% e te intervistuarve pranojne se paguajne rryshfet.

Ne ecurine e biznesit, rryshfeti ka marre pamjen e nje takse te detyrueshme, duke u futur keshtu ne çmimin e produktit/sherbimit qe shitet. Prandaj, edhe nje nga rruget qe duhet te ndiqet ne luften kunder korrupsionit eshte jo vetem duke u bazuar ne rregullat etike dhe morale, qe shpesh here jane te pakuptueshme per njerezit e dale nga nje sistem ideologjik, por edhe bazuar ne faktin se korrupsioni ka nje kosto ekonomike, nje kosto qe paguhet nga qyetatret pasi ajo reflektohet ne çmimet e mallrave/çmime qe konsumatori i paguan.

Edhe kriminaliteti duket se eshte problem per biznesin e Tiranes. 35% e sipermarresve deklarojne se paguajne gjoba per grupet kriminale, shifer kjo alarmante per rendin.

Pasqyra 53. Fitimi qe shkon si rryshfet

Madhesia	Frek.	Perqind
0%	63	44.7
deri ne 5%	60	42.6
5-10%	17	12.1
10-20%	0	0.0
20-50	1	0.7
Gjithsej	141	100



Grafiku 10. Perqindja e fitimit qe shkon per rryshfete

Biznesi ne Tirane duket se ka shume nevoje per kredi, kur 86% e biznesmeneve te pyetur kane deklaruar se nevojet e biznesit tiranas per kredi jane te medha deri shume te medha (atyre u eshte kerkuar te vleresojne nevojat per financim ne shkallen nga 1=shume te vogla ne 5=shume te medha). Ndersa, persa i perket efektshmerise se struktures ligjore ne ndihme dhe perkrahje te biznesit, 56% e te intervistuarve mendojne se kjo efektshmeri eshte e vogel deri shume e vogel, 34% jane neutrale dhe vetem 10% mendojne se kjo efektshmeri eshte ne nivel te larte.

Pasqyra 54. Fitimi i kerkuar si gjobe nga grupe te ndryshme kriminale

Madhesia	Nr.i pergjigjeve	Perqindje
0%	91	65
deri ne 5%	42	30
5-10%	5	3.6
10-20%	2	1.4
20-50	0	0
Gjithsej	140	100

Analiza e ketyre pergjigjeve nxjerr rezultate shume interesante. Sipas opinionit te biznesmeneve, sektori ku ka me shume interes te investohet ne Tirane eshte sektori i sherbimeve (56% e te intervistuarve e kane perzgjedhur kete sektor si me me interes). Edhe nga nje analize empirike qe mund t'i behet tregut te Tiranes vihet re se ky sektor eshte ai qe ka nevoje me shume per investime. Nderkohe, sektoret qe duket se kane mbingopur tregun, si ai i tregtise me pakice dhe i transportit nuk vleresohen nga biznesmenet si sektore me interes. Interesi i biznesmeneve vleresohet ne rradhe te pare nga norma e fitimit, dhe dihet se kjo norme eshte me e madhe ne ata sektore qe jane edhe te "parrahur" shume. Duket se pikerisht variabli, ne te cilin jane mbeshtetur biznesment e pyetur, eshte pikerisht nevoja e tregut.



Grafiku 11. Avantazhet e rajonit te Tiranes



Grafiku 12. Sektoret me interes investimi ne te ardhmen

Edhe sektori i industrise se lehte dhe asaj ushqimore konsiderohen me interes, duke pasur parasysh edhe rritjen e madhe te madhesise thithese te tregut te Tiranes. Ky sektor perkon edhe me propozimin e bere ne kete studim me krijimin e nje zone industriale, e cila ne te vertete do te perfshinte, perveç ndermarrjeve te vogla dhe te mesme te industrise, edhe sektorin e sherbimeve.





Grafiku 13. Vleresimi per nivelin e tarifave doganore *Grafiku 14. Vleresimi per nivelin e interesave te kredive*





Grafiku 15. Vleresimi per nivelin e Tatimit mbi fitimin *Grafiku 16. Vleresimi per nivelin e TVSH*

Te pyetur per cilesine e sherbimeve qe kryen pushteti lokal, biznesmenet japin opinionet e meposhtme (shkalla e vleresimit nga 1= Shume e ulet ne 5=Shume e larte).

Pasqyra 55. Cilesia e sherbimeve bashkiake

Sherbimet	Nr. i pergjigjeve	Mesatare
Gjelberimi	142	1.94
Ujesjellsi dhe kanalizimet	142	1.51
Mirembajtja e rrugeve	142	1.39
Parkingu	140	1.86
Ndriçimi rrugor	142	2.40
Transporti publik	142	2.29
Urbanistika	142	1.91
Kontrolli i perdorimit te tokes	141	1.62
Shkollimi	142	3.13
Kujdesi shendetsor	142	2.75
Tregjet e hapura	142	2.44
Mbrojtja e mjedisit	142	1.39



Grafiku 17. Cilesia e sherbimeve bashkiake

Vihet re se sherbimet e mesiperme konsiderohen si te cilesise shume te ulet nga ane e biznesmeneve. Permiresimi i tyre ka te beje si me permiresimin e jetes se qytetareve, ashtu edhe me permiresimin e mjedisit te aktivitetit te biznesit. Pushtetit lokal i lind nje detyre shume e rendesishme ne ndertimin e politikave ekonomike per zhvillimin e rajonit. Tashme, edhe me hartimin e Strategjises se Decentralizimit te Pushtetit, ky qeveria vendore do te kete nje autoritet me te madh persa i perket pronave lokale (te bashkise) si edhe autoritet financiar per te ndermarre investime.



Grafiku 18. Nevoja e nje zone industriale ne rajonin e Tiranes

Lidhur me idene e ndertimit te nje zone industriale, 97% e te intervistuarve e konsiderojne ndertimin e saj si nje mjet qe do t'i sherbente zhvillimi te shpejte te rajonit te Tiranes. Duke u nisur edhe nga keto rezultate, eshte pergatitur nje studim te veçante per ndertimin e nje zone te tille industriale, e cila do te kishte shume avantazhe si per bizneset, ashtu edhe per vete qytetin e Tiranes.

VII. PARKU INDUSTRIAL I TIRANES

Sikurse kemi trajtuar, Tirana si kryeqytet i vendit, ka qene rajoni ekonomik kryesor i vendit. Ekonomia e saj ka qene e shperndare ne te gjithe territorin, jo vetem ne periferi por edhe ne brendesi, midis blloqeve te banimit. Ajo ishte vendosur jo mbi baze kriteresh, mjaft te studjuara nga pikpamja urbanistike, mjedisore dhe nga ana e arkitektures. Pavaresisht nga mangesite e vendosjes se ndermarrjeve ekonomike te qytetit te Tiranes, mund te dallohen 4 rajone kryesore te vendosjes se tyre:

Zona I perfshin rajonin jugperendimor ne hyrje te Tiranes nga TEC-i dhe deri tek kryqezimi i rruges "21 Dhjetori". Ne kete rajon funksiononin ndermarrje te tilla te fuqishme si: Kombinati i Tekstileve, Kombinati i Perpunim-Drurit "M. Mame" Kombinati Ushqimor, ndermarrje te veshjeve, te ndertimit, Gjeologjise, etj.

Zona II perfshin rajonin veri-perendimor (anes rruges se Durresit deri tek Stacioni i Trenit) ku vepronin ish ndermarrje te tilla si: Kombinati i Materialeve te Ndertimit "J. Pashko", fabrikat e tullave, ndermarrje: elektro-mekanike, Elektro-Teknike, Abrazive, Uzinat Partizani e Tirana, Instituti Zoo-Teknik, ndermarrjet e Montimeve-Industriale, etj.

Zona III perfshin rajonin nga stacioni i Trenit dhe deri ne Kino-Studio, ku kane funksionuar ndermarrje te tilla si: ish ndermarrjet e Ndertimit te Linjave te Tensionit te Larte, Uzinat Dinamo e Re, Dinamo e Vjeter, Uzina Dajti, Ndermarrja Kimike, Kombinati i Mish-Qumeshtit, Gezof-Galanterise, ndermarrjet e Rruga-Ures, Porcelanit, Ndermarrjet e prodhimit "Sixhadese", Artistike Migjeni, Kino-Studio etj.

Zona IV perfshin rajonin veri-lindor, ku kane funksionuar ndermarrje te fuqishme: Kombinatet e Autotraktoreve, Poligrafike, ndermarrje te ndertimit te minierave, uzina e Gjeologjise etj.

Ne periferi te Tiranes dhe ne krahe apo brenda zonave te siperme vepronin edhe nje varg ndermarrjesh bujqesore si: Ndermarrja "17 Nendori", "Gjergj Dimitrov", Vora, Marikaj, Kamze, te cilat ishin furnizuesit kryesore te Tiranes me perime, qumesht, fruta, rush, etj. Sistemi ekonomik socialist udhehiqej nga gjigandomania, prandaj ngriti ndermarrje te medha, jashte mundesive konkrete te ekonomise shqiptare dhe mjedisit ekonomik, ku operon Shqiperia ne kushtet e ekonomise se tregut. Kjo, krahas mangesive te medha qe rezultuan gjate proçesit te privatizimit, beri qe shumica e ndermarrjeve te funksionojne pjeserisht dhe mjaft prej tyre te jene likuiduar.

Zhvillimi Ekonomik ne teresi dhe ai rajonal ne veçanti ne kushtet e ekonomise se tregut, ka kerkesa te tjera, te cilat ne te kaluaren nuk mund te mbaheshin parasysh dhe te zgjidheshin jo vetem ne zhvillimin ekonomik, por veçanerisht ne ate mjedisor. Pervoja boterore lidhur me zhvillimin ekonomik rajonal njeh edhe ndertimin e parqeve industriale.

VII. 1 Paraqitje e Pergjithshme

Perqendrimi industrial ne formen e nje "zone industriale" eshte i mundur ne zonat suburbane te Tiranes. Megjithe ekzistencen e ndermarrjeve te ndryshme industriale ne zonat suburbane, nuk ekziston nje park real industrial sipas standarteve nderkombetare. Eshte evidente se nje hapesire e tille e organizuar do te paraqese standarte te reja te mbrojtjes se mjedisit dhe do te siguroje qe ndermarrjet e industrise te veprojne brenda infrastruktures se nevojshme. Parku industrial i propozuar duhet te jete i madhesise se mesme (40 – 100 hektar), p.sh. 50 ha, i organizuar ne menyre te tille qe te pranoje ndermarrje te vogla dhe te mesme, veçanerisht ato qe kerkojne shume fuqi punetore.

Gjate periudhes se tranzicionit ka ndodhur nje pakesim i ndotjes industriale se mjedisit, sepse shumica e fabrikave ekzistuese nuk kane mbijetuar ne tregun e lire. Megjithese shumica

e ndermarrjeve te ndodhura ne komplekset industriale te Tiranes nuk jane me ne aktivitet, ende ekzistojne disa fabrika te medha qe kane historikun e tyre. Nje zhvillim interesant eshte se tashme, si rezultat kryesisht i investimeve te huaja, jane krijuar disa fabrika te reja te vogla dhe te mesme qe i perkasin industrise se lehte dhe ushqimore.

Mendohet qe ne parkun industrial te instalohen njesi te vogla me perdorim te gjere te fuqise punetore. Perveç ketyre fabrikave, duhet te ndertohen lehtesirat e meposhtme infrastrukturore:

- Nje impjant paratrajtimi per mbetjet e lengshme te krijuara ne parkun industrial;
- Nje sistem i kanalizimit te ujrave te zeza, qe te grumbulloje si mbetjet industriale dhe ujrat e shirave dhe t'i transportoje ato ne njesine e paratrajtimit;
- Nje sistem menaxhimi te mbetjeve te ngurta per grumbullimin dhe transportimin e tyre te prodhuara ne park;
- Nje qender administrimi, e pajisur me makineri, zyra dhe mbeshtetje sekretarie si per menaxhimin e parkut, ashtu edhe per te siguruar sherbimet per kompanite qe do te veprojne ne park.

Parku industrial propozohet qe te vendoset ne zonen e Laprakes. Do te ndertohet nje rruge lidhese qe per qellime estetike do te kete nje zone te gjelberuar pergjate saj. Rrjeti i rrugeve te brendeshme duhet te konsistoje ne nje rruge kryesore, qe kalon permes te parkut, duke lidhur hyrjet tij, nje rruge unazore rreth parkut dhe rruge lidhese sekondare per ne ndertesat industriale.

Parku industrial duhet qe te furnizohet realisht me uje dhe energji elektrike. Propozojme qe furnizimi me uje dhe rrjeti i energjise elektrike te vendosen nentoke nga njera ane e rruges dhe rrjeti i kanaleve te ujrave te zeza nga ana tjeter e rruges. Per furnizimin e rregullt me uje te ndertohen nje depozite me dy dhoma. Kjo do te ndihmoje furnizimin me uje ne rast mungese, demtimi, zjarri, kerkese me te madhe se zakonisht, ose probleme te tjera ne rrjetin e nje zone te gjere. Rrjeti i furnizimit me uje do te kombinohet me rrjetin e mbrojtjes nga zjarri, te vendosur ne nje pike te pershtatshme te parkut industrial. Rrjeti i furnizimit me uje te parkut industrial duhet te lidhet me rrjetin ekzistues te nje zone me te gjere. Propozojme qe per ndertimin e rrjetit te furnizimit me uje te perdoren tubat e PVC dhe ne disa pika tuba çeliku. Nje alternative e mundshme eshte perdorimi i tubave amiant-beton. Per te qene te sigurte se gjithnje ekziston nje burim shtese i ujit, duhet qe gjithashtu te shpohen puse, duke siguruar qe cilesia dhe sasia e ujit nentoksor te jete e pershtatshme per perdorim industrial. Per kontrollin e funksionimit te pershtatshem te rrjetit, duhet te perdoren pajisjet e meposhtme: valvola kontroli, valvola ajri, vleresues rrjeti, hidratues zjarri, etj.

Kanalizimet e ujrave te shiut duhet qe te ndertohen ne te gjitha rruget e parkut. Perveç tubave betonike te parafabrikuara eshte e mundur qe te perdoren edhe tuba katror. Tubat e mbetjeve ujore duhet te vendosen ne te gjitha rruget e zones. Do te jete me mire qe mbetjet ujore te drejtohen tek impjanti i paratrajtimit te mbetjeve sipas levizjes me gravitet dhe me tej te drejtohen ne impjantin kryesor te paratrajtimit. Tubat e PVC te fiksuara ne tubat betonik ose amiant – betonik duhet te perdoren per rrjetin e trajtimit te mbetjeve ujore. Per kontrollin dhe funksionimin e pershtatshem te rrjetit, duhet te ndertohen tubat kontrolluese dhe tubat e pastrimit. Duhet te ndertohet nje impjant paratrajtimi i mbetjeve ujore, me qellim pakesimin e ndotjes nga mbetjet industriale.

Propozojme qe shtylla tensione betonike 10 m te larta te perdoren per qellim ndriçimi rrugor. shtylla te cilat duhet te vendosen nga njera ane e rruges ne çdo 40 m. Per ndriçim duhet te perdoren llampa me sodium te presionit te larte. Kabllot elektrike duhet te jene nentoksore, te futura ne tuba plastike.

Parku duhet te kete qendren e vete. Sherbimet qe do te ofrohen nga qendra duhet te klasifikohen ne:

- *Propogandim i informacionit.* Sherbimet me karakter te tille duhet te krijohen per ndermarrjet e vendosura ne parkun industrial dhe gjithashtu t'u jepen si ndermarrjeve te tjera te rajonit. Kjo permbledh kryesisht:

• Publikimit te nje buletini informativ;
• Informacion i fokusuar ne tregjet e brendshme dhe ne ato te huaja dhe mundesite e eksportit;
• Promocioni i imazhit te rajonit;
• Kontakte me kliente dhe furnizues te mundshem te lendeve te para.

➢ *Asistence teknike dhe organizative per ndermarrjet.* Keto sherbime behen per te plotesuar nevojat specifike te ndermarrjeve si:

• Organizimi i prodhimit;	• Nxitja e eksporteve;
• Kompjuterizimi;	• Marketingu;
• Menaxhimi financiar;	• Sistematizimi i kontrollit te cilesise;
• Skicimi i produkteve te reja;	• Sistematizimi i kontrollit te kostos se proçesit te prodhimit
• Organizimi administrativ	• Planizimi strategjik

➢ *Sherbime me karakter te veçante.* Keto sherbime jane per sektoret me interes te veçante dhe kryesisht i referohen ndermarrjeve qe jane brenda parkut industrial. Sherbime te tilla jane: vrojtimet e tregut, programet e trajnimit dhe te edukimit, programet sektoriale, pjesmarrja ne panaire dhe ekspozita ose organizimi i ngjarjeve te te tilla per biznesin.

Parku industrial do te terheq investime te reja ne kete rajon, duke u siguruar token e nevojshme dhe te gjithe sherbimet qe do te kerkojne ndermarrjet e reja. Keshtu, parku industrial do te mbeshtese ndermarrjet e reja te kapercejne problemet e integrimit per te zhvilluar nje treg te ri, do te ndihmoje ndermarrjet ekzistuese te adoptojne teknologji te re dhe perfundimisht do te riktheje edhe nje here rajonin si nje pol industrial. Infrastruktura e mbrojtjes se mjedisit te parkut industrial siguron qe zhvillimi industrial i zones nuk do te demtoje mjedisin.

VII. 2 Statusi Juridik i Zones Industriale

Sipas legjislacionit shqiptar, nje zone industriale mund te kete statusin e meposhtem:

- *zone – park industrial,*
- *zone doganore,*
- *zone e lire.*

Keto forma juridike ndryshojne nga njera-tjetra ne lidhje me lehtesirat qe ofrojne ose jo brenda nje strukture ekonomike. Per me teper, problemi i zgjedhjes midis tyre behet me i rendesishem pasi ndikon me teper ne koston e investimeve, koston e funksionimit, çmimin e tokes brenda zones. Te tre format e permendura me siper jane ligjore dhe respektivisht te bazuara ne keto ligje shqiptare: zhvillimi i parkut industrial bazohet ne Vendimin e Keshillit te Ministareve *"Per krijimin e parqeve industriale"* Nr. 284, date 5.6.1995; krijimi i zones doganore bazohet ne Kodin Doganor Shqiptar, ligji Nr. 8449, date 27.01.1999, dhe krijimi i zonave te lira bazohet ne ligjin *"Per zonat e lira"* Nr. 8072, date 15.02.1996.

Ne vazhdim jepen me teper detaje per veçorite e perbashketa dhe ndryshimet qe kane keto forma ligjore, dhe gjithashtu si ndikojne ato.

•Gjeja e pare e perbashket per te tre format eshte akti bashkues i te tre subjekteve kryesore: zhvilluesi, i cili ndermer zhvillimin e zones; perdoruesi, i cili ushtron aktivitetin e tij brenda zones; dhe shteti, i perfaqsuar nga qeveria qendrore ose lokale.

•Nje veçori tjeter e perbashket eshte se investimet jane te perqendruara ne zone, per pasoje kane nje kosto me te ulet te infrastruktures, nje siguri me te madhe dhe mundesi per permiresim te menaxhimit.

Ndryshimet midis ketyre formave kane lidhje me nivelin e lehtesirave fiskale dhe doganore qe ofrojne secila prej tyre.

➢ *Parqet industriale.* Parku industrial nuk ofron ndonje lehtesi fiskale dhe/ose doganore. Si rezultat, kosto e investimit dhe e funksionimit nuk kane ndryshime me investimet e tjera private te bera ne zona te ngjashme, me perjashtim te efektit ekonomik qe ofron koncentrimi E shprehur ne terma ekonomik, kjo do te thote se perdoruesi do te preferoje te veproje ne nje park industrial vetem ne qofte se ka nje çmim konkurues te tokes/nderteses dhe nese infrastruktura qe parku ofron i kenaq kerkesat e tij. Ne kete fushe, legjislacioni shqiptar ne kete fushe eshte akoma larg te qenit i plote.

- *Zonat doganore.* Legjislacioni shqiptar dhe Kodi Doganor trajtojne probleme te zonave doganore. Si nje percaktim i pergjithshem, zona doganore perfshin territorin ne kushtet ku autoritetet doganore ushtrojne aktivitetin e tyre dhe gjithashtu *te gjitha zonat ku keto autoritete ushtrojne kontrollin ose supervizionin.* Zonat doganore jane krijuar ne pikat e kontrollit te kalimit kufitar si dhe ne pika te tjera te territorit doganor. Me fjale te tjera, disa zona brenda territorit doganor mund te marrin statusin e zones doganore, ku mund te kryhen aktivitete te lejuara, dhe te cilat jane nen kontrollin e autoriteteve doganore. Krijimi, zgjerimi territorial dhe klasifikimi i zonave doganore percaktohen nga Keshilli i Ministrave sipas propozimit te Ministrit te Financave.

Ne perputhje me Kodin Doganor, ka shume lloje aktivitetesh te lejuara ne nje zone doganore. Por, ketu po permendim vetem ato aktivitete, te cilat kane te bejne me fushen e interesave te studimit (zhvillimi i nje zone industriale):

A. Proçedura e magazinave doganore lejon ruajtjen ne magazinat doganore te mallrave joshqiptare, duke perjashtuar ato mallra qe jane subjekt i taksave te importit ose masave te politikes tregtare; dhe mallrat shqiptare, ne rastin e zbatimit te masave normale qe shoqerojne eksportin e ketyre mallrave. Aktiviteti dhe perdorimi i nje magazine doganore eshte subjekt i autorizimit nga autoritetet doganore. Ky status do te jete interesant per ata perdorues qe si aktivitet kryesor kane tregtine me shumice dhe shperndarje te mallrave ne Shqiperi dhe/ose ne territore te tjera doganore. Kosto e transportit eshte nje faktor qe duhet te merret ne konsiderate prej tyre.

B. Proçedurat e veprimit te brendshem. Perdoruesit ne nje zone doganore mund te kene avantazhe te proçedurave te veprimit te brendshem. Kjo gje lejon qe mallrat e meposhtme te perdoren ne territorin doganor te Republikes se Shqiperise ne nje ose me teper operacione perpunimi:

- mallrat joshqiptare te parashikuara per eksport nga territori doganor i Republikes se Shqiperise, ne forme te produkteve te kompensimit (te perpunuara), pa qene subjekt i taksave te importit ose te masave te politikave tregtare;
- mallrat e çliruara nga qarkullimi i lire me ripagese ose shlyerje te detyrimeve te importit te ngarkuara per keto mallra ne se ato eksportohen nga territori doganor i Republikes se Shqiperise ne formen e produkteve te kompensimit.

C. Proçedura per perpunim nen kontrollin doganor eshte nje procedure tjeter perpunimi qe mund te kryehet ne nje zone doganore. Ajo lejon mallrat joshqiptare te perdoren ne aktivitete ne territorin doganor te Republikes se Shqiperise, te cilat ndryshojne natyren ose gjendjen e mallrave, pa qene subjekt i detyrimeve te importit ose masave te politikes tregtare dhe lejojne produktet, qe rezultojne nga aktivitete te tilla, te jene te çliruara per qarkullimin e lire ne kategorine e detyrimeve te importit qe u perkasin atyre. Te tilla produkte duhet te kushtezohen ne produket e perpunuara. Lista e rasteve ne te cilat mund te perdoret proçedura e perpunimit nen kontrollin doganor eshte percaktuar ne listat e Kodit Doganor. Ky status, i ngjashem me statusin e meparshem (B), do te jete me interes per ata perdorues qe duan te veprojne ne Shqiperi me materialet e importit, duke shfrytezuar avantazhet e fuqise punetore, aktualeisht konkuruese, si dhe çmimin e tokes.

Zona doganore, ne krahasim me parkun industrial, u lejon perdoruesve nje sere proçedurash lehtesuese dhe gjithashtu ofron disa lehtesira nga detyrimet e import-eksportit dhe perjashtimin e perkohshem nga taksat indirekte per mallrat. Ne terma ekonomik, kjo do te thote se perdoruesit qe veprojne ne zona doganore (duke zgjedhur nje nga proçedurat e permendra me siper) do t'ju nevojitet me pak kapital sesa kur e ushtrojne aktivitetin jashte zonave te tilla. Ne te njeten kohe, ka me pak burokraci ne proçedurat e import-exportit se sa ne nje zone industriale. Ekziston mundesia per nje park industrial te krijuar, qe gjate funksionimit te tij te zbatoje statusin e zones doganore.

- *Zonat e lira.* Nje zone e lire ose zone e export-perpunimit eshte nje park industrial ku materialet dhe pajisjet mund te importohen pa detyrime dhe taksa permes nje proçedure doganore te organizuar me mire. Nga pikpamja e doganes, zona eshte nje ekstraterritor (sipas ligjit ne fuqi). Zona e lire eshte nje zone e percaktuar, e mbyllur dhe e siguruar me

premisa per aktivitete prodhimi, tregtare dhe sherbimi.

Gjithashtu, ajo garanton siguri fizike dhe liri veprimtarie. Ajo mund te ofroje per investitoret (zhvillues, perdorues dhe/ose te tjere) nje mjedis " te lire nga burokracite". Me lehtesi mund te zvogelohet ose eleminohet nderhyrja e panevojshme nga agjensite rregullatore. Kjo gje mund te jete nje avantazh i rendesishem per investitoret qe veprojne ne nje mjedis ekonomik me ndryshim te shpejte. Gjithashtu, zona e lire ofron nje sere lehtesirash fiskale dhe doganore. Ligji Shqiptar per zonat e lira ofron perjashtim te plote nga detyrimet doganore dhe disa taksa, dhe gjithashtu nje perjashtim te limituar nga taksa e fitimit per aktivitete ne zone (shtate vitet e para). Te gjitha mallrat e sjella ne nje zone te lire jane subjekt i mbikqyrjes dhe kontrollit doganor, ne perputhje me kodin doganor dhe me rregullat e zbatimit te doganes. Nese mallrat, te cilat nuk jane tranzite midis nje zone te lire dhe nje pike hyrje/dalje, jane blere ne nje zone te lire nga nje pjese tjeter e territorit doganor te Shqiperise, ato mund *te* perftojne nga masat e aplikuara normalisht per mallrat e eksportit. Sherbimet e bera nga nje pjese tjeter e territorit doganor te Shqiperise, duke perfshire edhe sherbimet e infrastruktures, te realizuara per nje zhvillues dhe perdorues ne nje zone te lire mund te perftojne nga masat e aplikuara normalisht ne sherbimet e eksportit.

Ligji percakton proçedurat per krijimin e zones se lire dhe per liçensen e zhvilluesit dhe te perdoruesit. Autoriteti Kombetar per Zonat e Lira ka te gjitha te drejtat dhe detyrimet per te nxitur, zhvilluar, menaxhuar, mbikqyrur dhe kontrolluar zonat e lira. Se fundi, nje pike qe duhet theksuar eshte se krijimi i zonave te lira eshte nje problem i politikes ekonomike qe ndjek qeveria shqiptare dhe ndikohet nga kushtet aktuale te zhvillimit te vendit dhe ne rajonin e Ballkanit.

VII. 3 Kerkesa nga Firmat Lokale dhe Investitoret e Huaj

VII.3.1 Metodologjia, Perkufizimet

Analiza e kerkeses perpiqet te trajtoje çeshtjet e meposhtme:

- Te vleresoje karakteristikat kryesore (madhesine, pronesine, deget, nivelin e zhvillimit etj) te ndermarrjeve qe do te kene interes qe te jene perdorues potencial te parkut industrial;
- Te percaktohet madhesia optimale e parkut;
- Te percaktohet modeli i perdorimit te tokes, ne menyre qe te plotesoje nevojat e perdoruesve potencial te permendur me siper;
- Te vleresohet shperndarja e kerkeses per nje periudhe 20 vjeçare, me qellim qe te pershtaten supozimet ne te cilat do te bazohen vleresimet ne lidhje me mbijetesen e ardhshme ekonomike te parkut;
- Te identifikohen kushte ne te cilat interesat ose dyshimet paraprake te sipermaresve per krijimin e parkut industrial do te transformohen ne nje objektiv konkret vendndodhjeje

VII. 3.2 Mjedisi ekonomik dhe prirja e levizshmerise se investimeve

Ne te kaluaren, Tirana ka qene poli kryesor industrial dhe tregtar jo vetem per nje zone te gjere, por per gjithe Shqiperine. Duke patur avantazhet e nje vendndodhje strategjike ne qender te vendit dhe si kryeqytet i vendit, Tirana kishte mundesite te mbetej nje sistem i hapur ekonomik dhe social. Megjithate, gjate dekades se fundit Tirana, si e gjithe Shqiperia, nuk mbeti e paprekur nga dy krizat e medha ('90 dhe '97), te cilat goditen ekonomine shqiptare dhe sollen destabilizim te pergjithshem te ekonomise se vendit.

Pavarsisht nga problemet e medha ekonomike dhe sociale qe perballoi Tirana, ajo mund te karakterizohet si nje rajon me nje kulture te rendesishme industriale, veçanerisht ne fushen e ndertimit, tekstileve, industrise se lehte dhe industrise ushqimore. Ajo ka trasheguar nje fuqi punetore te kualifikuar dhe nje kulture biznesi qe me lehtesi mund t'i pershtatet kerkesave te reja te biznesit.

Lidhur me idene e parkut industrial ne rajonin e Tiranes, duhen analizuar pikat e forta dhe te dobta qe e mbeshtesin kerkesen per ngritjen e tij:

- *Pikat e forta qe mbeshtesin kerkesen per Park Industrial*
- Mjedis ekonomik nderkombetar i favorshem, qe mbeshtetet nga çmime konkuruese

te fuqise punetore dhe vleres se tokes, i kombinuar me kosto relativisht te ulet te transportit ne rajon;

- Vendndodhja strategjike e Tiranes;
- Burime lendesh te para te pashfrytezuara ne rajon;
- Specializim i trasheguar ne fushen e industrise;
- Problemi i sigurise dhe i furnizimit te regullt me energji per ndermarret ekzistuese;
- Grantet dhe mundesite e tjera financuese qe tashme i ofrohen Shqiperise (nga Banka Boterore, EIB, BERZH, borxhe shteterore, etj.);
- Interesat, e shprehura per ripozicionim te investimit nga investitore te fuqishem, sidomos te vendeve fqinje;
- Interesa te reja investuese si pasoje e permiresimit te kushteve ekonomike, politike dhe sociale te vendit.

➢ *Pikat e dobta ne lidhje me kerkesen per Park Industrial*

- Pasiguria ne lidhje me kushte e pergjithshme ekonomike dhe sociale ne Shqiperi;
- Mungesa e aftesise se ndermarrjeve qe te perpunojne plane specifike biznesi per prioritetet e nevojave te tyre;
- Mundesia e kufizuar e Fondeve te Investimeve Private;
- Mungesa e besimit ne lidhje me materializimin e projekteve te medha te infrastruktures per vendin;
- Mungesa e nxitjeve specifike per investitoret potencial te Parkut Industrial.

Megjithate, kuptohet se ekzistenca e nje parku industrial do te ngreje fuqishem atraktivitetin e zones per investitoret e huaj, veçanerisht te vendeve fqinje, per me teper te investitoreve shqiptare. Gjithashtu, ekzistenca e nje numri ndermarrjesh te huaja ose joint-ventures te konsoliduara ne fushen e perpunimit ushqimor dhe te pijeve, ne lidhje me traditen e kultures se sipermarrjes ne keto dege, mund te mbeshtese krijimin e nje parku indusrtrial. Sipas eksperiences nderkombetare, Parqet Industriale me specializim te madh jane terheqes per perdoruesit potencial. Tashme, kapercimi i papershtashmerise strukturore ne pergjithesi, ne ekonomine shqiptare konsiderohet si nje kusht i domosdoshem ne prioritetet e investimeve.

VII. 3.3 Permes nje modeli specifik per nje park industrial: Pervoja nderkombetare

a. Llojet e parqeve industriale. Parqet industriale konsiderohen si nje praktike e zakonshme biznesi ne Ameriken e Veriut dhe Europen Peredimore. Ato mund te klasifikohen ne:

- Parqe industriale sekuenciale ne perqendrimet industriale ekzistuese;
- Parqe industriale te zhvilluara ne zona me perdorim te meparshem (psh., baza ushtarake);
- Parqe industriale te zhvilluara ne zona qe nuk kane qene te perdorura me pare.

Sipas sherbimeve qe kryejne, parqet industriale mund te klasifikohen:

- Parqe industriale te perdorimit te pergjithshem industrial dhe te sherbimeve;
- Parqe industriale te specializuara, te parapercaktuara per dege te industrise dhe sherbime te nevojave te veçanta.

b. Sherbimet e ofruara. Shumica e Parqeve Industriale nuk jane te kufizuar vetem ne ofrimin e siperfaqeve per ndermarrje industriale. Duke qene hapesira te perdorshme per aktivitete te ndryshme, ato shpesh karakterizohen si parqe biznesi. Sherbimet me te shpesha te nje parku industrial tipik mund te permblidhen si vijon:

- Shitje ose dhenie me qera te parcelave te tokes industriale;
- Shitje ose dhenie me qera te ndertesave (te perfunduara ose gjysem te perfunduara);
- Sigurim, sherbim i ndihmes se pare, mbeshtetje teknike;
- Lehtesira infrastrukturore (hyrje ne rrjetin e transportit, trajtim mbeturinash, telekomunikacion, furnizim me energji, etj.);
- Sherbime te ndryshme te mbeshtetjes se biznesit dhe lehtesira sociale.

c. Skemat operacionale dhe e zhvillimit variojne sipas shteteve, tipit te parkut industrial, etj. Ne shume raste, parqet industriale jane zhvilluar dhe ne to veprojne me teper se nje ent (autoritetet lokale, zhvilluesit e tokes, kompanite e ndertimit, kompanite qe prodhojne energji elektrike, institucione fiskale, etj.). Ka gjithashtu raste te pjesemarrjes

se perdoruesit perfundimtar ne skemen e zhvillimit (veçanerisht kompanite e medha shumkombeshe).

d. Çmimet dhe nxitjet. Kosto e tokes dhe e superstruktures zakonisht ka çmim qe bazohet ne koston e zhvillimit dhe ne fitimin e pritur te zhvillimit. Sherbime te tjera, veçanerisht ato te energjise, menaxhimit te mbeturinave dhe telekomunikimit, ne disa raste jane konkuruese me çmimet e nje zone me te gjere. Kjo çon ne marreveshje te veçanta, te realizuara midis zhvilluesit dhe shperndaresve kryesore ne nje zone te gjere. Ne disa parqe industriale perfshihen nxitesa special per perdoruesit perfundimtar. Ne parim, ato kane te bejne me zbritje te taksave mbi te ardhurat, zbritje te taksave lokale, zbritje te TVSH, etj.

VII.3.4 Nje perngjasim sasior

Duke bere perngjasimin e disa aspekteve sasiore, eshte thelbesore te perpunohet nje modul projeksioni afatgjate, me qellim qe te vleresohen probleme specifike sasiore per kerkesen per park industrial. Eshte e qarte se projeksionet per nje periudhe 20 vjeçare, ne kushtet e pasigurise, mund te quhen vetem si tregues. Megjithate, ky eshte i vetmi instrument qe disponohet per te perngjasuar madhesine optimale dhe shperndarjen e perdorimit te tokes ne nje park industrial per Tiranen. Metodologjia pershkruhet si me poshte:

- Adoptohen supozime per struktura sektoriale makroekonomike te ekonomise lokale per 20 vjetet e ardhshem, te bazuara ne potencialin e vendit dhe ne pervojen nderkombetare. Theks i eshte dhene pjesemarrjes se degeve te industrise ne krijimin e punesimit.
- Bazuar ne standartet nderkombetare ne lidhje me percaktimin e madhesise optimale te nje parku industrial (shkalla e perqendrimit te punesimit ne parkun industrial, punesimi per hapsiren e perdorur, punesimi per ndermarrje) jane nxjere perfundime per kerkesen teorike per hapesire ne parkun industrial.
- Bazuar ne situaten ekzistuese dhe ne pervojen nderkombetare, jane vleresuar nje sere indeksesh specifike (p.sh., thyerja e punesimit sipas madhesise se ndermarrjes, perzjerja e degeve, etj.).

Lidhur me vleresimin e kerkeses per hapesira, ne vazhdim jane dhene tre perngjasime te ndryshme:

Perngjasimi i pare. Sipas literatures, nje park industrial ne periudhen afatgjate konsiderohet si veprimtari e suksseshme, ne qofte se ai menaxhon nje perqendrim prej 25% te punesimit te nje zone te gjere, afersisht me shifren koresponduese te eksperiences greke prej 18%. Per te dhene nje perngjasim te sigurte, analiza konsideron se pas nje periudhe 20 vjeçare, 15% e punesimit ne zonen e Tiranes do te perqendrohet ne Parkun Industrial. Sipas kritereve nderkombetare indeksi i punesimit per dynym ne Parkun Industrial eshte rreth 2.5 persona per siperfaqen gjithsej dhe 3.2 persona per siperfaqen e perdorur. Ne se do te bejme nje krahasim me Greqine, indekset koresponduese jane respektivisht 3 dhe 4. Per te dhene nje perngjasim te sigurte analiza supozon se punesimi per dynym ne Parkun industrial te Tiranes do te jete respektivisht rreth 5 dhe 5.2.

Perngjasimi i dyte bazohet ne supozimet ne vijim:

- Madhesia mesatare e punesimit per njesi prodhuese do te jete rreth 40-45. Ky eshte nje vleresim i moderuar dhe eshte ne perputhje si me standartet e tanishme shqiptare, ashtu edhe me eksperiencen nderkombetare nga rajone te ngjashme (ku punesimi mesatar nuk i kalon 45 personat). Duhet te theksohet se ndermarrjet shume te medha nuk jane shume te lehta per t'u perfshire ne nje park industrial te nje madhesie te tille.
- Madhesia mesatare e nje hapesire industriale per nje njesi (ndermarje) nuk i kalon 10 dynym (1ha). Ky eshte gjithashtu nje supozim i arsyeshem ne baze te standarteve nderkombetare.

Perngjasimi i trete bazohet ne supozimet e meposhtme:

- 80% e punesimit total do te perqendrohet ne deget e industrise qe punesojne mbi 5

punetore. Duhet te permendim se indeksi korespondues tashme i kalon 80%.

- Madhesia mesatare e punesimit e nje njesie sipas industrise do te jete rreth 40-45 punonjes.
- Indeksi i perqendrimit per numrin e njesive ne Parkun Industrial do te jete 15%.
- Madhesia mesatare e hapesires industriale per ndermarrje do te jete rreth 10-12 dynym.

Duhet theksuar se shifrat e mesiperme jane treguese, qe i korespondojne kerkeses teorike, qe mund te shprehet per Parkun Industrial ne kushte te stabilitetit ekonomik dhe politik.

VII. 3.5 Probleme te specifikimit

a. Thyerja sipas madhesise. Ne lidhje me thyerjen e punesimit, ne analizen midis njesive te mesme dhe te medha, u adoptuan supozime se ky raport do te mbetet pak a shume i njejte me ate qe eshte sot. Keshtu, 25% e punesimit do te perqendrohet ne ndermarrjet me 5-20 punonjes dhe pjesa tjeter, 75%, ne ndermarrjet e medha. Thyerja sipas madhesise eshte e rendesishme per te percaktuar plane alternative ne lidhje me madhesine mesatare te parcelave.

b. Miksimi i degeve. Vleresimi i kerkeses per investime te degeve miks bazohet si ne karakteristikat ekzistuese industriale, ashtu edhe ne te dhenat e projektuara sipas dinamikes se rajonit dhe ne pervojen perkatese boterore.

Ne studim u supozua se ne nje periudhe afatgjate:

- Deget e industrise se lehte dhe ushqimore do te mbajne pozicionin e tyre kryesor ne ekonomine lokale, por ato do te zvogelojne peshen e tyre ne ekonomi;
- Perpunimi i drurit, perpunimi i lendeve te para dhe konstruksionet e lehta metalike vleresohen se do te kene nje peshe te rendesishme ne aktivitetin industrial;
- Dege te tjera te industrise si ajo plastike, e mobiljeve, etj., vleresohen se do te zene rreth 10% te punesimit.

Miksimi i degeve te industrise eshte i rendesishem per te percaktuar alternativa te karakteristikave teknike te ndertimit, te cilat ndikojne si ne koston e investimit ashtu edhe ne vleren e zones.

VII.4 Planifikimi Operacional Urban dhe Kerkesat Teknike te Parkut Industrial

VII.4.1 Karakteristikat operacionale

Zona nen zhvillim mendohet se duhet te kete nje madhesi 50 ha dhe eshte ne kufirin e vendosur nga ligji shqiptar per Parqet Industriale (25-50 ha). Madhesia e tokes se shfrytezueshme, sipas kerkeses se projektuar per investime, aktualisht nenvlereson nevojat potenciale per hapesira industriale. Nga ana tjeter, nje park industrial modern i organizuar duhet t'i sherbeje nje sere aktivitetesh si: degeve te industrise, tregtise me shumice dhe nevojave per zyra. Per me teper, perngjasimet krahasuese garantojne efekte te fuqishme perqendrimi. Ne vazhdim jepet nje ndarje treguese teorike e perdorimit te tokes ne parkun industrial qe kenaq kerkesen sipas sektoreve:

Deget e industrise	23.8 ha (68% te tokes se shfrytezueshme)
SME	7.0 ha (20% te tokes se shfrytezueshme)
Magazina	3.8 ha (11% te tokes se shfrytezueshme)
Sherbime biznesi dhe perdorim te veçante	2.0 ha (1% te tokes se shfrytezueshme)

VII. 4.2 Deget e industrise dhe SME

- *Numri i njesive dhe punesimi i inkoporuar.* Bazuar ne politiken e indeksit te perqendrimit te planifikuar, punesimi ne deget e industrise ne parkun Industrial te propozuar eshte llogaritur ne 1300 persona, qe i korespondon vetem 10% te punesimit ne industri ne rajon, ne vend te vleres prej 15% qe eshte dhene si nje detyre e arsyeshme e politikes qe do ndiqet.

• *Thyerja sipas madhesise.* Ne lidhje me thyerjen e punesimit, ne analizen midis njesive te mesme dhe te medha, raporti do te mbetet pak a shume i njejte me ate qe eshte sot. Keshtu, 25% e punesimit (d.m.th. 300 te punesuar) do te perqendrohet ne ndermarrjet me 5-20 punonjes dhe pjesa tjeter 75% (d.m.th. 1 mije te punesuar) ne ndermarrjet e medha. Thyerja sipas madhesise eshte e rendesishme per te percaktuar madhesine mesatare te parcelave. Duke e konsideruar madhesine mesatare te punesimit per SME dhe deget e industrise respektivisht rreth 12-65 punonjes, eshte llogaritur se ne zone do te kene aktivitet rreth 20-30 SME dhe 15-18 ndermarrje industrale. Keshtu, 20% e zones industriale eshte ndare ne parcela prej 1 dynym dhe 80% ne parcela prej 2 dynym secila.

VII. 4.3 Miksimi i degeve

Vleresimi i kerkeses per investime te degeve miks bazohet si ne karakteristikat ekzistuese industriale, ashtu edhe ne te dhenat e projektuara sipas dinamikes se rajonit dhe ne pervojen perkatese boterore. Miksimi i degeve te industrise eshte i rendesishem per te percaktuar karakteristikat teknike te ndertimit, te cilat ndikojne ne koston e investimit dhe ne vleren e zones. Bazuar ne supozimet e mesiperme eshte vleresuar se, konstruksionet e perkohshme (metalike te lehta) do te zene 20% ndaj 80% te konstruksioneve me skelet betoni. Keto indekse per SME do te jene respektivisht 70% dhe 30%.

VII.4.4 Magazinat – tregtia me shumice

E ndodhur ne pjesen qendrore te Shqiperise, shume prane Durresit dhe aeroportit te Rinasit, duke qene nje pike kryqezimi per rruget baze ekzistuese dhe koridoret kryq Ballkanit qe jane ne ndertim, Tirana, ne terma gjeografik, ka nje pozicion mjaft te mire per t'i sherbyer nevojave te magazinimit. Ky sektor do te mbeshtetet ne veçanti, ne qofte se zona do te kete statusin juridik te zones doganore ose te zones se lire.

VII. 4.5 Sherbimet e biznesit

Sektori i sherbimeve eshte parashikuar te rritet shpejte, i shoqeruar nga zhvillimi i pergjithshem i zones. Nga ana tjeter, ne kete zone eshte verejtur nje rritje e madhe e sasise se zyrave, por qe gjithsesi mbeten te pamjaftueshme. Besohet se nje qender sherbimesh biznesi do te krijoje nje kerkese te madhe per dhenie me qera dhe blerje. duke sjelle nje perftim te madh per zhvilluesin e Parkut Industrial.

VII. 4.6 Perdorime speciale

Besohet se riparimi dhe mirembajtja e makinave, etj., do te jene sherbime te suksesshme ne Parkun Industrial. Sipas disa vleresimeve te peraferta ne kete zone do te punesohen afersisht 200 punonjes.

VII. 5 Kerkesat e Planifikimit

VII.5. 1 Kerkesat e planit per parqet industriale ne pergjithesi

Ne pergjithesi, Parqet Industriale jane krijuar prane zonave urbane dhe prioriteti i tyre i pare eshte qe te zhvillojne industrine e vendit nga pikpamja e nje zhvillimi te qendrueshem dhe mbrojtjes se ambjentit. Distanca midis parqeve industriale dhe ndertesave urbane te qytetit eshte zakonisht mesatarisht 10 km. Megjithate. kjo kerkese buron nga pervoja nderkombetare me teper se nga legjislacioni aktual shqiptar. Dy kerkesat me kryesore qe nje park industrial duhet te plotesoje jane:

• Ai nuk duhet te sjelle shqetesime per funksionimin e qytetit ose te ndote zonen rrethuese. Ne kete menyre. duhet te mbrohet toka nga perdorimi i keq dhe te shfrytezohet ajo ne menyre produktive per perftime te parkut industrial:

• Te kete lehtesi hyrjeje ne infrastrukturen ekzistuese (rrjetin kryesor rrugor. stacionin hekurudhor. aeroport).

Nje park industrial i organizuar mund te permbaje te gjitha aktivitetet qe perfshin industria. manifakturimi. tregtia me shumice dhe zyra te ndryshme. Ne pergjithesi. eshte thelbesore qe te kete nje balance midis zones se okupuar nga industria perpunuese dhe deget e tjera te industrise. Kujdes i veçante zakonisht nevojitet per industrine qe krijon ndotje (industria kimike. e mineraleve. etj.). Per me teper. rrjeti komunal. rruget dhe

hapesirat e lira duhet te zene te pakten 20% te siperfaqes gjithsej. Infrastruktura dhe nevojat komunale perfshijne:

- Rruget;
- Furnizimin me uje;
- Rrjetin e kanaleve te ujrave te zeza dhe te drenazhimit;
- Rrjetin elektrik dhe te telefonave;
- Njesine qendrore te trajtimit biologjik te mbeturinave;
- Laboratorin e kontrollit te ndotjes se mjedisit.

Gjithashtu, Parqet Industriale duhet te kene te vendosura ne qender keto ndertesa:

- Njesine qendrore te perpunimit te te dhenave;
- Qendren e kontrollit te cilesise;
- Ekspoziten e produkteve;
- Mencen e ushqimit;
- Bankat;
- Qendren e ndihmes se pare;
- Ambientet sportive;
- Qendren e edukimit, institutet e kerkimeve, etj.

Zona e propozuar ka sherbim te mire nga rrjeti rrugor ekzistues dhe ai i se ardhmes. Per me teper, ajo ndodhet afer stacionit te trenit dhe lidhet me lehtesi me te ne te ardhmen. Ne argumentat e mesiperm shtojme se zona eshte prane autostrades kombetare dhe ne zonen ne drejtim te aeroportit te Rinasit. Megjithate, zona e dhene ka nje mangesi specifike, sepse ajo eshte gati direkt e ngjitur me ndertimet urbane dhe nuk ploteson distancen e nevojshme prej 10 km, qe normalisht do te nevojitej midis qytetit dhe zones industriale. Ky problem mund te zgjidhet permes krijimit te nje zone te mjaftueshme te gjelberuar pergjate zones dhe gjithashtu edhe vendosja e hyrjes kryesore per ne parkun industrial ne anen e kundert te qytetit. Ne kete menyre, ndertesat urbane nuk do te kene kontakt direkt me parkun industrial. Shtojme se mbrojtja ambjentale urbane kerkon ndertimin e njesise qendrore te trajtimit biologjik te mbeturinave dhe gjithashtu te laboratorit te kontrollit te ndotjes se mjedisit. Njesia e trajtimit biologjik duhet te vendoset ne periferi te zones, ne nje zone qe eshte pergjegjesia e Bashkise qe ta bleje dhe ta zhvilloje.

VII.5.2 Plani i propozuar

Nje plan tregues i parkut industrial te propozuar, ne nje zone prej 50 ha duhet te ndahet ne blloqe. Ne baze te pervojes se huaj, u morr ne shqyrtim nje model, ku zona eshte ndare ne 12 blloqe me permasat e meposhtme:

Blloku 1:	21.800 m^2	Blloku 7:	10.800 m^2
Blloku 2:	46.600 m^2	Blloku 8:	48.100 m^2
Blloku 3:	38.100 m^2	Blloku 9:	36.900 m^2
Blloku 4:	22.300 m^2	Blloku 10:	23.800 m^2
Blloku 5:	25.600 m^2	Blloku 11:	24.600 m^2
Blloku 6:	32.500 m^2	Blloku 12:	18.900 m^2

Siperfaqja gjithsej per shfrytezim eshte 350 mije m^2 keshtu qe siperfaqja e tokes e caktuar per infrastrukture, rruge, gjelberim, etj., eshte150 mije m^2, domethene 30% e siperfaqes gjithsej.

Rregullimet e propozuara per parkun industrial jane:	
Mbulimi i tokes	75% e siperfaqes se tokes
Koeficenti i ndertimit	1 (per biznes: 2.4)
Lartesia maksimale	12 meter
Numri i kateve	3
Distanca minimale nga rruga	10 meter
Distanca minimale nga kufiri	5 meter
Madhesia e tokes per industrine perpunuese	1000 m^2
Madhesia e tokes per dege te tjera te industrise	2000 m^2

Duke marre ne konsiderate elementet e mesiperm mund te arrihet ne perfundimin se keshtu krijohet nje ambjent funksional, i cili pershtatet me realitetin shqiptar dhe projektimin e saj ne te ardhmen e afert. Ekzistenca e hapesirave te gjelbra krijon nje klime te kendshme per banoret lokal si dhe per punonjesit.

Nje ndarje treguese teorike e tokes se perdorur ne parkun industrial eshte:

Industri	23.36 ha (67% e tokes se nevojshme)
SME dhe perdorim special	6.83 ha (19% e tokes se nevojshme)
Magazina	4.41 ha (13% e tokes se nevojshme)
Biznese	0.40 ha (1% e tokes se nevojshme)

Brenda zones se parkut industrial, rruget jane te skicuara ne akset baze me nje gjeresi 15 m. Kjo eshte gjykuar si e mjaftueshme per kamionet e medhenj. Gjithashtu, perdoruesit e parkut industrial mund te perdorin sherbime te tjera si qendren e ndihmes se pare, bankat, ose menca e ushqimit, qe duhet jene ne qender te zones, prane hyrjeve. Ndertesat ku do te kryhen keto perdorime komunale do te jene ngjitur me zyrat e zhvillimit te propozuara per zonen.

VII.5.3 Fazat diskrete te zhvillimit

Duke marre ne konsiderate pasigurine qe mbizoteron ne Shqiperi, zhvillimi i parkut industrial duhet te behet me faza. Ne fakt, faza e pare duhet te optimizoje nevojat e zhvillimit qe te thithe nje pjese te rendesishme te interesave te perdoruesve, te shprehura tashme, drejt ngritjes se nje parku industrial te organizuar, se paku deri ne piken ku te mbrohet aftesia mbijetuese e projekteve. Ne çdo rast, perfshirja e skemes investuese te nje faze te dyte te ndertimit, qe eshte subjekt i nje rivleresimi te proçesit te pergjithshem te projektit, redukton thelbesisht rrezikun qe ndermerr zhvilluesi, ne nje kohe qe lejon zhvendosjen ne kohe te nje pjese te rendesishme te kostos se investimeve totale per te ardhmen.

Keshtu, ky studim propozon qe duhet te skicohet nje Faze e Dyte Ndertimore per programimin e projektit gjate nje aktiviteti 10 vjeçar, nderkohe qe faza e pare i perket ndertimit te 60% te zones se parkut industrial, ndersa zona e perfshire ne fazen e dyte perben 40% te zones se parkut industrial.

VII. 5.4 Kerkesat e infrastruktures teknike

Perdorimet e ardhshme qe do te zhvillohen ne Parkun industrial jane: dege te industrise dhe manifakturim 85%, magazina 10% dhe perdorime speciale 5%, siç jane riparimi i veturave, sherbim, mirembajtje, zyra te qendres se biznesit, punishte, zyra administrative, etj. Perzjerja e degeve te industrise favorizon industrine e lehte ne sektoret e tekstileve, industrise ushqimore, lendeve te para, mobiljeve, plastikes, konstruksione metalike, etj. Ne kete studim eshte trajtuar çeshtja se infrastruktura ekzistuese e Tiranes eshte e papershtatshme per te plotesuar nevojat e zhvillimit te nje Parku Industrial. Ndertimi i nje infrastrukture te pershtatshme dhe i rrjetit komunal ka nje rendesi te madhe per te mbeshtetur kerkesen per investime, veçanerisht ne industri, manifakturim dhe magazina.

Bazuar ne karakteristikat e mesiperme te planifikimit dhe operacionale te nje parku industrial, per nje veprimtari te regullt jane te nevojshme instalimet e meposhtme.

• *Rrjeti hidraulik*

- Kanalizimet e ujrave te zeza. Eshte imperative ndertimi i nje rrjeti te veçante, nje per terheqjen e mbeturinave dhe nje tjeter per rrjedhjen e ujrave siperfaqsore. Rrjeti i propozuar duhet te jete ne perputhje me infrastrukturen ekzistuese te pjeses tjeter te qytetit dhe duhet te jete objekt i nje studimi specifik qe duhet marre ne konsiderate parametrat e nevojshem. Gjatesia e pergjitheshme e vleresuar e rrjetit te tubave kryesore te mbeturinave eshte rreth 6.700m. Nje gjatesi te njejte duhet te kete dhe rrjeti i ujrave siperfaqsore (i drenazhimit). Kosto koresponduese eshte vleresuar per rreth 650 mije EURO, prej se ciles vlera 260 mije EURO i korespondon Fazes se Dyte te Ndertimit.

- Rrjeti i furnizimit me uje eshte imperativ dhe gjatesia e vleresuar e rrjetit te sugjeruar eshte rreth 6.900 m. Ndertimi i tubave respektive (ashtu siç jane ekzaminuar nga studime e duhura) duhet te jete nga materjale te pershtatshme dhe ne perputhje me rekomandimet shkencore ne fuqi. Kosto e investimit eshte vleresuar per 590 mije EURO, prej se ciles 240

mije EURO i perkasin Fazes se Dyte te Ndertimit.

- Rrjeti i mbrojtjes nga zjarri. Eshte i po te njejtes rendesi ndertimi fqinje me parkun i nje rezervuari ujor, me qellim mbrojtjen nga zjarri. Ky instalim dhe rrjeti i nevojshem eshte vleresuar te kete nje kosto prej 300 mije EURO, prej se ciles 100 mije EURO i perkasin Fazes se Dyte te Ndertimit.

• *Rrjetet/Pajisjet elektromekanike*

- Rrjeti i furnizimit me energji elektrike. Nevojat e konsumit te energjise dhe furnizimi i rregullt per aktivitetin dhe zhvillimin e Parkut Industrial presupozojne si nje kusht te nevojshem, ndertimin e nje nenstacioni fuqie elektrike. Kapaciteti i nenstacionit duhet llogaritur ne baze te perdorimeve te ndryshme ne te ardhmen (industrine e lehte, SME, magazina, sherbime te tjera te ndryshme) dhe gjithashtu nga zhvillimi i parashikuar i parkut industrial. Ndriçimi i rrugeve: duhet te behet per çdo 25 m nga te dy anet e rrjetit rrugor Pajisjet respektive te nevojshme qe duhet te instalohen jane:

- Dy transformatore te fuqise nga i larte ne te mesme
- Materiale kontrolli dhe shperndarje
- Rrjeti kabllor i tensionit te mesem 20 kV
- Pesembedhjete kabina transformimi nga tensioni i mesem ne ate te ulet. Ne menyre specifike nga zbarat e tensionit te mesem do te dalin 4 çelsa te tensionit te mesem te mbyllur ne unaze. Çdo çeles do te furnizoje 15 kabina, duke dhene siguri per furnizimin me energji.

Kosto e nenstacionit do te jete 500 mije EURO ndersa kostoja gjithsej e instalimeve elektromekanike do te jete per afersisht 880 mije EURO. Nje pjese e rendesishme e puneve/ instalimeve dhe kosto respektive qe arrin 330 mije EURO mund te zhvendoset per ne Fazen e Dyte te Ndertimit.

- Telekomunikacioni. Plotesimi i kerkeses se parashikuar presupozon zbatimin e nje qendre telefonie te re dixhitale. Pajisjet e nevojshme per te jane:

- Kapaciteti i qendres telefonike do te kete 800 linja;
- rrjet per t'i sherbyer Parkut Industrial;
- pesembedhjete qendra shperndarje telefoni.

Kosto totale per telekomunikacionin do te jete afersisht 260 mije EURO, prej se ciles 60 mije EURO mund te zhvendosen per ne Fazen e Dyte te Ndertimit.

• *Ndertimi i rrugeve* te pershtatshme ka rendesi themelore per te lehtesuar trafikun ne Parkun Industrial. Asfalti i rrugeve te brendeshme dhe trotuaret prej guri duhet te jene ne perputhje me specifikimet per kamionet e rende te mallrave, me qelim qe te plotesojne funksionimin dhe hyrjen e nevojshme per ne zone. Infrastruktura rrugore dhe ndriçimi i rrugeve siguron nje hyrje te pershtatshme te kamioneve te rende te mallrave dhe sigurojne te gjitha lehtesite e nevojshme per shkarkim te sigurt te kamioneve industrial. Kosto respektive e ndertimit per gjatesine e vleresuar prej 7.700 m eshte llogaritur ne 1.180.000 EURO, prej se ciles 480 mije EURO i perket Fazes se Dyte te Ndertimit.

• *Gjelberimi.*

Si prioritet. duhet te ndertohet nje zone e gjelber qe te mbroje ndertimet qytetare ne kufirin e zones. Gjithashtu. gjelberimi duhet te nderthuret ne te gjithe zonen ne perputhje me zhvillimin e parashikuar. Kosto e gjelberimit arrin 60 mije EURO, ndersa 25 mije EURO i korespondojne fazes se Dyte te Ndertimit.

• *Rrethimi*

Rrethimi i zones eshte mjaft i rendesishem. Ai duhet te ndertohet ne perputhje me zhvillimin e parashikuar te Parkut Industrial. Ai kushton 80 mije EURO. ku 30 mije EURO i korespondojne Fazes se Dyte te Ndertimit.

• *Menaxhimi i mbeturinave.* Duhet te ndermerren veprime per grumbullimin e mbeturinave te ngurta dhe per nje skeme te depozitimit. si dhe per infrastrukturen e nevojshme (pika te grumbullimit te mbeturinave. kazane plehrash, zona te depozitimit te mbeturinave). Eshte e rendesishme qe kjo detyre specifike te perfshihet ne nje Skeme Globale te Menaxhimit te Mbeturinave te pershtatur per nje rajon me te gjere. Kosto gjithsej eshte vleresuar per 75 mije EURO. e ndare 45 mije EURO per Fazen e Pare te Ndertimit dhe 30 mije EURO per te dyten.

• *Ndertesa per trajtimin biologjik.* Ndertimi i nje pike per trajtimin biologjik behet i nevojshem, per trajtimin e derdhjeve industriale te prodhuara nga njesite industriale fqinje, me qellim pasjen e nje mjedisi te paster. Nje studim i veçante duhet te ekzaminoje vendndodhjen e kesaj pike, te percaktoje mekanizmin e perdorur per trajtim dhe kerkesat teknike per ndertimin gradual te pikes ne perputhje me fazat e zhvillimit te Parkut. Kjo e fundit eshte konsideruar mjaft e rendesishme per keto arsye:

- te transferoje pjese te kostos se investimit ne te ardhmen;
- te reduktoje koston operative dhe;
- te mbroje veprimin e regullt te pikes se trajtimit biologjik.

Kosto respektive eshte vleresuar ne 600 mije EURO, nderkohe qe 420 mije EURO i korespondojne fazes se pare te ndertimit dhe 180 mije EURO te dytes.

Gjithashtu, skicimi i puneve te propozuara duhet te ekzaminohet, me qellim qe te minimizohen germimet themelore dhe te nxitet venja me e mire e tubave (tubat e ujrave te zeza, te drenazhimit, te furnizimit me uje, te telekomunikacionit dhe te furnizimit me energji elektrike).

VII. 6 Rezultatet

VII.6.1 Perftimet ekonomike dhe sociale te zones

Perftimet ekonomike te zones nuk duhet te shihen ne nje menyre strikte (dmth ne terma te perftimeve financiare). Ne vleresimin e perftimeve me mire do te ishte te behej nje vleresim socio-ekonomik i perftimeve qe do te kishte zona nga krijimi i Parkut Industrial.

A. Perftimet nga faza e ndertimit

• Faza fillestare e ndertimit

- Ne punesim: Kosto totale e investimit (6.6 milione EURO) permban koston komunale qe perfshin: infrastrukturen teknike, gjelberimin, rethimin dhe ndertesat administrative dhe mbeshtetese. Per fazen filestare te ndertimit, kosto respektive eshte vleresuar per 4.2 milione EURO. Vlera e shtuar lokale eshte vleresuar te arrije 1.5 milione EURO (rreth 35% te shume gjithsej). Duke pritur, standart i arsyeshem per kushtet shqiptare, se nje puntori i korespondon nje kostoje investimi, per infrastrukturen ekonomike dhe teknike, prej 40 mije EURO, atehere eshte vleresuar se faza e zhvillimit fillestar do te gjeneroje nje punesim per 40 njerez-vite.

- Ne te ardhura. Duke supozuar se prirja per te kursyer, per kete rajon, nuk i kalon 20%. atehere multiplikatori i perafert i te ardhurave eshte llogaritur ne nivelin 5. Keshtu, ne afatin e mesem, efekti i multiplikatorit ne prodhim do te arrij vleren 7.5 milione EURO.

• Faza e dyte e ndertimit

Kosto totale e investimit per fazen e dyte te ndertimit eshte vleresuar per 2.4 milione EURO. Bazuar ne supozimet e mesiperme, ndikimi relativ ne punesim eshte vleresuar per 23 njerez vite. ndersa efekti multiplikator ne te ardhura eshte vleresuar per 4.3 milione EURO.

B. Perftime nga faza e aktivitetit

Eshte llogaritur se ne Parkun Industrial, ne nje afat te gjate, do te veprojne rreth 150 ndermarrje qe do te kene nje ndarje te tille: 16 ndermarrje industriale, 26 SME, 8 firma tregti me shumice, 50 firma qe ofrojne sherbime biznesi, te tjera rreth 45 firma.

Pritet qe perveç terheqjes per arsye te zhvillimit te rregullt te parashikuar te Parkut Industrial, permes krijimit te lehtesirave te infrastruktures, sigurise, lehtesira veprimtarie etj., ai do te luaje nje rol te rendesishem ne gjenerimin e zhvillimit industrial te rajonit. Ky avantazh i rendesishem ne krahasim me rajonet e tjera, pritet qe te veproje si nje pol atraksioni per zhvillimin industrial ne dy drejtime:

- Si force e brendshme invesuese ne rajon dhe ne pergjithesi ne Shqiperi;
- Rritje te kerkesave per investime te huaja.

Ne pergjithesi, eshte pranuar nje supozim teorik se 30% e zhvillimit industrial te projektuar do te gjenerohet si pasoje e ekzistences se Parkut Industrial.

Punesimi i parashikuar per tu realizuar ne Parkun Industrial (te gjithe sektoret) eshte vleresuar per 2.000 persona. Ne perputhje me sa mesiper, 30% e tij ka te beje me punesimin e induktuar. Prodhimi industrial ne periudhen afatgjate pritet te rritet nga 12% e GDP ne 20%.

Pritet qe, te pakten 30% e tij do te perqendrohet ne Parkun Industrial. Ne perputhje me analizat e mesiperme, te pakten 10% e prodhimit shtese do t'i atribohet ekzistences se Parkut Industrial.

C. Efektet anesore

Rritja e prodhimit ne sektorin industrial do te veproje si nje shtytes i fuqishem per zhvillimin e pergjithshem te rajonit. Ne menyre specifike:

- Lidhjet me mjedisin, permes sektorit primar (d.m.th. bujqesise dhe burimet natyrore), do te forcohen, duke ushtruar nje presion te fuqishem per modernizimin e tyre;
- Padyshim qe do te shfaqen efekte pozitive ne tregti dhe ne sherbime;
- Rritja e konsumit do te gjeneroje zhvillim te ri per te kenaqur nevojat e reja. Ky efekt multiplikator pritet te jete shume i madh, perderisa modeli i konsumit ne kete faze te zhvillimit te Shqiperise eshte i orjentuar drejt mallrave baze;
- Krijimi i Parkut Industrial presupozon permiresimin e rrjetit te infrastruktures komunale. Kjo do te sjelle gjithashtu, nxitjen dhe permiresimin e infrastruktures se qyteti dhe te rajonit;
- Nuk duhet te nenvleftesohen çeshtje te tilla si transferimi i teknologjise dhe kembimet, rritja e mobiliteteve dhe zhvillimi i turizmit profesional;
- Perqendrimi i parashikuar i industrise me parkun Industrial, qe vepron ne kushtet e rrepta te regullave te urbanistikes dhe te kushteve te mjedisit, do te mbaj nen kontroll fenomenin e nderthurjes industriale, duke patur nje efekt mjaft pozitiv ne mjedis;
- Se fundi, problemet fiskale duhet te konsiderohen te rendesishme. Te ardhurat e bashkise nga zhvillimi i tokes do te jene te rendesishme, pavaresisht nga marreveshja perfundimtare midis autoriteteve lokale dhe zhvilluesit. Ketu duhet te shtohen edhe te ardhurat potenciale qe do te grumbullohen nga bashkia, permes pjesemarrjes se mundshme ne skemen e aktivitetit.

VIII. MBIJETESA EKONOMIKE E PARKUT INDUSTRIAL

VIII. 1 Koncepti i Pergjithshem i Biznesit

A. Fusha e veprimtarise

Parku industrial duhet te krijohet, organizohet dhe veproje ne kushtet e mjedisit krahasues dhe sipas kriterit te efiçenses se biznesit privat. Keshtu, zhvillimi i tokes duhet te ndermerret sipas nje skeme zhvillimi te kualifikuar, me qellim nje fitim te bollshem.

B. Pjesmarresit

Sipas percaktimit, lojtaret kryesore te perfshire ne kete detyre jane:

• Pronaret e tokes (shites, dhenes me qera ose caktues te tokes per zhvillim). Pronaret mund te marrin pjese ne skemen e zhvillimit.

• Zhvilluesi ndermer skicimin e planifikimit urban dhe te punimeve te ndertimit te infrastruktures dhe te superstruktures. Nje alternative tjeter eshte qe ekzekutimi i punimeve te ndertimit mund te nenkontraktohet me kompani te specializuara ndertimore. Gjithashtu, zhvilluesi ka pergjegjesine e administrimit te pergjithshem dhe te marketingut per Parkun industrial. Ne menyre alternative, ai mund te nenkontraktoje, jap me qera ose te shese tek te tretet, te drejten e kryerjes se nje sere sherbimesh (plotesisht ose pjeserisht).

• End-user[1]. Blen ose mer me qera toke dhe ndertesa. Sipas nevojave te veta ai perdor produkte ose sherbime te ndryshme. Gjthashtu, si end-users konsiderohen ente qe kryejne nje sere sherbimesh (te nenkontraktuara nga zhvilluesi) per ndermarrjet dhe per individet qe punojne ne Parkun Industrial. Te gjithe end-users qe kane blere ose kane marr me qera ndertesa ose toke, do te zoterojne aksione pronesie ne hapesirat e zakonshme te perdorimit dhe te drejat e aksionereve ndaj menaxhereve te prones.

• Financuesi siguron finacimin afatshkurter dhe afatgjate si per zhvilluesin, ashtu edhe per end-users. Gjithashtu, ai mund te marr pjese ne skemen e investimit, si aksioneri kryesor.

C. Hapat Kryesore:

• *Kontributi ne toke per Parkun industrial*

Toka e caktuar eshte 50 ha, qe mund te kete pjese prone publike dhe pjese prone private. ku duhet te behet shpronesimi. Zona e identifikuar duhet te jepet si kontribut i shtetit ne projekt. Sipas legjislacionit shqiptar, mundesite alternative te kontributit te tokes jane si me poshte:

- Bashkia ia shet token skemes se zhvillimit qe do te realizoje zhvillimin e Parkut Industrial;

- Bashkia ia jep zhvilluesit token me qera per nje periudhe nga 30 ne 99 vjet. Zhvilluesi gezon te drejten e qeramarrjes dhe perdorimit per te njejten periudhe;

- Bashkia proçedon per nje marreveshje koncesioni me zhvilluesin, marreveshje me terma te pranueshme per te dy palet.

• *Zgjedhja e zhvilluesit.* Skema e zhvillimit e permendur me siper do te realizohet nga kryerja e nje tenderi nderkombetar, i organizuar nga Bashkia e Tiranes me mbikqyres autoritetet shqiptare. Per plotesimin me sukses te te gjithe proçesit eshte i domosdoshem caktimi i nje keshilltari per skicimin e skemes, pergatitjen e dokumentave te tenderit etj.

• *Pergatitja e projektit.* Zhvilluesi do te proçedoje ne realizimin e negociatave me financues potencial, si pjesemarres kryesor dhe perdorues te tjere perfundimtar, ndermarrje aktive dhe te sherbimit me qellim qe te siguroje kushtet dhe termat e nevojshem per financimin dhe aktivitetin e Parkut Industrial. Ky hap duhet te konsiderohet si shume i rendesishem. Investitoret pjesmarres ne skeme nuk do proçedojne ne zbatimin e projektit, pa qene te sigurte ne kthimin

[1] *Perdoruesi perfundimtar*

maksimal qe investimit te tyre, per nje periudhe minimale kohe. Ne vende si Shqiperia, me rrezik te rritur politik dhe te sipermarrjes, prioriteti i pare per skemat nderkombetare te investimit eshte minimizimi i pasigurise se biznesit. Gjate ketyre negociatave, zhvilluesi duhet te vleresoje avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve alternative ne lidhje me çeshtje te tilla si finacimi i projektit, pjesmarresit anchors, strukturen e mjeteve dhe maksimizimin e subvencioneve qe do te arrije per aktivitetin dhe berjen e projektit fitimprures.

• *Zhvillimi i projektit.* Pasi ka nenshkruar marreveshjet e para te kushteve me te gjitha palet e permendura me siper, zhvilluesi duhet te urbanizoje token e dhene per kete qellim, duke respektuar profilin e zones dhe regullimet urbanistike te pozuara nga autoritetet lokale dhe qendrore. Me tej, ai do te proçedoje ne zbatimin e Programit te investimeve, duke iu permbajtur nje sere punimesh infrastrukture dhe superstrukture.

VIII. 2 Analiza e Aftesise Mbijetuese: Komente Metodologjike

Analiza e aftesise mbijetuese ka per qellim te investigoje termat nen te cilet zhvillimi i Parkut Industrial do te kete perftime. Faktoret baze per kete qellim jane:

• Statusi juridik i Parkut Industrial;
• Struktura e mjeteve te veta;
• Perftimi i çmimit te tokes;
• Sherbimet e ofruara;
• Kosto e ndertimit, etj.

Ne lidhje me çeshtjet e mesiperme, zhvilluesi do te kete nje sere alternativash dhe mundesish. Eshte e qarte se analizat nuk mund te perfshijne te gjitha keto alternativa. Keshtu, ne vazhdim jepet nje skenar baze. Analiza e aftesise mbijetuese eshte bazuar ne hapat ne vazhdim:

• Vleresimi i kostos se zhvillimit dhe i skemes se financimit, duke patur avantazhet e mundesive te finacimit te jashtem;
• Adoptimi i supozimeve ne te cilat do te bazohen projeksionet ekonomike te projektit;
• Perpunimi i moduleve te te ardhurave dhe shpenzimeve te projektit dhe vleresimi i treguesve te qarkullimit dhe te normes se efiçenses;
• Perpunimi i skenareve alternative te aftesise mbijetuese te projektit;
• Paraqitja e perfundimeve te analizave te permendura me siper, duke e vene theksin ne çeshtjet themelore te politikes per te arritur nje veprimtari te suksesshme te projektit.

VIII.2.1 Statusi ligjor i Parkut Industrial dhe sherbimet e ofruara

Ne studimin tone eshte pranuar zhvillimi i zones me statusin juridik te Parkut Industrial. Megjithate, siç eshte permendur, dy mundesite e tjera kane nje interes te veçante dhe ato duhet te analizohen me kujdes nga ana e zhvilluesit.

A. Sherbimet kryesore te ofruara perfshijne:

• Ndertimi i ndertesave te reja industriale per prodhim dhe i magazinave ne emer te perdoruesit perfundimtar. Ky aktivitet perben detyren kryesore dhe prioritetin e skemes se zhvillimit. Çdo ndertese industriale, manifakture dhe magazine do te vendoset ne nje pozicion te veçante, te ndertuara sipas skemes se zhvillimit duke u bere perftimi kryesor i ndertimit. Gjithashtu, skema e zgjedhur e zhvillimit duhet te jete cilesore, me qellim kenaqjen e nevojave te nje programi ndertimi te nje superstrukture ekstensive. Nuk duhet te perjashtohen alternativat e nenkontraktimit te ndertimit te ndertesave industriale nga arsyetimi i uljes te perftimit nga ndertimi.

• Shitja e parcelave per perdorim industrial, manifakturimi dhe magazinimi, qe te zhvillohen nga perdoruesi, sipas rregullave te planifikimit urban, te pozuara ne Master Planin e Parkut Industrial. Parcelat do te shiten direkt nga skema e zhvillimit tek perdoruesi i tyre perfundimtar. Nuk duhet te perjashtohen rastet e qeradhenies afatgjate, por per arsye thjeshtesie ato nuk jane perfshire ne analize.

• Dhenia me qera e hapesirave te veçanta per industrine e lehte, nga pjeset e ndertesave per perdorim manifakturimi. Keto ndertesa do te ndertohen mbasi te jene fituar nje minimum

kontratash per dhenie me qera dhe blerje ne te ardhmen. Praktika e shitjeve nuk duhet te perjashtohet, por ato nuk jane perfshire ne analize.

• Dhenia me qera e hapesirave te veçanta per tu perdorur si zyra eshte pjese e nje qendre sherbimesh biznesi. Kjo qender do te ndertohet sipas parakontratave te perftuara per dhenie me qera ose blerje ne te ardhmen. Nuk jane perjashtuar praktikat e shitjes, por ato nuk jane perfshire ne analize.

B. Sherbimet komunale

• Furnizimi me energji elektrike, instalimet e trajtimit biologjik, grumbullimi dhe depozitimi i menaxhuar i mbeturinave, mbrojtja nga zjarri, etj. Skema e zhvillimit do te realizoje ndertimin e te gjithe instalimeve te nevojshme dhe furnizimin me paisjet perkatese.

• Sherbimi i kujdesit social (infermjeria, kujdesi mjeksor, etj.)

Te gjitha sherbimet e mesiperme konsiderohen si sherbime pa fitim (reciproke).

C. Skema te ndryshme sherbimesh perfshijne:

• Sherbime te mbeshtetjes teknike;
• Sherbime transporti;
• Sherbime te sigurise;
• Sherbime financiare dhe manaxheriale.

Zhvilluesi duhet t'i siguroje keto sherbime ne menyre te drejtperdrejte ose t'i nekontraktoje ato nga te trete. Edhe keto sherbime trajtohen gjate analizave si sherbime reciproke.

IX. INTEGRIMI I ZONAVE SATELITE PERRETH QYTETIT TE TIRANES

Kjo pjese e materialit fokusohet ne mundesite reale te integrimit te zonave suburbane perreth kryeqytetit ne ritmet e mundshme te jeteses se kryeqytetit dhe gjithashtu ne nevojen e pergatitjes se plan-veprime qe duhet te ndermerren ne menyre te menjehershme ne lidhje me zhvillimin e infrastruktures dhe zhvillimin afatgjate ekonomik dhe social te ketyre zonave. Ne studimin e zonave satelite eshte patur parasysh:

- Studimi i ndryshimeve demografike te tyre, sidomos ne 10 vjeçarin e fundit;
- Studimi i situates demoekonomike dhe i infrastruktures ekzistuese;
- Studimi i gjendjes dhe i problemeve te institucioneve arsimore, shendetsore dhe kulturore ne keto zona;
- Studimi i mundesive te zhvillimit ekonomik te ketyre zonave dhe integrimin e tyre ne jeten e kryeqytetit;
- Dhenja e disa rekomandimeve te pergjithshme per planin regullues te zones si dhe per integrim ne jeten e kryeqytetit.

Ne kushte e burimeve te limituara te kohes, analiza u bazua ne studimin e zones se Kamzes, zone e cila ploteson dy kushte per tu marre si zone pilot: ajo eshte krijuar qe gjate periudhes se sistemit komunist dhe ka nje zgjerim mjaft te madh ne keto 10 vjet te tranzicionit.

IX.1 Situata Aktuale

- *Pozicioni gjeografik.* Kamza eshte nje zone suburbane prane Tiranes, me pamje te nje zone tradicionale satelite, kryesisht bujqesore dhe e pazhvilluar, papunesi te larte dhe me infrastrukturen te pazhvilluar. Duke qene nje zone e krijuar dhe e konsoliduar me shume vite me pare, si dhe duke patur si fenomen baze rritjen dhe rendimin e numrit te problemeve te kultivuara qe gjate periudhes komuniste, mund te thuhet se kemi te bejme me nje zone model te plote dhe te vlefshme per nje studim qe mund te jete nje pergjithesim me i gjere.

Krijimi i vendbanimeve te reja perreth saj ka bere qe tashme Kamza ne vetvehte te konsiderohet si nje pol qendror per mundesite e zhvillimit te vendbanimeve te reja perreth saj, si Bregu i Lumit, Bathorja e me gjere. Pra, ne e konsiderojme Kamzen si nje pol zhvillimi ne rrethin e Tiranes, e cila ka krijuar rreth vetes nenpole te tjera.

- *Mjedisi biologjik.* Zona eshte nje mjedis kryesisht bujqesor dhe blegtoral, e shquar per potencial te larte zhvillimi ne bujqesi e blegtori edhe per shkak te perqendrimit te larte te specialisteve te ketyre fushave, qe kane punuar dhe punojne ne Universitetin e Kamzes, qe per Shqiperine ka qene dhe mbetet nje universitet me tradita.

Popullsia e zones perbehet nga pak banore autoktone dhe mbi te gjitha nga familje te shperngulura kryesisht nga zonat rurale (me teper nga zonat rurale te veriut), por te vendosura ketu si gjate regjimit komunist, per arsye te pamundesise per tu vendosur ne Tirane, dhe nga familje qe kane migruar gjate ketij dhjetevjeçari. Ne kushtet aktuale, kjo qender suburbane paraqet mjaft probleme si me sistemin arsiomor dhe me ate shendetesor ambulator dhe spitalor.

- *Vleresimi i shkurter i infrastruktures teknike.* Duke qene se Kamza shtrihet ne aksin e rruges qendrore qe lidh Tiranen me veriun e Shqiperise, ajo ka nje lidhje te mire dhe te mjaftueshme rrugore, e cila i rrit mundesite e zhvillimit. Rruget ne sistemin e qytetit jane ne kushte shume te keqia. Qarkullimi eshte shume i veshtire dhe ne shume raste i rezikshem. Por, duhet theksuar se cilesia e keqe eshte jo vetem ne rruget e brendshme, por edhe ne sektorin e rruges nacionale qe shtrihet brenda territorit te Kamzes.

Ashtu si edhe ne qytete te tjera, problem perben e gjithe infrastruktura teknike duke filluar

nga sistemi i furnizimit me uje te pijshem, kanalizimit e ujrave te zeza, dhe depozitimi dhe grumbullimi i mbeturinave urbane te ngutra. Gjithashtu, problem mbetet dhe rrjeti i furnizimit me energji elektrike si dhe rrjeti telefonik. Brenda kufijve te qytetit gjate dites ka mjaft nderprerje te furnizimit me energji elektrike, veçanerisht gjate periudhes se kohes kur kerkesa eshte e madhe (ne periudhen e dimrit, sidomos heret ne mengjes dhe ne mbremje). Furnizimi i qytetit me energji elektrike behet nga nje rrjet me paisje te amortizuara, te paafta qe te plotesojne nevojat e qytetit. Ndriçimi i keq i rrugeve krijon probleme te ndryshme per zonen. Rrjeti telefonik eshte i pamjaftueshem per plotesimin e nevojave. Kjo zone ka mungese te ujit te pishem. Shumica e tubacioneve te sistemit te furnizimit me uje jane te vjetra dhe jo ne kushte te mira. Furnizimi ditor nderpritet shpesh, veçanerisht gjate oreve kur kerkesa eshte e madhe. Rrjeti i pastrimit te mbeturinave nuk ekziston. Rezultati kryesor eshte qe mbeturinat e ngurta dhe te lengshem hidhen ne natyre, duke ndotur mjaft ambjentin. Ne kete zone nuk ka ndonje impjant trajtimi te mbeturinave ujore.

IX.2 Prirja e Parashikuar e Zhvillimit

A. Mundesi per zhvillimin e infrastruktures.

Lidhur me kete çeshtje duhet theksuar se projektet e ndryshme infrastrukturore nuk duhen pare te shkeputura nga zonat satelite te saj, por ato duhet te jene te perbashketa. Duhet te merren ne konsiderate te gjitha mundesite per zhvillimin e infrastruktures se kesaj zone, nepermjet vleresimeve te bera nga specialiste te sektoreve perkates, te cilet jo vetem do te japin mundesite e zhvillimit, por te shoqeruara keto edhe me nje vleresim te kostove perkatese.

B. Mundesite e zhvillimit te biznesit. Zona ofron mundesi te medha per zhvillimin e biznesit agrar dhe ate industrial, sidomos ne fushen e perpunimit te produkteve bujqesore, pa lene pas dore biznesin tregtar. Duhet te ndiqen politika te caktuara per integrimin e bizneseve lokale ne rrjedhen e biznesit te kryeqytetit.

Modeli i perdorimit te tokes duhet te behet i studjuar dhe i bazuar ne gjendjen atuale dhe ne mundesite e ardhjeve migruese dhe te rritjes natyrore te popullsise.

C. Propozime per veprime te menjehershme

- **Duhet qe te percaktohen nevojat me urgjente te zones dhe te jepen mendime konkrete per mundesite e plotesimit te tyre. Caktimi i prioritetit te nevojave, sipas gjendjes konkrete perparesise logjike te plotesimit te tyre per nje zhvillim sa me te shpejte dhe per te integruar zonen me kryeqytetin, duhet qe te shoqerohet me percaktimin e planit te veprimeve qe do te propozohen per tu realizuar.**
- **Sipas mendimit tone, veprimet qe duhet te ndermerren gjate nje periudhe te shkurter per integrimin e zonave te tilla ne jeten e Tiranes jane te renditura me poshte:**
  - ***Planet e Veprimeve te Menjehereshme,* me qellim permiresimin e situates ekzistuese te ambjentit nepermjet pastrimit sistematik te mbeturinave te ngurta dhe te lengshme dhe gjithashtu restaurimi (perteritja) e infrastruktures baze siç eshte elektriciteti, furnizimi me uje, telekomunikacioni, drenazhimit, rrugekalimeve, kalimeve te kembesore, ndriçimin e rrugeve etj. Keto plane do te perfshijne prirjen social-ekonomike per te parashikuar kapacitetin e nevojshem te infrastruktures se propozuar dhe mundesite e integrimit te saj ne rrjedhen e kryeqytetit; pershkrimin e detajuar te veprimeve duke perfshire justifikimin e zgjedhjeve te bera, perftimet direkte/indirekte per zonen si dhe burimet potenciale te financimit te zbatimit te projektit**
  - ***Planet e Zhvillimit* perfshijne ekzaminimin e potencialit te tregut, te mundesive per biznes si dhe te interesave te investitoreve per nje sere projektesh zhvillimi; pershkrimin e detajuar te veprimeve te zgjedhura duke perfshire justifikimin e zgjedhjes se bere dhe perftimet socialekonomike si dhe ndikimin ne ambjent; vleresimin e perafert te buxhetit te nevojshem per zbatimin e çdo projekti zhvillimi; vleresime te pergjithshme te ndikimit te projekteve te propozuara ne zhvillim si dhe percaktimin e burimeve te mundshme te financimit.**

X. VENDI DHE ROLI I QEVERISE VENDORE NE ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL

Proçesi i tranzicionit te vendeve te Europes Qendrore dhe Lindore, perfshire edhe Shqiperine, drejt nje demokracie politike dhe ekonomise se tregut, po tregon se shtrati i arritjeve, por edhe i pengesave, vonesave dhe gjithe dukurive negative qe e shoqerojne tranzicionin lidhet me nje nyje themelore, ne lakun e te cilit qendron shteti, pjese e te cilit eshte edhe pushteti vendor. Dhe kjo eshte e natyrshme, perderisa nga shteti momentalisht priten dy gjera:

Se pari, ai duhet te ndryshoje vetveten. Veshtiresia eshte e qarte, teper e madhe.

Se dyti, ai duhet te ndryshoje gjithe sistemin shoqeror e ne rradhe te pare ate ekonomik. Sado i terthorte dhe modest te jete roli ekonomik i shtetit ne nje ekonomi te mirefillte tregu, strukturimi i kesaj ekonomie mund te behet vetem nga shteti dhe me ndihmen e tij.

Pavaresisht nga roli qe duhet te luaje shteti ne nje ekonomi tregu te mirefillte, tranzicioni drejt kesaj ekonomie e vendos shtetin ne qender te ketij proçesi. E gjithe ecuria e tranzicionit varet, nder te tjera, nga dy faktore kryesore: *nga qendrimi i shtetit ndaj ketij tranzicioni dhe nga qendrimi i shoqerise ndaj shtetit.* Mozaiku i qendrimit ndaj shtetit ne shoqerine tone eshte shumepermasor, shumengjyresh, duke reflektuar edhe mozaikun e interesave te grupeve te ndryshme shoqerore, te cilat ne fund te fundit kane lidhje te drejtperdrejte me zhvillimin ekonomik te vendit ne teresi, por radhe me zhvillimin ekonomik te rajonit per nje komunitet te caktuar.

Para çdo shoqerije shtrohet per zgjidhje nje problem ekonomik themelor, problemi i shperndarjes se burimeve te kufizuara ndaj nevojave te pakufizuara te njerezve. Ne kuadrin e ketij problemi themelor, shoqeria duhet t'u jape zgjidhje çeshtjeve te tilla si: çfare te prodhohet, si te prodhohet dhe per ke te prodhohet? Te gjitha keto jane te lidhura dhe te kushtezuara nga zhvillimi ekonomik. Sistemi qe lame pas, zgjidhjen e problemit te siperm, por edhe te çeshtjeve qe lidhen me te, ia besonte teresisht qeverise dhe organeve te pushtetit vendor. Tashme eshte provuar, jo vetem ne teori, por edhe ne praktike inefiçensa e ketij sistemi ekonomik.

Ndersa ne nje sistem te bazuar ne nje ekonomi tregu, pergjegjesia e zgjidhjes kalon nga shteti tek vete tregu. Tregu, me forcat e tij ekonomike, sidomos me mekanizmin e çmimeve, luan nje rol vendimtar ne shperndarjen e burimeve. Konkurrenca i detyron prodhuesit e produkteve/ sherbimeve te kerkojne rruge me te pershtatshme teknologjike e organizative per uljne e shpenzimeve ne menyre qe te rritin fitimet dhe te zgjerojne veprimtarine.

Megjithate, roli vendimtar i tregut nuk perjashton, perkundrazi presupozon nje rol te rendesishem ne ekonomi, ne shperndarjen e burimeve.

Funksionet kryesore ekonomike te shtetit, perfshi edhe pushtetin vendor ne nje ekonomi tregu, mund te permblidhen:

-krijimi dhe jetesimi i nje kuadri te nevojshmem ligjor per ekonominе e tregut

-nderhyrja ne shperndarjen e burimeve per te permiresuar eficensen ekonomike

-hartimi dhe zbatimi i politikave stabilizuese makro e mikro-ekonomike

-hartimin dhe zbatimin e programeve per rishperndarjen e te ardhurave ne dobi te grupeve te caktuara shoqerore.

Rruget kryesore te nderhyrjes se shtetit ne ekonomi per realizimin e funksioneve te siperme mund te permblidhen:

• Taksimi - shteti perdor taksimin per te ndikuar ne shperndarjen e te ardhurave dhe per te siguruar fondet e nevojshme buxhetore.

• Shpenzimet publike. Shteti kryen shpenzime te caktuara qe synojne ne nxitjen e firmave per te prodhuar lloje te caktuara mallrash e sherbimesh ne financimin e nje sere aktivitetesh publike, mbeshtetjen e shtresave te caktuara te popullsise.

• Politikat antitrust. Shteti duke mos lejuar krijimin ne dege te caktuara te strukturave monopolistike synon nxitjen e strukturave konkurrente te tregut.

• Politikat rregulluese. Permes masash te caktuara shteti synon rregullimin e sjelljes se firmave lidhur me çmimin, prodhimin, kushtet e punes etj.

• Politikat monetare, valutore te te ardhurave, etj. Tipar karakteristik i nderhyrjes se shtetit ne nje ekonomi tregu eshte se ai priret te perdore kryesisht metoda te ndermjetme, te terthorta dhe jo te drejperdrejta, ne perpjekje per te vepruar me leva te pranueshme nga tregu, sipas ligjeve ne fuqi.

Pushteti vendor, si pjese perberese dhe hallka baze e pushtetit shteteror, ka rol te pazevendesueshem ne qeverisjen teresore te vendit, ne kete kuader edhe ne zhvillimin ekonomik rajonal.

X. 1 Decentralizimi i Metejshem i Pushtetit Vendor dhe Riorganizimi i tij per Rajonin e Tiranes

Qeverisja vendore ne Shqiperi, perpara viteve 90, ne thelb ishte nje qeverisje e dekoncentruar me organe te kufizuara vetqeverisese brenda kuadrit te nje sistemi vendimmarres thellesisht te centralizuar, qeverisje kjo e ngarkuar per menaxhimin e zbatimit te planeve ekonomike te detajuara te qeverise.

Rajoni i Tiranes, vitet e fundit te sistemit te kaluar administrohej nga Komiteti Ekzekutiv i qytetit te Tiranes dhe Komiteti Ekzekutiv i K.P. te rrethit te Tiranes. Qyteti i Tiranes ishte i ndare ne 3 rajone qe vareshin nga Komiteti Ekzekutiv i qytetit te Tiranes dhe ne varesi te secilit rajon kishte disa keshilla lagjesh. Rrethi i Tiranes administrohej nga nje rajon me vete dhe kishte varesi qytetet e Kamzes, Vores, Krrabes si dhe 181 fshatra.

Ndryshimi i sistemit politik, ekonomik dhe social do te kerkonte domosdoshmerisht edhe ndryshime ne organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Ne vitet '90 sistemi u orientua drejt nje modeli me te decentralizuar dhe qeverisje autonome vendore. Baza ligjore e ketyre ndryshimeve u bene dispozitat kryesore kushtetuese. Ne kete kohe, gusht 92, ne baze te ligjit Nr. 7572 date 3.6.1992 *"Per organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal"* u u krijuan qeveri vendore. Ne fakt, reforma e vitit 1992 ngriti per here te pare qeverite vendore. Kjo gjykohet si nje arritje e rendesishme. Pushtetit vendor iu kaluan disa nga sherbimet dhe funksionet me perfitim te drejtperdrejte per publikun, se bashku me me shume autonomi administrative dhe financiare. Megjithate, perkundrejt qendrueshmerise se autonomise politike, autonomia fiskale dhe administrative mbetet e kufizuar.

Parimi kryesor i ndarjes administrative eshte qe ajo t'i sherbeje afrimit te pushtetit me banoret e juridiksionit perkates qe problemet jetesore te zgjidhen atje ku lindin. Ndarja administrative dhe pushteti vendor i rajonit te Tiranes ka qene objekt i ligjeve teresore ne shkalle vendi. Nuk ka pasur ndonje ligj te veçante per organizimin e pushtetit lokal te qytetit te Tiranes ndonese nje varg faktoresh social-politike, ekonomike dhe demografike e diktojne nje gje te tille. Ndryshimi kryesor strukturor i reformes qe pervijimi i rolit te te dy niveleve te qeverisjes vendore:

• Bashkive/komunave iu shtuan funksionet si organe te nivelit te pare te qeverisjes me pergjegjesi te drejtperdrejte dhe me me shume autoritet;

• Keshilli i rrethit u pervijua si nje organ me rol me shume koordinativ.

Ne zbatim te ligjit Nr. 4605 date 15.02.1992 *"Per ndarjen ne Bashki e Komuna dhe organizimin e funksionimin e Bashkise se Tiranes"*, kesaj te fundit i atribohen edhe kompetencat e rretheve. Aktualisht rajoni i Tiranes administrohet:

• Bashkia e Tiranes, me 11 njesi administrative ne varesi

• Rrethi i Tiranes, ne varesi te te cilit jane 3 qytetet Vore, Krrabe, Kamez dhe 18 komuna me 181 fshatra

Hapat e bere konsiderohen te pamjaftueshem per te arritur standartet e njohura demokratike te vetqeverisjes vendore lokale europiane - madje mund te thuhet se suprimimi i rajoneve dhe keshillave te lagjeve ishin masa me karakter centralizues; keto ishin hapa prapa, rrjedhim i te cilave jane verejtur nje varg shkeljesh ligjore gati ne te gjitha fushat ne keto vite te periudhes

se tranzicionit

Madhesia e kompetencave te duhura qendrave administrative dhe realizimi i kompetencave nga Bashkia e Tiranes veshtireson zgjidhjen e problemeve thelbesore te disa qindra mije banoreve, e largon popullin nga pushteti, i ben ata te painteresuar per vendimet qe merren, pa folur per interesimin per problemet rrenjesore te zhvillimit ekonomik te rajonit. Tirana aktualisht ka 45 keshilltare, pra 1 per çdo 15-20 mije banore. Pervoja e viteve te fundit vertetoi se organizimi i pushtetit vendor per Tiranen nuk i pergjigjet kerkesave qe shtrohen aktualsiht dhe ne perspektive.

Tirana, tani nje qytet me veçori e permasa europiane, duhet te qeveriset sipas standarteve europiane. Shfrytezimi i pervojes se viteve te demokracise, evidentimi i arritjeve, shmangia e mangesive dhe pershtatja e pervojes se huaj ne kete fushe, duhet te jene objektivat kryesore te ketij organizmi, ne menyre qe te rritet efektiviteti i drejtimit te rajonit ne teresi dhe ne kete kuader te zhvillimit ekonomik te tij.

Aktualisht, si organ pushteti vendor Tirana ka vetem Bashkine, e cila ne nje variant me tre nivele do te luante me teper nje rol koordinues me nje numer te kufizuar punonjesish. Ndarja e nje qyteti ne bashki apo rajone nuk eshte pervoje shqiptare, me teper eshte nje pervoje e huaj, madje perben nje rregull te pergjithshem europian. Drejtimi i qyteteve me madhesi te perafert me Tiranen, pa folur per qytete te medha, jane te organizuara ne disa bashki, rajone apo distrikte. Konkretisht, Parisi administrohet krahas Bashkise se Parisit edhe nga 23 bashki te rajoneve te tij; Stambolli ndahet ne 49 bashki te vogla; Vjena ndahet ne 23 bashki te vogla me nga 75-80 mije banore; dhe keshtu me radhe Praga, Budapesti, Athina, Beogradi, Anover etj. Riga kryeqytet i Letonise me madhesi te perafert me Tiranen, ndahet ne 6 distrikte, pra funksionon Keshilli i Riges dhe pushtetet vendore te distrikteve, ku secili ka kryetarin, organet ekzekutive respektive si dhe buxhet relativisht te pavarur[1]. Madje per te koordinuar punen per zgjidhjen e problemeve te perbashketa te Qytetit funksionon edhe Dhoma e Riges me 60 perfaqesues, 30 nga keshillat e distrikteve dhe 30 nga keshilli i Qytetit.

Pervoja Europiane e boterore, si dhe ajo e vete Bashkise se Tiranes jane argumente te mjaftueshme per te ndermarre nje hap per riorganizimin e pushtetit vendor te qytetit te Tiranes dhe rajonit te saj. Duke qene se kete vit zhvillohen zgjedhjet pushtetit vendor, eshte rasti me i mire qe te zgjidhet menyra e organizimit dhe te funksionimit te pushtetit vendor te qytetit dhe rajonit te Tiranes.

Njohes te pushtetit ne teresi, dhe te qytetit te Tiranes ne veçanti, gjykojne qe pushteti vendor ne Tirane te jete ne tre nivele nga nje qe eshte sot:

- Bashkia e Tiranes
- Bashkite e Tiranes
- Keshillat e Lagjeve

Bashkia e Tiranes eshte konceptuar si njesi koordinative dhe pergjegjese per drejtimin teresor te pushtetit vendor te qytetit. 11 Njesite administrative te kthehen ne Bashki te vogla me 40-50 mije banore, mbi te cilat do te ngrihet nje pushtet lokal i zgjedhur nga elektorati do te ishte rruga me e pershtatshme. Secila bashki e vogel, duhe te shoqerohet me kompetenca te caktuara dhe buxhetin perkates, ashtu si e kane bashkite dhe komunat ne pergjithesi. Qe pushteti te jete sa me afer interesave jetesore te banoreve, qe te parandalohen dukurite negative, si dhe shkeljet ligjore, dhe, qe decentralizimi i pushtetit te thellohet me tej, do te qe ne interes te punes te kete keshilla lagjesh me rreth 5000 banore, me nje numer te kufizuar anetaresh (7-9), me disa kompetenca dhe pa aparate ekzekutive.

Problem qe do nje kujdes te veçante eshte raporti i kompetencave midis 3 niveleve te pushtetit vendor te qytetit te Tiranes. Duke respektuar gjithnje parimet e njohura te vetqeverisjes, te pavaresise, te autonomise lokale dhe te decentralizimit mund te percaktohej nje ndarje e kompetencave:

- Bashkia e Tiranes te merret me problemet e koordinimit te politikave te zhvillimit ne rang qyteti
- Bashkite e Tiranes me zgjidhjen e problemeve me jetesore te banoreve ne te gjitha aspektet.

[1] *Local Government reform in Latvia. Institute of Economics, Latvian Academy of Sciences, by Raita Karnite. Riga 1993.*

• Keshillat e lagjeve ne ndihme per parandalimin e shkeljeve dhe zbatimin e ligjeve ne fuqi.

Ne menyre krejt te natyrshme, pushteti vendor ne Tirane do te kerkonte nje status te veçante, nje ligj te veçante organik, jashte ligjit per organizimin e funksionimin e pushtetit vendor ne teresi. Nje status te tille e kane edhe shume kryeqytete te tjera te Europes.

Nje variant i dyte i organizimit te pushtetit vendor per qytetin e Tiranes, qe mund te merioje vemendje, eshte edhe ai i Bashkise se Kamzes, ne perberje te se ciles eshte edhe Bathorja. Populisia e vendosur aty nuk disponon toke, pra realisht nuk eshte populisi fshatare. Ajo ka te gjithe shqetesimet si dhe populisia e qytetit te Tiranes: punesim, strehim, infrastruktura komunale, arsimore shendetesore, teknike etj. Nisur nga natyra e njejte e problemeve te kesaj populisie me ato te gjithe qyteteve, ndodhja e saj ne periferi te qytetit te Tiranes, kjo zone me shume perafron me qytetin se sa me fshatin. Ne keto kushte do te qe me oportune qe Bashkia e Kamzes per pjesen e qytetit, dhe zonen e Bathores, do te ishte Bashkia Nr. 12 e qytetit te Tiranes.

X. 2 Zhvillimi Ekonomik ne Nivel Lokal

Ndryshimet e shpejta ekonomike, sociale dhe ligjore, te kombinuara me shume ndryshime te pandodhura me pare, bene qe vendet ne tranzicion te perballen me nevojen per te kuptuar ekonomine e tyre dhe pozicionin ne lidhje me ekonomine e vendeve te tjera, per te vleresuar te ardhmen e zhvillimit te ekonomise se tyre si dhe per t'i bere te njohur vendeve te tjera gjendjen ekonomike dhe mundesite qe ato zoteronin. Keto ishin ne te njejten kohe sfida edhe per qeverite vendore. Ato tashme duhet te ishin shume me te angazhuara ne zhvillimin e komunitetit qe drejtonin.

Zhvillimi ekonomik eshte elementi me i rendesishem i zhvillimit te komunitetit, perderisa ai i siguron qytetit mundesite financiare per te zhvilluar aspektet e tjera. Per te ndermarre nje inisiative te suksesshme te zhvillimit ekonomik eshte e nevojshme te identifikohen aktoret qe do te perfshihen ne te, te gjendet se cila eshte rruga me e mire per keta aktore qe te punojne se bashku ne partneritet dhe, se fundi, te identifikohen burimet dhe pervoja qe secili aktor mund te ofroje.

Tre jane aktoret kryesore ne gjithe kete proçes: qeveria lokale, bizneset private dhe perfaqesuesit e tyre, dhe sektori i trete, shpesh i perfaqesuar nga organizatat jo-qeveritare. Ndermjet ketyre aktoreve, qeveria vendore eshte me kryesorja, ajo qe analizon ekonomine lokale, siguron drejtimin/udheheqjen, krijon dhe ruan nje mjedis aktiv qe nxit zhvillimin e biznesit, siguron sherbimet ose mundeson sigurimin e tyre, bashkerendon punen me aktoret e tjere, etj.

Pervoja e vendeve te ndryshme, qofte edhe atyre ne tranzicion, deshmon per nje angazhim ne rritje te qeverive lokale ne proçesin e zhvillimit ekonomik, duke u angazhuar proçesin e krijimit, vleresimit dhe te mobilizimit te burimeve njerezore, financiare, fizike e natyrore. per te krijuar mundesi dhe cilesi me te larte jete per komunitetin.

X. 2.1 Kuadri Ligjor Ekzistues lidhur me Zhvillimin Ekonomik Lokal

Angazhimi i pushtetit vendor ne zhvillimin ekonomiko-shoqeror te rajonit perkates eshte detyrim ligjor. Ligji Nr. 7572, date 10.06.1992 i permiresuar edhe ne vitin 1996, "*Per organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal*" percakton, si nje nga kompetencat e Keshillit Bashkiak apo te komunes se, ai "miraton studimet prognoze dhe programet e zhvillimit ekonomiko-shoqeror (neni 14.3)". Edhe keshillat e rretheve. krahas bashkerendimit te punes se Keshillave te komunave dhe te bashkive. kane te njejten kompetence. Po ky ligj. ne nenin 45.5 dhe 45.6. percakton se Keshilli i Rrethit "miraton programet e prognozat e zhvillimit social-ekonomik te rrethit dhe mbikqyr zbatimin e tyre" dhe "miraton buxhetin e rrethit dhe mbylljen e llogarise financiare te vitit".

Ne vijim te dispozitave te tjera ligjore. ne ligjin Nr. 7608 date 22.09.1992. te permiresuar dhe ne vitin 1997, ne kompetencat e prefektit percaktohet se ai "kontrollon zbatimin e buxhetit te shtetit ne administraten shteterore dhe ate te pushtetit lokal, si dhe kujdeset per mireadministrimin e te gjitha burimeve ekonomike kulturore. natyrore e historike" dhe "koordinon planin per zhvillimin ekonomik, shoqeror. arsimor. kulturor te prefektures dhe kujdeset per

zbatimin e tij".

Nga sa me siper, te dy nivelet e pushtetit vendor (bashki apo komune dhe Keshill i Rrethit) dhe prefektura kane te njejtat kompetenca ne rafshin e zhvillimit ekonomiko-shoqeror. Duke vazhduar ne kete linje, ne dispozitat plotesuese, ne forme orientimi percaktohet se keshillat e bashkive, komunave e rretheve ngrene prane tyre komisione te perhershme per probleme qe u interesojne, ku ne rrafshin e zhvillimit ekonomiko-social permenden: komisioni ekonomik dhe i zenies ne pune, i veprimtarise financiare dhe buxhetit, i zhvillimit te urbanistikes dhe ndertimeve, etj.

Problemet e funksionimit te pushtetit vendor zene nje vend qendror edhe ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise. Midis te tjerash, ne nenin 115 te saj percaktohet se "keshillat komunale, bashkiake dhe te qarkut:

a. rregullojne dhe administrojne ne menyre te pavarur çeshtjet vendore brenda juridiksionit te tyre;

b. ushtrojne te drejten e prones, administrojne ne menyre te pavarur te ardhurat e krijuara, si dhe kane te drejte te ushtrojne veprimtari ekonomike;

c. kane te drejte te mbledhin dhe te shpenzojne te ardhurat qe jane te domosdoshme per ushtrimin e funksioneve te tyre".

X. 2.2 Pushteti Vendor dhe Realiteti Ekonomik Lokal

Lidhur me zhvillimin ekonomik lokal ne pergjithesi dhe rolin e pushtetit vendor ne te, realiteti deshmon se:

Se pari, ne kuadrin e pergjithshem te ekonomise, ende nuk ka politika, orientime apo programe strategjike te zhvillimit te degeve kryesore te ekonomise, (perjashtuar bujqesine) pa diskutuar per nje program teresor. Keto programe kane te bejne paraprakisht me njohjen e nevojave te individeve, me percaktimin e prioriteteve, mjeteve dhe rrugeve qe do te perdoren per arritjen e objektivave, etj. Te gjithe keto elemente pothuajse mungojne deri tani, pasi vemendja eshte perqendruar tek stabilizimi ekonomik, permes masave makroekonomike qe ndihmojne kete proçes.

Se dyti, ne mungese te nje strategjie kombetare, zhvillimi ekonomik lokal po realizohet ne menyre spontane, gje qe ka te ngjare te thelloje me tej dallimet midis rajoneve. Aktualisht Tirana eshte rajoni me i zhvilluar, ku jane perqendruar 43 per qind e shoqerive tregtare. Pjesa me e madhe e subjekteve fizike e juridike (60 per qind) jane te karakterit tregtar, ku mundesia e punesimit eshte relativisht e kufizuar.

Kjo ka ndikuar edhe ne zhvillimet demografike dhe levizjet e pakontrolluara te popullsise nga zonat rurale ne ato fshatare, qe kane sjelle edhe mjaft shqetesime dhe probleme per qytetet e medha (strehimi, punesimi, urbanizimi, sherbimet komunale sherbimet sociale, etj.) Duke ju referuar popullsise se regjistruar, Tirana eshte rritur 1,6 here ne krahasim me 1990. por qe ne ne fakt, shifra arrin ne 2,4 - 2,6 here.

Se treti, megjithese kuadri ligjor ngarkon pushtetin vendor, ne tere piramiden e tij. te merret me zhvillimin ekonomik lokal dhe, megjithese kane kaluar rreth 8 vjet nga miratimi i ligjit baze *"Per organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal"*, nga ana e organeve te administrates shteterore nuk eshte punuar dhe miratuar asnje akt nenligjor (vendim apo udhezim) qe te percaktoje kriteret, metodiken, treguesit e hartimit te programeve prognoze te zhvillimit rajonal.

Se katerti, duke filluar nga Keshilli i Ministrave, nuk ka ende nje organizim monitorizues e bashkerendues te politikave ekonomike te ministrive, te institucioneve te tjera qendrore dhe aq me pak te organeve te pushtetit vendor, te rretheve te bashkive apo te komunave.

Se pesti, ne organet e pushtetit vendor gjejne pak vend. strukturat qe kane per detyre studimin dhe ndjekjen e zhvillimit perspektiv te rajonit. Ne disa bashki, si ne ate te Tiranes dhe Durresit, ka departamente te politikave te zhvillimit, madje edhe te perbere nga sektore te veçante per problemet te turizmit, tregtise, te industrise, etj., nderkohe qe ne bashkite me te vogla keto struktura nuk ekzistojne. Megjithate, edhe aty ku keto struktura jane ngritur. e gjithe puna e specialisteve te ketyre fushave permblidhet ne çeshtjet rutine, dhe mungon nje vizion i qarte dhe konkret i politikave te zhvillimit te ardhshem lokal.

Se gjashti, nga vrojtimet dhe kontaktet me punonjes te bashkive, te krijohet pershtypja se,

sipas tyre, zhvillimi ekonomik eshte detyre e pushtetit qendror dhe jo edhe atij lokal. Vizioni i tyre per rolin e pushtetit vendor permblidhet ne disa sherbime komunale (pastrim i qyteteve, kanalizim i ujrave te zeza, i ujit te pijshem, sherbimi i varrezave dhe dekorit te qyteteve, mirembajtja e rrugeve, tregjet e brendshme, mbledhja e taksave lokale, etj. Eshte e vertete se ne ekonomine e tregut, roli i shtetit ne teresi dhe ne kete kuader edhe ai i pushtetit vendor zvogelohet, por ai nuk shuhet. Veçanerisht ne periudhen e tranzicionit, ai eshte i domosdoshem. Shteti eshte ai qe duhet te ndertoje kuadrin ligjor dhe institucional te pershtatshem per veprim dhe te udheheqe e te realizoje ndryshimet strukturore. Ne kete aspekt, nje rol te rendesishem ka padyshim edhe pushteti vendor.

Se shtati, duke konsideruar sektorin privat si bazen e zhvillimit ekonomik ne nje ekonomi tregu, duhet pranuar se pushteti vendor eshte shume larg njohjes se gjendjes se zhvillimit te bizneseve ne rajonet perkatese, per te mos folur per bashkepunim midis tyre dhe hartim programesh te perbashketa per zgjerimin e tyre, shtimin e numrit te te punesuarve, etj.

Se teti, ekziston nje shkeputje midis shume problemeve social-ekonomike qe duhet te zgjidhe pushteti vendor dhe ndertimit te struktures se aparatit shteteror. Megjithese sipas ligjit ai ka rolin e vet dhe strukturat e veta per disa çeshtje mjaft problematike si punesimi, strehimi, arsimi, shendetesia, etj., paqartesia e kompetencave dhe ekzistenca edhe e strukturave te tjera shteterore qe merren me keto probleme, ka bere qe roli i pushtetit vendor te jete mjaft anesor.

Nga sa me siper, mund te thuhet se aktualisht, pushteti vendor eshte shume pak i perfshire dhe i angazhuar ne problemet aktuale dhe perspektive te zhvillimit ekonomik e social te rajonit.

X. 2.3 Disa Drejtime te Ndikimit te Pushtetit Vendor ne Zhvillimin Ekonomik

Roli i pushtetit vendor eshte i pazevendesueshem ne qeverisjen e vendit dhe ne ndertimin e shoqerise civile. Ai eshte hallka e pare e shtetit qe ndeshet me shqetesimet ekonomike e sociale te qytetareve, moszgjidhja e pershtatshme dhe ne kohe e te cilave mund te gjenerojne tensione politike. Ne kete kontekst, ai jo vetem qe duhet te perfshihet ne kete proçes por, duhet te jete nje nga aktoret kryesore te tij. Nga ana tjeter, eshte detyre e pushtetit qendror qe, nisur nga treguesit makroekonomik dhe synimet qe kerkon te arrije ne teresi, te jape disa pista te pergjithshme kerkimi dhe studimi, ne menyre qe organeve te pushtetit vendor t'u çelet horizont. Ne kete kontekst, disa nga drejtimet ne te cilat pushteti vendor duhet te fokusohet jane:

a. Identifikimi i burimeve rajonale per zhvillimin ekonomik e social-kulturor te rajonit perkates, duke perfshire burimet natyrore, kapacitetet prodhuese ekzistuese, burimet ujore, burimet njerezore, traditen e zones per prodhimet dhe sherbimet kryesore, etj.

b. Angazhimi i drejtperdrejte ne hartimin dhe zbatimin e projekteve te veçanta afat-shkurtera dhe afatmesme. Per kete duhen eliminuar disa praktika te tanishme dhe duhen bere permiresime ne drejtimet e meposhtme:

- permiresime ligjore qe angazhojne, ne rradhe te pare, pushtetin vendor dhe pastaj ate qendror ne marrjen e inisiatives per kryerjen e studimeve te pavarura. Ne kete aspekt, duhet theksuar nevoja e bashkepunimit me institucionet perkatese te administrates qendrore;
- permiresime ligjore qe percaktojne partneritetin me sektorin privat ne hartimin e zbatimin e projekteve te zhvillimit te biznesit (prodhues dhe te sherbimeve) ne nivel lokal;
- nxitje e projekteve afatshkurtera dhe afatmesme ne pergjithesi te plote te pushteteve lokale;
- rregulla ne shperndarjen e investimeve dhe dhenia e tyre ne bllok.

c. Sipas madhesise dhe mundesive te çdo komune apo bashkie, duhet te hartohet nje program/mikrostrategji zhvillimi ekonomik e shoqeror, nderkohe qe per bashkite e qyteteve kryesore duhet detyrimisht nje prognoze dhe strategji e plote zhvillimi rajonal, e cila, e miratuar nga organet kompetente perkatese, te marre fuqi detyruese. Ne kete pike duhet theksuar se, strategjite lokale do te jene pjese perberese dhe do te perfshihen ne strategjite degesore dhe ate te pergjithshme kombetare.

d. Zhvillimi ekonomik rajonal duhet te jete me politike e vazhdueshme per çdo zone, me

synim zbutjen e dallimeve midis tyre.

e. Te ndergjegjshem se ne zhvillimin ekonomik rajonal peshen gjithmone ne rritje do ta kete sektori privat, atehere edhe studimet duhet te synojne ne nxitjen e investimeve private te atyre sektoreve qe shfrytezojne burimet lokale dhe thithin fuqi punetore te re. Plotesimi i nje synimi te tille, krahas nje stafi te pergatitur te administrates te pushtetit vendor, kerkon edhe krijimin e mundesive financiare si linja te caktuara kreditimi per biznese te caktuara, lehtesira fiskale e doganore per lendet e para dhe makinerite e pajisjet teknologjike, probleme keto qe mund te zgjidhen ne bashkerendim me pushtetin qendror.

f. Rritja e kapaciteteve drejtuese te nepunesve lokale. Nga vrojtimet e QShKE-se, te realizuar gjate muajit Shtator 1999 me nepunesit e bashkive te qyteteve Tirane, Durres dhe Kavaje, rreth 70 per qind e tyre kerkojne te trajnohen ne çeshtjet e planifikimit strategjik dhe te zhvillimit ekonomik lokal.

g. Ky proçes kerkon bashkepunim te paleve te interesuara (pushtet qendror dhe pushtet vendor) per zhvillimin rajonal dhe institucionalizimin e ketij bashkepunimi. Praktikat e vendeve perendimore tregojne se ne zhvillimin lokal nje ndikim te rendesishem ka ngritja e institucioneve te pavarura te zhvillimit, te cilat bashkepunojne me pushtet vendore, si agjensite e zhvillimit ekonomik, koorporata e fondacione kreditimi, etj. Te tilla struktura jane ngritur ne rrethe e zona te veçanta te vendit si agjensite e zhvillimit te biznesit, inkubatoret e biznesit Tirane, Shkoder e ndonje rreth tjeter, praktike qe duhet te shtrihet me tej.

h. Per programet me karakter kombetar, per aq sa lidhen me veprimtarine lokale, pushtetet vendore eshte e domosdoshme te kete pergjegjesine e keshillimit si dhe te nxitjes se zhvillimit lokal ne teresi. Do te ishte me se normale qe nje drejtues/specialist i nje organi te pushtetit vendor, si pergjegjes kryesor per rajonin, te jete i pranishem dhe me mendimet te ndikoje ne hartimin e programeve te zhvillimit ekonomik ne teresi.

X. 2.4 Kush duhet te merret me Zhvillimin Ekonomik e Social Rajonal

Vite perpara u perpunuan dhe miratuan dy strategji te pjesshme, ajo per zhvillimin e turizmit dhe ajo e bujqesise, per te cilat mund te thuhet se nuk kane gjetur ndonje zbatim. Aktualisht, nuk ka asnje strategji zhvillimi degesor (perjashtuar bujqesine), pa bere fjale per strategji kombetare zhvillimi. Eshte e kuptueshme se strategjia kombetare mund dhe duhen ndertuar mbi bazen e strategjive rajonale e degesore, pa te cilat as qe mund te mendohet per nje strategji te besueshme dhe te realizueshme. Problemi shtrohet se kush duhet te ndertoje politikat apo strategjite e zhvillimit ekonomik?

Se pari, ne rang vendi duhet te kete nje organ shteteror, ne varesi te Keshillit te Ministrave, i cili te perpunoje kriteret metodologjike te hartimit te strategjise kombetare te zhvillimit si dhe menyrat e instrumentet e realizimit te politikave apo te strategjive te caktuara (kombetare, ministeriale, rajonale). Ai, ne baze te programit te Qeverise, fikson politikat prioritare sipas sektoreve te ekonomise dhe zonave apo rretheve te veçanta. Organizimi qe propozohet gjykohet te jete ne rangun e nje Ministrie te Ekonomise apo te nje Komiteti te Politikave Qeveritare.

Se dyti, drejtorite e Politikave te Zhvillimit prane Ministrive dhe institucioneve qendrore, te bashkerendojne punen dhe bashkepunojne me organet e pushtetit vendor per hartimin e strategjive afatshkurtera, afatmesme apo afatgjata te deges.

Se treti, ne baze qarku duhet te krijohet nje njesi/departament i zhvillimit ekonomik, e cila te kete per detyre, te studioje e monitorizoje zhvillimin ekonomik te rajonit dhe, ne baze te udhezimeve me karakter metodologjik, pergatit e paraqet per miratim programin e zhvillimit te rajonit.

Se katerti, ne raport me mundesite, kerkesat, nevojat dhe madhesine, te fuqizohen strukturat qe merren me politikat e zhvillimit, ne bashkite ku ato ekzistojne, si dhe te ngrihet atje ku ato mungojne. Ndersa, ne bashkite e qyteteve te vogla edhe ne komuna, gjykohet qe per keto probleme te kete bashkepunim ndermjet strukturave te tjera te bashkise.

Se pesti, prane Ministrise se Pushtetit Lokal gjykohet te ngrihet nje njesi/drejtori te koordinimit te politikave te zhvillimeve rajonale, detyre themelore e se ciles do te ishte pergatitja e udhezuesve per organet vendore per menyren e hartimit dhe te miratimit te politikave apo

te programeve te zhvillimit social-ekonomik te rajoneve te ndryshme; koordinimi i projekteve te ndryshme dhe paraqitja e tyre per miratim ne organet me te larta; mundesimi i instrumenteve financiare per realizimin e tyre (investime shteterore, kredi per sektorin privat, dhe kushtet per dhenien e tyre, donacione nga Organizma boterore apo shteteve te ndryshme); ndjekja sistematike e projekteve te miratuara dhe propozimi i masave perkatese, kur projektet ngecin apo ngadalesohen.

Gjykohet se ndertimi i nje piramide te tille eshte i domosdoshem per udheheqjen e nje zhvillimi ekonomik te qendrueshem si ne kuadrin rajonal, ashtu edhe ate kombetar dhe qe do te ndikonte ne decentralizimin e metejshem te pushtetit dhe rritjen e rolit te pushtetit vendor ne ndertimin e nje shoqerije civile demokratike.

X.2.5 Problemet Kryesore te Zhvillimit Ekonomiko-Social Rajonal

Territori i nje rajoni eshte nyja ku shumica e problemeve duhet te zgjidhen apo te marrin rrugen e zgjidhjes. Pra, para pushtetit vendor shtrohen shume probleme, nga menyra e zgjidhjes se cilave varet shume ecuria e nje rajoni, sigurohet qendrueshmeri ekonomike e sociale, zvogelohen konfliktet dhe shpejtohet krijimi i shoqerise civile te kerkuar. Disa aspekte te zhvillimit ekonomik e social rajonal me te cilat duhet te merret pushteti vendor jane:

Se pari, studimi i burimeve rajonale natyrore (nentoka, lendet e para, burimet ujore, bujqesore, blegtorale, etj.;

Se dyti, njohja e tradites se zones per realizimin dhe tregtimin e produkteve te ndryshme, mundesite per te cuar me tej kete tradite;

Se treti, analiza e kapaciteteve prodhuese ne perdorim, ato te vjetrat qe ka zona dhe qe mund te reabilitohen, kapacitetet e reja qe kerkohen per te shfrytezuar burimet rajonale;

Se katerti, studimi i karakteristikave te zones: bujqesore, industriale, tregtare, turistike, largesine nga tregjet kryesore, qendrat e banuara; gjendja e infrastruktures rrugore;

Se pesti, analiza e nivelit te zenies ne pune, fuqine e lire punetore, nivelin e kualifikimit dhe arsimit te saj, strukturen profesionale ekzistuese dhe kerkesat e reja te tregut te punes, rrjetin e shkollave per rikualifikimin e punetoreve apo pergatitjen e profesioneve te reja. Ne kete kuader, njohja e numrit dhe kualifikimit te specialisteve te qytetit, qe lidhen drejtperdrejte me prodhimin dhe sherbimet dhe pershtatja e saj e tregut aktual te punes;

Se gjashti, analiza e kapitaleve financiare te brendshme te biznesit privat, mundesite e institucioneve bankare, per te kredituar zhvillimin ekonomik e social dhe mundesite e terheqjes se investimeve te huaja.

Se shtati, studimi i bashkepunimeve te mundshme per prodhimet dhe sherbimet brenda rajonit, midis rajoneve te vendit dhe me gjere;

Se teti, studimi i tregut rajonal, i vendit dhe mundesive per eksport;

Se fundi, percaktimi i zonave te ndertimeve te reja (blloqe banimi, zona industriale, ndertime turistike, sheshe gjelberimi, lojra femijesh, kende sportive, etj.:

X. 3 Pavaresia Financiare e Pushtetit Vendor

Sipas Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, organet e pushtetit vendor veprojne si organe te pavarura dhe drejtojne punet publike ne njesite territoriale. Marredheniet ndermjet organeve te rrethit me ate te njesive te tjera administrative tokesore bazohen ne parimin e autonomise dhe te bashkepunimit per zgjidhjen e problemeve social-ekonomike. Ndermjet tyre nuk ekzistojne marredhenie varesie.

Sipas dispozitave ligjore ne fuqi, Keshilli i komunes/bashkise, sikurse kemi permendur, krahas hartimit dhe miratimit te programeve prognoze te zhvillimit ekonomiko-shoqeror, miraton buxhetin dhe ndjek zbatimin e tij, administron pasurine e komunes/bashkise, vendos taksa e detyrime te tjera te caktuara me ligj, krijon dhe suprimon institucione dhe njesi ekonomike te percaktuara me ligj, etj. Qe pushteti vendor te mund te realizoje funksionet dhe kompetencat ligjore te permendura, si dhe funksione te tjera qe do te gjykohen ne kuadrin e strategjise se Decentralizimit te Pushtetit Vendor, komunat/bashkite duhet te kene buxhetin e tyre te pavarur.

Shpenzimet e pushtetit vendor sipas dispozitave ligjore, mbulohen nga te ardhurat qe

realizojne komunat/bashkite, grantet (financimet) nga buxheti qendror dhe donacione te ndryshme.

Pavaresia relative e pushtetit vendor varet, ne nje mase te madhe, nga mundesite financiare qe ai ka per te kryer sherbime ne interes te komunitetit. Aktualisht, mundesite financiare te pushtetit vendor jane shume te kufizuara. Shpresohet qe me miratimin e ligjeve organik te funksionimit te pushtetit vendor (ligji per organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, per pronat e pushtetit vendor dhe te ligjit per buxhetin e pushtetit vendor), te rritet pavaresia financiare dhe ketyre te fundit t'u krijohen me shume hapesira per te vepruar ne menyre te pavarur. Tani per tani, organet e pushtetit vendor me te ardhurat qe realizojne ne shkallle vendi mbulojne rreth 59% te shpenzimeve. Ne dallim nga niveli mesatar ne shkalle vendi; te ardhurat nga burimet e brendshme ne Bashkine e Tiranes arrijne vlera te konsiderueshme. Dinamika e tyre ka qene me rritje nga viti ne vit. *(shih gjithashtu pasqyren 17 tek Aneksi).*

Pasqyra 56. Te dhena mbi financimet ne Bashkine e Tiranes

Treguesit	Viti 1997		Viti 1998		Viti 1999	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Financime nga Buxheti i Shtetit	1973	1870	2346	2293	2751	2687
Financime nga te ardhurat e Bashkise	254	219	260	249	451	423
Shuma	2227	2089	2606	2542	3202	3110
Mbulimi i shpenzimeve me te ardhurave ne %	11.4	10.4	9.9	10.8	14	13.6

Burimi: Departamenti i Finances, Bashkia Tirane

XI. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME KRYESORE

A. Pervoja e viteve te tranzicionit, si per te gjithe vendin, edhe per rajonin e Tiranes deshmoi per nje zhvillim spontan te te gjithe sektoreve te jetes ekonomike, shoqerore, politike. Ne disa drejtime jo vetem qe nuk jane shenuar arritje, por perkundrazi vertetohen perkeqesim i treguesve ekonomik apo edhe deshtime te pjesshme.

Per te menjanuar spontanitetin dhe per te siguruar nje zhvillim te harmonizuar te sektoreve prodhues dhe joprodhues ne kushtet e ekonomise se tregut, del e domosdoshme hartimi i nje strategjie te pergjithshme te zhvillimit te rajonit. Ajo ne pergjithesi duhet te permbaje:

- **Evidentimin dhe shfrytezimin e pasurive nentokesore dhe mbitokesore te rajonit;**
- **Shfrytezimin e kapaciteteve prodhuese ekzistuese dhe shtimin e aftesive te reja prodhuese;**
- **Studimin e lidhjeve kooperuese te rajonit brenda tij dhe me rajonet e tjera te vendit dhe me gjere;**
- **Fuqine punetore te papune, nivelin e kualifikimit, moshen, profesionalizmin si dhe shtimin e tregut te punes me forcat e reja;**
- **Gjendjen e infrastruktures teknike, sociale dhe prodhuese dhe perspektiven e saj;**
- **Studimet urbanistike te rajonit, duke percaktuar zonat e populluara, tregjet, zonat industriale, spitalore, shkollore, etj.;**
- **Studimet e modelit te perdorimit te tokes bujqesore, traditen e rajonit ne fushen e prodhimit, ndertimit, etj., te rejat qe jane futur si dhe perspektiven;.**
- **Fuqine investuese te rajonit;**
- **Burime te brendshme te vete bizneseve;**
- **Mundesine e kreditimit nga sistemi bankar;**
- **Mundesite qe krijohen nga dheniet me koncesion dhe me qera te pronave publike;**
- **Mundesite qe krijohen nga firmat e perbashketa;**
- **Keditime te mundshme me terma te buta;**
- **Financime nga burime te ndryshme (shteterore dhe te huaja).**

B. Per te hartuar, zbatuar, dhe monitoruar strategjine e pergjithshme te zhvillimit te rajonit kerkohet:

- **Te krijohen organizmat perkatese prane administrates se pushtetit vendor (te bashkive, komunave dhe te rrethit). Njesia e zhvillimit dhe e koordinimit prane bashkise duhet te riorganizohet dhe te fokusohet jo me problemet e sotme te rutines, por te luaje rolin e inisiatorit, drejtuesit, koordinuesit dhe te monitorizuesit te hartimit dhe te zbatimit te strategjise se zhvillimit te rajonit;**
- **Zhvillimi strategjik i rajonit duhet konceptuar dhe trajtuar si pune paresore e te gjithe elementeve te administrates vendore dhe jo vetem e njesise se zhvillimit;**
- **Sektori i informacionit, veçanerisht ai statistikor, duhet te funksionoje normalisht dhe te realizoje te gjithe informacionin ekonomik sipas kerkesave te ligjit "Per statistiken". Duhet te kuptojme se pa statistike nuk ka informacion dhe pa informacion nuk mund te kete drejtim shkencor;**
- **Bashkepunim dhe bashkerendim te punes me qeverine qendrore per politikat e veçanta sektoriale dhe ate te rajonit ne teresi;**
- **Percaktimi i afateve kohore te strategjise se zhvillimit , afatshkurter, afatmesem**

apo afatgjate;

➢ **Treguesit qe e bejne strategjine te matshme dhe te kontrollueshme.**

C. Ndertimi i nje parku industrial per Tiranen do t'i sherbeje zhvillimit ekonomik te rajonit. Kjo sepse Tirana ka qene dhe mbetet nje qytet industrial. Ne vend te disa sateliteve industrial qe kane rrethuar qytetin duke ndotur mjaft edhe ambjentin e tij, mendojme se krijimi i nje parku modern industrial ne zonen prane superstrades kryesore do te ndihmonte ne gjenerimin e punesimit dhe te jetes ekonomike te kryeqytetit

D. Decentralizimi fiskal eshte nje problem per te cilin po behet diçka ne keto vitet e fundit, por qofte edhe hapat me te medha jane te pamjaftueshem per rajonin e Tiranes. Ashtu si edhe ne te gjithe boten bashkia e kryeqytetit ka nje status special duke u ndare ne nenbashki, te cilat duhet te kene nje bashki qendrore dhe koordinuese te te gjithe aktivitetit social dhe ekonomik. Pra e thene shkurt, **Tirana ka nevoje per decentralizim te decentralizimit. Ne veçanti ketu behet fjale per decentralizimin administrativ dhe fiskal.**

E. Bumi urban qe po perballon Tirana eshte i tille qe, sipas mendimit tone, ne 10 vjetet e ardhshme do te arrijme ne piken kur rajoni i Tiranes te kete 25-30% te popullsise se Republikes. Ne keto kushte asgje, **eshte shume i domosdoshem azhornimi i Master Planit te qytetit me ndryshimet e reja te ndodhura dhe zbatimi strikt i tij, shoqeruar edhe me ndeshkime ligjore te aryre qe shkelin rregullat e urbanistikes.**

F. Zhvillimi ekonomik i qytetit te Tiranes kerkon nje studim urbanistik te plote te rajonit, ku me perparesi duhet te studjohet problemi i zonave satelite dhe i integrimit te tyre aktiv ne jeten e Tiranes. Vetem ne kete menyre do te frenohet disi mbipopullimi i Tiranes dhe do te arrihet nje zhvillim i harmonizuar ne nje hapsire me te gjere. **Per kete duhet hartuar nje sistem ligjor nxites per investime ne zonen suburbane dhe ne qytetet satelite te Tiranes, duke i bere ata me atraktiv per investitore vendas dhe te huaj.**

G. Tirana, si kryeqytet i vendit, eshte nje zone mjaft terheqese per banka te ndryshme. Aktualisht, ne qytetin e Tiranes operojne 13 banka vendase dhe te huaja, ne formen e degeve te bankave te ndryshme, joint ventures me bankat shqiptare ose edhe si filiale bankash. Por, megjithe numrin e madh te bankave qe jane ne Tirane, ato nuk arrijne te shuajne etjen e biznesit tiranas per kredi. Pra, shume prej ketyre bankave sherbejne vetem per grumbullim te depozitave pa kredituar biznesin tiranas. Mendojme se **duhet te behen regullimet e mundeshme ligjore per "detyrimin" e ketyre bankave per te patur nje nivel te caktuar kreditimi me qellim rritjen e ativitetit ekonomik te rajonit. Ne kete menyre, keto banka shlyejne edhe nje "detyrim moral" qe kane ndaj depozitoreve te tyre, qytetareve te Tiranes.**

H. Permiresimet infrastrukturore te rajonit duhen pare jo vetem ne drejtim te mirembajtjes dhe riparimeve urgjente te infrastruktures ekzistuese, por edhe ne krijmin e nje rrjeti te ri infrastrukturor me te gjere. Ne kete drejtim, duhet te shfrytezohet mali i Dajtit, i cili mund te sherbeje si nje qender shlodhese klimaterike. **Ndertimi i nje sistemi teleferik per te lidhur periferine e Tiranes ne zone prane kinostudjos me piken e vjeter baze turistike te malit te Dajtit eshte nje nevoje me se e domosdoshme. Kjo gje do te sjelle jo vetem rritjen e ambjenteve çlodhese, por edhe gjenerim te punesimit dhe te aktivitetit ekonomik.** Natyrisht, qe mbas krijimit te infrastruktures se nevojshme mbeshtetese (nje parking i gjere makinash prane kinostudjos) dhe te vete teleferikut, jane biznesmenet tiranas ata qe ne baze te iniciatives se lire do te ngrene komplekset çlodhese dhe argetuese ne zonen turistike. Kjo gje do te ndikoje edhe ne uljen e fluksit te trafikut drejt Durresit, qe ne periudhen e veres eshte i paperballueshem.

I. **Vitalizimi dhe integrimi ne vendimarrjen per rajonin e Tiranes, te shoqatave te biznesmeneve tiranas eshte nje rruge per rritjen ekonomike te rajonit.** Jane pikerisht biznsmenet ata qe jane munduar te gjallerojne jeten ekonomike te rajonit te Tiranes, jane ata qe duke patur ne baze interesat e tyre personale dhe inteligjencen dhe aftesite menaxhuese kane arritur te bejne diçka per jeten ekonomike te rajonit. Natyrisht qe ndaj tyre duhet vepruar

me kujdes, duhet te nxiten per biznes te ligjshem dhe me interes dhe te goditen ne prirjet korruptive dhe ne fshehjet qe i bejne te ardhurave nga bizneset per te pakesuar kontributin e tyre ndaj buxhetit te shtetit.

J. **E dobishme do te ishte nxitja e krijimit te bizneseve te perbashketa midis bashkise (me marrjen e pronave te veta ne perdorim) dhe biznesit qe operon ne Tirane.** Kjo, jo vetem qe do te ndihmoje mundesite investuese te biznesmeneve, por do te rrise edhe te ardhurat e bashkise se Tiranes, duke i dhene me teper mundesi per investime ne nivele te ndryshme te infrastruktures se qytetit dhe rajonit.

K. Mendojme se, per bizneset prodhuese qe shfrytezojne lendet e para te rajonit te Tiranes, qe krijojne premisa per eksport dhe qe angazhojne ne pune fuqi punetore te konsiderueshme duhet te ndiqet nje politike nxitese tatimore dhe doganore, me qellim prioritar zgjerimin e aktivitetit te tyre dhe krijimin e kushteve per rritjen e numrit te biznesmeneve qe investojne ne aktivitete te tilla.

L. Ne nje bashkepunim te ngushte mes bashkise se Tiranes dhe Ministrise se Punes dhe te Perkrahjes Sociale, me ndihmen e Ministrise se Arsimit dhe Shkences **duhet te hartohen program te gjera riciklimi dhe kualifikimi per fuqine punetore e cila ka dale dhe do te dali e tepert nga zhvillimet e ekonomise se vendit ne tranzicion, si edhe per te perballuar shtesen e tregut te punes nga punonjesit e rinj qe vijne nga shtesa natyrore dhe nga ajo migruese e popullsise.**

M. Ne kushtet e zhvillimit te bujqesise dhe blegtorise **duhet te studjohet dhe te llogariten tepricat bujqesore dhe blegtorale sipas llojeve te produkteve dhe sipas zonave rurale te Tiranes, te cilat sot dalin ne treg ne menyre spontane dhe kaotike. Mbi kete baze mendojme se duhet te nxitet krijimi i qendrave zonale te grumbullimit te tyre,** te cilat do te sherbejne si nje hallke ndermjetese mes bujqesise dhe perpunuesve te agrobiznesit dhe furnizimit te tregut te qytetit me produkte te fresketa.

N. Ne studimet urbanistike te qytetit te Tiranes, nje vend te veçante duhet te zere krijimi i supermarketeve te mbyllura bujqesore dhe blegtorale, te cilat si ambjente mund te jene prone e bashkise, dhe qe do te perdoren per tregtim me shumice dhe me pakice te produkteve bujqesore dhe blegtorale

LITERATURA:

1. Agjensia Rajonale e Zhvillimit Tirane
2. Botime, Ministria e Ekonomise Publike dhe e Privatizimit, 1999
3. Buletine, Komiteti i Turizmit
4. Buletine, INSTAT
5. Buletine, KESH
6. Buletine, Komiteti Kombetar i Energjise
7. Gazeta "Ekonomia" 29 Shkurt 2000
8. Informacion, Drejtoria e Statistikes Bashkise Tirane
9. Ministria e Shendetsise. Studim per ujin e pijshem dhe ujrat e zeza per Tiranen 1997
10. Raporte, informacione te Bashkise Tirane
11. Raport per gjendjen e mjedisit 97-98, Agjensia Kombetare e Mjedisit, Tirane 1999
12. Plani Kombetar i menaxhimit te plehrave per Shqiperine, PHARE, Tirane 1966
13. Projekte kerkimore dhe vrojtime te QShKE-se, 1998, 1999
14. Projekti per zhvillimin e arsimit ne Shqiperi, Programi Tirana 2000, SOROS.
15. Statistika, Sektori i Statistikes prane Drejtorise se Bujqesise Tirane
16. Statistika, Drejtoria e Tatim-Taksave, Tirane 1999
17. Statistika, Deget e Bankave ne Tirane te BKT-se dhe B. Kursimeve, 1999
18. Strategjia afatmesme per zhvillimin e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, 1999.
19. Strategjia e Zhvillimit te Bujqesise, 1998
20. Vjetar Statistikor 1990

ANEKS

Pasqyra 1. Konsumi i Energjise Elektrike per Rrethin e Tiranes (ne mije)

Emertimi	1998						1999					
	Konsumi i Pergjithshem			Konsumi i Populisise			Konsumi i Pergjithshem			Konsumi i Populisise		
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat
Prodhimi i Energjise elektrike	6100	-	-	-	-	-	5400	-	-	-	-	-
Tirana	876.859	686.233	190.636	274.094	232.148	41.946	1071.108	850.654	220.454	355.406	292.675	62.731
Janar	83017	68277	14740	25301	22322	3019	114820	94341	20479	32410	27783	4627
Shkurt	73181	59509	13672	23564	20658	2906	113353	99096	19237	30127	25358	4768
Mars	77568	64469	13099	21951	19127	2824	107632	88151	19501	30836	26165	4671
Prill	73605	56840	16765	22482	19685	2797	94495	74994	20593	30243	24851	5392
Maj	71353	43871	14522	21145	18247	2898	76586	55993	16604	28278	23141	5137
Qershor	52253	39365	12888	20752	17429	3323	70880	54276	15525	27309	22028	5281
Korrik	53425	39628	13797	21334	17817	3517	67761	52220	15541	26720	23616	5084
Gusht	53857	41002	12855	21397	17456	3941	68350	54446	15874	26807	21628	5179
Shtator	58153	44879	13304	21316	17358	3958	70787	57846	16341	27379	23827	5552
Tetor	70530	55203	15327	22548	18521	4027	75224	74070	17378	29251	23670	5581
Nendor	93543	75974	17569	24387	20026	4291	91933	27765	17863	30102	24496	5606
Dhjetor	116374	97206	19168	27917	23432	4485	119287	27765	21522	35944	30091	5833

Burimi: Korporata Elektroenergjetike

Pasqyra 2. Te dhena sezonale per rajonin e Tiranes, 1998-1999 (000/kwh)

Periudha	1998						1999					
	Konsumi i Pergjithshem			Konsumi i popullsise			Konsumi i Pergjithshem			Konsumi i popullsise		
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat
Kons. pergj	876859	686.223	190636	274094	232148	41946	1071108	850654	220454	355406	292675	62731
Dimri	355589	224992	47580	76782	66412	10410	347460	286202	61238	98481	83233	15248
Janar	83017	68277	14740	25101	22322	3019	114820	94341	20479	32410	27783	4627
Shkurt	73181	59509	13672	23561	20658	2906	113353	94.0%	19237	30127	25359	4768
Dhjetor	116374	97206	19168	27917	23432	4485	119287	97765	21522	35944	30091	5853
Vera	159535	119995	39460	63483	52702	10781	206991	158972	48019	80836	65292	15544
Qershor	52253	39365	12888	20752	17429	3323	70880	54276	15525	27309	22028	5281
Korrik	53425	39628	13797	21334	17817	3517	67761	52220	15541	26720	21636	5084
Gusht	53857	41002	12855	21397	17456	3941	68350	52476	15874	26807	21628	5179
Dif. (shume absolute)	196054	104987	8120	13299	13710	-371	140469	127230	13219	17645	17941	-296
Dif. Ne %	55	46.6	17	17	20	-	40	44.4	21	17.9	21.5	

Pasqyra 3. Rrjeti arsimor dhe numri i nxenesve ne Tirane

Nr.	Emertimi	1997-1998			1998-1999		
		Gjithsej	Nga keto		Gjithsej	Nga keto	
			Tirana	Rrethi		Tirana	Rrethi
Numri i shkollave							
1	8-vjeçare	148	50	98	150	51	99
2	Shkolla vartese	94	1	93	97	1	96
3	Shkolla te mesme me shkeputje nga puna	38	20	18	40	22	18
	-te pergjithshme	28	11	17	29	12	17
	-profesionale	10	9	1	10	10	0
	-te bashkuara	0	0	0	0	0	1
4	Shkolla te mesme pa shkeputje nga puna	3	2	1	2	2	0
	-te pergjithshme	2	1	1	1	1	0
	-profesionale	1	1	0	1	1	0
	-te bashkuara	0	0	0	0	0	0
5	**Kopshte**	155	42	113	151	41	110
Numri i nxenesve							
1	Ne 8-vjeç. dhe shkolla vartese	71395	45625	25770	75503	46748	28755
2	Ne shkollat e mesme me shkeputje nga puna	16109	13979	2130	17054	14704	2350
	-te pergjithshme	12220	10123	2097	12974	10674	2300
	-profesionale	3889	3856	33	4080	4030	50
3	Ne shkollat e mesme pa shkeputje nga puna	1915	1524	391	1820	1315	505
	-te pergjithshme	1378	987	391	1367	862	505
	-profesionale	537	537	0	453	453	
4	**Nr i vendeve ne kopshte me ushqim**	2390	2390	-	2273	2273	

Pasqyra 4. Aktiviteti i Institucioneve Ambulatore dhe Konsultoret e Femijeve

Viti		Institucione ambulatore	Poliklinika	Qendra Shendetsore	Ambulanca	Konsultore te femijeve
1993	Gjithsej	165	12	75	78	130
	Qytet	12	12	0	0	10
	Fshat	153	0	75	78	120
1994	Gjithsej	165	12	75	78	130
	Qytet	12	12	0	0	10
	Fshat	153	0	75	78	120
1995	Gjithsej	177	15	75	87	145
	Qytet	15	15	0	0	12
	Fshat	162	0	75	87	133
1996	Gjithsej	181	15	61	105	164
	Qytet	13	13	0	0	13
	Fshat	168	2	61	105	151
1997	Gjithsej	172	15	62	95	170
	Qytet	13	13	0	0	13
	Fshat	159	2	62	95	157
1998	Gjithsej	224	15	59	150	164
	Qytet	13	13	0	0	14
	Fshat	211	2	59	150	150

Pasqyra 5. Aktiviteti i Çerdheve te Femijeve

Nr.	Emertimi	Numri i çerdheve	Numri i vendeve ne çerdhe	Numri i regjistruar	Frekuentuar
Viti 1993					
	Gjithsej	33	1929	1658	1346
1	Qyteti	33	1929	1658	1346
2	Fshati				
Viti 1994					
	Gjithsej	33	1440	1428	1059
1	Qyteti	33	1440	1428	1059
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1995					
	Gjithsej	30	795	1457	1024
1	Qyteti	30	795	1457	1024
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1996					
	Gjithsej	30	1315	1460	1016
1	Qyteti	30	1315	1460	1016
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1997					
	Gjithsej	29	1441	1400	884
1	Qyteti	29	1441	1400	884
2	Fshati	0	0	0	0
Viti 1998					
	Gjithsej	29	1505	1452	981
1	Qyteti	29	1505	1452	981
2	Fshati	0	0	0	0

Pasqyra 6. Struktura e fondit te tokes se punueshme ne rajonin e Tiranes 000/ha

Nr	Lloji	Nivel Republike	Rrethi i Tiranes	Pesha specifike e Tiranes ne rang vendi (%)
1.	Toke arre	699.0	31.4	4.5
2.	Pemetari	59.5	2.3	3.8
3.	Vreshta	19.0	1.7	8.9
4.	Ullishta	44.0	3.8	8.6

Pasqyra 7. Te dhena mbi bujqesine e rajonit te Tiranes

Nr.	Artikulli	Njesi e matjes	Republika	Rrethi Tiranes	Pesha specf. Tiranes/Repb.
1.	Peme frutore	000/renje	3.129	258	8.2
2.	Ullinj	000/renje	2.600	210	8.0
3.	Pjergulla	000/renje	423	27	6.4
4.	Lope	000/krere	1.395	58	4.2
5.	Dele	000/krere	3.837	35.5	9.2
6.	Prodh. Qumesht	000/ton	8600	57	6.6
7.	Prodh. Veze	000/kokra	397000	47.0	11.8
8.	Prodh. Mish peshe e gjalle	000/ton	106.0	5.2	4.9
9.	Prodh. Ullinj	000/ton	47.0	6.3	13.4

Pasqyra 8. Perpunimi i Produkteve Bujqesore dhe Blegtorale, 1998 (ne ton)

Nr.	Artikulli	Republika	Rrethi i Tiranes	P. Specifike
1.	Miell	74016	20254	27.4
2.	Buke	61151	14006	22.9
3.	Makarona	866	92	10.6
4.	Kos	4713	2241	47.5
5.	Djath	5798	1583	27.3
6.	Gjize	201	12	5.9
7.	Gjalp	302	72	23.8
8.	Konserv. Peshku	836	337	40.3
9.	Kons	337	164	48.6
10.	Sallam	2349	960	40.8
11.	Birre	92583	74033	80.0
12.	Pije alkoolile	22029	10511	47.7

Burimi: Ministria e Bujqesise dhe ushqimit

Pasqyra 9. Te dhena per bimet e arave, 1999

Nr.	Emertimi	Sip. ha	Rend. Kv/Ha	Prodhimi	
				Direkt ton	Gjithsej ton
I	Sip. e tokes are	21404	x	x	x
II	Sip. e mbjelle gjithsej	19078	x	x	x
1	Drithera Gjithsej	5430	31	16793	16793
•	Grure	2310	23.3	5398.5	5398.5
•	Miser	3106	36.6	11380.5	11380.5
•	Theker	14	9.9	14	14
2	Perime e bostan	3172	145	46018	53172
3	Patate	634	104	6582	6582
4	Fasule	678	9.9	673	720
5	Duhan	67	9.3	62.5	62.5
6	Elb Distik	3.2	11.3	3	3
7	Soje	x	x	x	X
8	Tagjira	407	16	658	658
9	Foragjere te njoma	8604	211	181378	205107
•	Jonxhe	4800.5	274.4	131729	131729
•	Kultura te tjera arash	82.5	47	385	385

Pasqyra 10. Te dhena per pemtarine, 1999

Nr.	Emertimi	Sip. (ha)	Numri i rrenjeve		Rend. Kg/ rr.	Prodhimi (ton)
			Gjithsej	Ne prodhim		
1	Peme frutore	x	265175	215640	16.3	3520
2	Ullinj	x	317920	293605	9	2664
3	Agrume	x	6238	1686	12.8	21.6
4	Pjergulla	x	222812	193092	9	1911
5	Vreshta	349	x	322	61kv/ha	1957
6	Prod. rrush gjithsej	x	x	x	x	3868

Pasqyra 11. Te dhena per blegtorine, 1999

Nr.	Emertimi	krere
1	Gjedhe gjithsej	39560
•	Lope	27600
•	Qe	445
2	Te leshta	70045
•	Dele plleja	54360
3	Te dhirta	46465
•	Dhi plleja	34971
4	Derra	553
5	Dosa	90
6	Njethundrake	12582
•	Kuaj	1406
7	Shpende gjithsej	403400
•	Shpende fushe	400324
	pula	368900
•	Shpende uji	690
•	Shpende deti	2386
8	Blete (koshere)	1898

Pasqyra 12. Prodhime blegtorale gjithsej

Nr	Emertimi	Krere	Rendimenti (Kg/krere)	Prodhimi (ton)
1	Qumesht Gjithsej	x	x	61372.1
•	Lope	27600	2032.46	56096
•	Dele	54360	46.2	2512.5
•	Dhie	34971	70.02	2763.6
2	Mish gjithsej	x	x	5145.4
•	Gjedhi	x	x	3269.9
•	Te imtash	x	x	1445
•	Derri	x	x	47
•	Shpendi	x	x	383.5
3	Lesh	70045	1.7	119.3
•	Dele	70045	1.7	119.3
•	Dhie	x	x	x
3	Veze (000/kokrra)	378900	131.36	49773.5
4	Mjalte	1898	8.2	15.6

V.O. Qumeshti qe kane pire vicat eshte 10150 ton dhe eshte perfshire ne prodhim qumesht lope dhe qumesht gjithsej.

Pasqyra 13. Eksportues Agro-industriale te Tiranes (per periudhen 1997 dhe vijim)

Nr	Subjekti eksportues	Vendodhja	Produkti i eksportuar	Sasia mes. Vjetore (ton)	Destinacioni eksport
1	Aris-Frut	Tirane	Erza kulinare	20	Zvicer
2	Euro-Col	Tirnae	Bime medicinale	2000	Gjermani-greqi
3	Herbex	Kom. Preze	Bime medicinale Esenca bimore	120 3-4	France
4	Preza shpk	Tirane	Bime medicinale	100	Greqi
5	G.I.A.	Tirane	Domate e thare	15	Itali
6	Gazheli shpk	Tirane	Esence dellenje	800	Itali
7	Ish tre ortaket	Tirane	Konjak "Skenderbeu"	25	Slloveni
8	Bora dhe Comp.	Tirane	Kerpudhe e fresket	25	Itali

Pasqyra 14. Statusit aktual i ish ndermarrjeve prone publike

Nr	Emri i ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushteti Vendor	Publik	SHA-sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint venture	Me qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
1	Kombinati i Autotraktoreve	po	-	40	Po	60	-	-	-	Po	-	-
2	Uzina Dinamo (vjeter)	-	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	-	-
3	Uzina Dinamo e Re	Po	-	Po	po	-	-	-	-	Po	-	-
4	Uzina mekanike Tirana	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	Po	-	-
5	Uzina Tirana	-	Po	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
6	Uzina Partizani	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
7	U.M. Bujqesore	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
8	Uzina Elektr-mekanike	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
9	Uzina Elektroteknike	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
10	Uzina Abraziveve	Po	-	-		Po	-	-	-	Po	-	-
11	Uzina Dajti	-	-	-	-	-	-	Po	-	Po	-	-
12	Uzina elekt-mjekesore	-	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-
13	Uzina Gjeologjise	Po	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	-	-
14	Elektr-mek Komunale	-	Po	60	-	40	-	-	-	Po	-	-
15	Oficina M. Rendit	Po	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
16	Oficina e Min. Tregtise	-	-	Po	-	-	-	-	-	-	Po	-
17	N.R.M.N.	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
18	Parku i Min. Ndertimit	-	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	-	-
19	Uzina e Tankeve	Po	-	Po	-	-	Po	-	-	-	-	Po
20	Uzina e Altilerise	po	-	po	-	-	-	-	-	-	Po	-
										po	-	-

Pasqyra 15. ***Struktura e Ndermarrjeve***

Nr	Emri i Ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushtet Vendor	Publik	SHA-sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint venture	Me qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
Ndermarrje Energjetike												
1	TECI	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	-	-
2	Nd. Elektrike	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
3	Hidrocentrali	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
4	Nd. Elektrike fshatit	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
5	Nd. Shperndarjes karburantit	Po	-	-	Po	-	-	-	-	Po	Po	-
Ndermarrje Minerare												
1	Min. Qymyrg. Valias	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	-	Jo
2	Min. Qymyrg. Mezez	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	Jo
3	Min. Qymyrg. Krrabe	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	Po	Po	-
4	Min. Qymyrg. Mushqeta	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	Po	Po	-
5	Min. Bokside	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	jo

Pasqyra 16. Ndermarrje te Industrise se Lehte

Nr	Emri i Ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushtet Vendor	Publik	SHA-sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint venture	Me qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
1	Kombinati Tekstilit	po	-	40	Po	60	-	-	-	-	-	-
2	NPV Ushtarake	po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
3	NPV Nr. 1	Po	-	49	Po	51	-	-	-	Po	-	-
4	NPV Nr. 2	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
5	N.P.K. Gjere Nr. 1	-	Po	20	-	80	-	-	-	-	-	-
6	N.P.K. Gjere Nr. 2	-	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-
7	Fabrika e kepuceve	Po	-	36	-	64	-	Po	-	Po	-	-
8	Artistike "Migjeni"	-	Po	30	-	70	-	-	-	-	-	-
9	Gezof Galanteri	-	Po	20	-	80	-	-	-	Po	-	-
10	Porcelani	-	Po	25	-	75	-	-	-	Po	-	-
11	Prodhime sixhade	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
12	Komb. "Misto Mame"	-	Po	20	-	80	-	-	-	Po	-	-
13	Komb. Poligrafik	Po	-	30	-	70	-	-	-	Po	-	-
14	Shtypshkronja B. Prof	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
15	Tipografi ushtarake	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	Po	-	-
16	Nder. Mjete Mesimore	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
17	Nder. Mjete Sportive	-	Po	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po
18	Nder. Kartografike	-	Po	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
19	Uzina e Antibiotikeve	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
20	Ndermarrja Kimike	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
21	ND. Kimike Ushtarake	Po	-	-	Sh.A.	-	-	-	-	-	-	Po
22	N.P. Veprave te Artit	Po	-	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po
23	N.P. Farmaceutike	Po	-	po	Po	-	-	-	-	po	-	-

Pasqyra 16/1. Struktura e Ndermarrjeve

Nr	Emri i Ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushtet Vendor	Publik	SHA-sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint venture	Me qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
Ndermarrje te Industrise Ushqimore												
1	Kombinat Ushqimor	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	-	-
2	Fabr. Birres	Po	-	-	Po	-	-	-	-	Po	Po	-
3	Fab. Miellit	-	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	-	-
4	Fab. Bukes	Po	-	-	Po	-	-	-	-	Po	-	-
5	Komb. Mish Qumesht	po	-	50	Po	po	-	-	-	po	-	-
Ndermarrje te Ndertimit												
1	Komb. "J. Pashko"	Po	-	20	po	80	-	-	-	Po	-	-
2	Nder. Pr. Mat. Ndertimi	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	Po	-
3	N.N. Banesa	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
4	N. N. Industriale	-	Po	30	-	70	-	-	-	-	-	Po
5	N. N. 10	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
6	N. Bonifikimit	-	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	Po
7	N. Rruga Ura Asf.	Po	-	30	Po	70	-	-	-	Po	-	-
8	N. Rruge Kanalizime	-	Po	Po	-	-	-	-	-	-	Po	-
9	N.N. Miniera	Po	-	Po	-	-	-	-	-	Po	-	-
10	N.N. Tension i Larte	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
11	Fab. Tulla Vore	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	Po	-
12	Fab. Tulla Nr. 1	-	-	-	-	Po	-	-	-	Po	-	-
13	Fab. Tulla Nr. 2	-	-	-	-	Po	Po	-	-	Po	-	-
14	Nd. Montim Industriale	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
15	N.N. Hidroteknike	po	-	po	po	-	-	-	-	po	-	-
Ndermarrje Bujqesore												
1	N.B. Kamze	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
2	NB "17 Nendori"	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
3	NB "Gj. Dimitrov'	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
4	NB Kurova	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
5	NB Vore	-	-	-	-	Po	Jo	-	-	-	-	Po
6	NB Marikaj	-	-	-	-	-	Jo	-	-	-	-	Po
7	Drejt. Ujrave	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	-	Po	-
8	SMT	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	-	Po
9	Eksimagro	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
10	Inst. Perime-Patate	Po	-	Po	-	-	-	-	-	-	Po	-
11	Inst. Zooteknise	Po	-	Po	-	-	-	-	-	Po	-	-

Pasqyra 16/2. Struktura e Ndermarrjeve

Nr	Emri i Ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushtet Vendor	Publik	SHA-sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint venture	Me qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
Ndermarrje Tregtise												
1	NTI	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
2	NTU - 1	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
3	NTU 2	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
4	NTUS	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	pd
5	ND. e Mencave	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
6	NFP	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
7	NTSH - 1	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
8	NTSH - 2	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
9	NT Studenti -1	-	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po	-
10	NT Studenti -2	-	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po	-
11	NT Studenti -3	-	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po	-
12	Minergo impeks	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
13	Makina impeks	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
14	N.Sh. Z. Drini	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
15	N. Grumbullimit	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
16	Frigoriferi Nr. 1	-	-	-	-	Po	-	-	-	-	Po	-
17	Frigoriferi Nr. 2	-	Po	-	Po	-	-	-	Po	-	Po	-
18	Nd. Tregjeve	-	Po	-	Po	-	-	-	-	-	Po	-
19	Alb. Turizmi	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	Po	-	Po
20	Tregshm	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	Po
21	Fufarma	-	Po	70	Po	30	-	-	-	-	Po	-
22	Meico	-	-	-	-	-	po	-	-	-	-	-

Pasqyra 16/3. Struktura e Ndermarrjeve

Nr	Emri i Ndermarrjes	Pronesia		Statusi Aktual						Funksionon?		
		Ministri	Pushtet Vendor	Publik	SHA-Sh.p.k	Privatizuar	Likuiduar	Koncesion -Joint Venture	Me Qera	Pjeserisht	Plotesisht	Jo
Ndermarrje Transporti												
1	Parku i udhetareve	Po	-	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
2	Parku i Mallrave	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
3	Parku Spedicionit	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
4	Parku i Tregtise	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
5	Parku Komunal	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
6	Parku i Industrise	-	-	-	-	Po	Po	-	-	Po	-	Po
7	Transshqip	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	Po	Po
8	N.Sh. R. A. K	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
9	Parku i Delegacioneve	-	-	-	-	Po	Po	-	-	-	-	Po
10	Autoparku i Ushtrise	Po	-	-	-	-	-	-	-	Po	Po	-
11	Parku i Turizmit	Po	-	Po	-	-	-	-	-	Po	Po	-
Ndermarrje Komunale												
1	Nd. Gjelberimit	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
2	ND. Ujesjellesit	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
3	Nd. Pastrimit	-	Po	-	Po	Po	-	Po	-	-	Po	-
4	Nd. Rruge-Kanalizime	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
5	Nd. Riparim-Sherbime	-	-	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	Jo
6	Nd. Lende djegese	-	-	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	Jo
7	Nd. Dekorit	-	Po	Po	Po	-	-	-	-	-	Po	-
8	Nd. Ndriçim qytet	-	Po	-	Po	-	-	-	-	-	Po	-

***Shenim**: Shifrat ne kollonat e statusit aktual "publik apo privatizuar" tregojne raportin e aksioneve shtet-privat*

Ne vitin 1990 ne Tirane funksiononin *121 ndermarrje ekonomike*

-Funksionojne plotesisht *35 ndermarrje*

-Funksionojne pjeserisht *32 ndermarrje*

-Nuk funksionojne *54 ndermarrje*